



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/101 - 4305 dt. 29/10/2019

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
21.12.2018**

PROCESVERBAL

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë.
21.12.2018

Mbledhjen e kryesoi: **LABINOT HALILAJ** – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 28 anëtar

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend Dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së datës: 29.11.2018
2. Plani i Punës i Kuvendit Komunal për vitin 2019
3. Raporti i punës rreth regjistrimit të planit të integritetit dhe menaxhimit të rrezeve.
4. Propozim Vendim për vazhdimin e dhënien në menaxhim-shfrytëzim të përkohshëm të parkingut të automjeteve që gjendet në hapësirat e stacionit e autobusëve, Shoqatave të dalura nga Lufta.
5. Propozim vendim për iniciimin e themelimit të teatrit të qytetit
6. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 29/11/2018 ishin: Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, Përfaqësues të KFOR-it, dhe përfaqësues të OSCE-së, Drejtor të Drejtorive.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të gjithë, hapi diskutimin për rendin e ditës dhe kërkoi nga anëtarët e kuvendit se a pajtohen me këtë rend dite, apo ka ndonjë propozim?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, pati një propozim vendim:

Për ndryshimin e lokacionit për ndërtimin e qendrës edukativo-kulturore, nga parcela 7820 dhe pjesa e parcelës 768-1, në parcelen Nr.01001-3 në zonën kadastrale në Drenas. Ku i njoftoi me arsyetimin e këtij propozim vendimi, dhe kërkoi nga ana juaj që ky propozim ndryshim i këtij vendimi të votohet nga ana juaj.

Petrit Gashi, unë kisha propozuar që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet, mos të hyn si pikë e rendit të ditës, për shkak që po ngutemi, ne vetëm sa e morëm materialin dhe nuk mundemi me e verifikuar këtë material ende. Ne kur kemi diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës për "Qëndresën Kosovare" për ndërtimin e kësaj qendre edhe atëherë e keni sjellë me urgjencë dhe keni thënë se menjëherë do të fillon puna. dhe po shihet që deri me tani nuk paskeni filluar, dhe tani paskeni shikuar pronën dhe e keni vërtetuar se toka ka probleme dhe nuk është në rregull dhe tani duhet për shpronësim një pronë tjetër, për shkak të këtyre gabimeve që po ndodhin nga ana juaj jo nga ana jonë sepse gjitha ato propozim vendime që i keni sjellë edhe pse kemi debatuar prapë i kemi përkrahur po del që edhe ne po mbesim gabim, edhe ju po dilni keq, kështu që mos më e përsërit në vazhdimësi gabimin e njëjtë unë propozoj që deri ta analizojmë mjaftueshëm këtë material dhe këtë propozim vendim të shtyhet për seancën tjetër të radhës.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, kërkoi nga asamblistët që të mos debatohet deri sa të kalojë kjo pikë e rendit të ditës dhe kërkoi që ta votojë këtë.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan: 20

Kundër: 03

Abstenim: 03

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së datës: 29/11/2018

Sokol Bylykbashi, e kam një vërejtje të vogël, këtu ku flas për çështjen e transparencës, informimit në përgjithësi, nuk po e lexoj krejt por vetëm aty ku nuk e keni cek ashtu siç e kam thënë: por problemi është që qytetaret janë të përjashtuar nga ky aspekt. Nuk e keni cek ashtu siç e kam thënë, unë kam thënë se qytetaret duhet me qenë pjesëmarrës të përfshirë në dy faza ku njëra është konsultative, ku ata janë pjesëmarrës dhe mundësh me i degju dhe e thonë fjalën e tyre, dhe tjetra fazë është ku qytetaret janë spektator ku qytetaret mundën me na përcjell edhe këtu kryesisht edhe përmes mediave.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar:

Për votuan: 26

Kundër: 01

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës
2. Plani i Punës i Kuvendit Komunal për vitin 2019

Beqir Kiqina, sa i përket planit të Kuvendit Komunal, me disa gjera pajtohem por kam disa kërkesa sa i përket këtij raporti të cilat nuk po kryhen, kërkoj nga Kuvendi Komunal jo vetëm nga komuna që t'i merr më mirë parasysh çështjet e komisioneve, e shikova që në planin e punës për këtë vit parashihet se si do të vijnë punët edhe sa i përket raporteve të ndryshme por edhe komisioneve të ndryshme që po formohen në Kuvendin Komunal, kërkoj nga komisioni i formuar në këtë Kuvend Komunal që ka qenë për emërimin ose riemërimin e rrugëve, ai proces nuk ka përfunduar dhe kërkoj që Kuvendi Komunal ta merr për bazë këtë çështje, dhe iu kisha lutur edhe kolegeve opozitar të VIZION-it që një deputet nga VIZION-i ka qenë në komision por pasi që i ka ra me u ndërruar me tjetrin ende KQZ-ja nuk e ka dhënë verditin e tyre, nëse nuk gaboje është në pritje Gëntit Gerguri në komisionin për emërimin e rrugëve dhe kisha kërkuar edhe ata anëtar të cilët janë në komision të kryhen punët nga ky komision sepse ka shumë probleme dhe shqetësime të qytetarëve se emërimi i rrugëve nuk ka përfunduar ashtu siç duhet dhe komisioni nuk e ka kry punën e vet, pavarësisht që është votuar në Kuvendin Komunal. Bëjë kërkesë që formimi i këtij komisioni nga pozita dhe opozita që se paku nga muaji Mars e tutje të dalin në teren dhe t'i rregulloj këto çështje.

Sabrije Kukaj, sa i përket komisionit të rrugëve nuk mundeni me thënë se nuk kanë punuar mirë sepse kanë qenë edhe kryesuesit e secilit fshat bashkërisht me komisionin i kanë zgjedh rrugët. Por sa i përket tabelave nuk janë vendosur sepse për shkak të vonësive të disa këtu në kuvend ka ndodh që donacioni me humb, por rrugët janë të emëruara shumë mirë sepse me kryesi të fshatrave kanë ndodhë gjitha ato emërtime të rrugëve

Florentina Elezi, unë dua të cekim edhe diçka si lloj tradite dhe për shkak të transparencës tani e tutje më na sjellë edhe planin e prokurimit edhe raportin e prokurimit në kuvend që me qenë sa ma transparent, pasi që kjo është edhe mbledhja e fundit e vitit 2018 por kisha kërkuar që planin e prokurimit me na dërguar në email ndërsa raportin e prokurimit për vitin 2019 me na sjellë çdo gjashtë muaj apo siç ta shihni ju të arsyeshme, por është shumë e rëndësishme për ne asamblist të jemi të njohur me të gjitha procedurat.

Sokol Bylykbashi, përveç asaj që e ceku kolegja, kërkoj që në plan të futet edhe raporti i zyrës së brendshme, raporti i auditorit të brendshëm, ne asnjëherë nuk e kemi pas një raport të zyrës së auditorëve të brendshëm, së paku një herë në vit.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovi, plani i prokurimit për vitin 2018 ka qenë në ueb faqe që është zyrtare publike dhe ka mundur më shiku çdo kush si dhe raportet dhe kontratat e lidhura dhe për vitin 2019 nuk mundem me e publikuar raportin e buxhetit pa u votuar në nivel qendror.

Ndërsa sa i përket raportit të auditorit të brendshëm përfshihet në raportin e Kryetarit të Komunës, dhe nëse e gjeni diku që raporti i brendshëm del në kuvend atëherë edhe unë e sjelli.

Florentina Elezi, unë nuk thash që nuk është në ueb faqe por thash që me sjellë në kuvend dhe me diskutuar rreth raportit dhe atij plani. Kërkoj dhe pres me votu.

Sokol Bylykbashi, unë nuk kërkoja me i sjellë 12 raporte por thash që me na sjellë një raport të përgjithshëm që i përfshin të gjitha. Unë kërkoja me pas raportin e brendshëm për arsye se ne jemi monitorues, përveç se jemi organi kryesor jemi edhe monitorues të punës dhe nëse ne nuk i kemi ato raporte si mundemi ne me e monitoru kryetarin dhe jemi më të mangët në monitorimin e punës së kryetarit.

Vehbi Berisha, një pyetje dua ta bëjë për auditorin, nëse e di nuk kemi kufizime ligjore që mundemi me kontraktua një kompani nga jashtë që me e kry atë rol, a kishim mundur ne me kry një gjë të tillë që me e ul koston.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovi, komisionet për emërime nuk ka qenë vetëm një komision, por kanë qenë të paktën tri komisione tre mandate. Ne mungesë të komisionit të anëtarit të vizionit nuk ka qenë funksional komisioni por nga viti 2019 nga janari e tutje të gjitha komisionet kanë me qenë funksional.

Beqir Kiqina, unë kisha kërkuar edhe nga VIZONI për Drenasin deri sa të vjen asamblisti i ri që është në pritje pas ndërrimit me qenë dikush nga ata, që më qenë funksional komisioni në fillim të vitit që po vjen se janë shqetësime të qytetareve dhe nuk po mundemi me ia dhënë një përgjigje adekuate.

Petrit Gashi, ne vet si Kuvend kemi vendos për me qenë Gentrin Gerguri dhe mos prania e tij nuk po mundet me u plotësuar komisioni dhe me qenë funksional, ne si komision kemi mundur me fillu punën, por komisioni pa plotësimin e numrave të anëtareve të përcaktuar nuk është komision funksional, por nëse doni një propozim vendim për ndërrim të komisionit atëherë sjellne propozimin dhe e ndërrojmë.

Beqir Kiqina, është mirë më pas një propozim me ndërru anëtarin e komisionit deri sa të vjen anëtari i ri.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, deri në seancën e radhës besoj se do ta bëjmë një zgjidhje.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar:

Për votuan: 24

Kundër: 03

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:
3. Raporti i punës rreth regjistrimit të planit të integritetit dhe menaxhimit të rreziqeve.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:
4. Propozim Vendim për vazhdimin e dhënien në menaxhim-shfrytëzim të përkohshëm të parkingut të automjeteve që gjendet në hapësirat e stacionit e autobusëve, Shoqatave të dalura nga Lufta.

Florentina Elezi, ne në Komitet kemi marrë vendim se me e sjellë një raport ose një rregullore se sa kanë me qenë tarifa, nuk po e shoh një dokument të tillë.

Lumnije Krapit, dhënia e kësaj parcele është pa kompensim, raporte nuk mundemi me kerku por te hyrat vjetore për një vit kryesisht janë 4450, muaji gusht dhe korrik munden me pas ma shumë të hyra, 1 euro është tarifa 1 ditore në bazë të rregullores.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 21 anëtar:

Për votuan: 20

Kundër: 01

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:
5.Propozim vendim për iniciimin e themelimit të teatrit të qytetit

Beqir Kiqina, sa i përket kësaj pike, për mua personalisht është ndër lajmet ma të mira ose është një propozim ma të mira që do të marrë Kuvendi Komunal, për arsye se komuna e Drenasit nuk ka pas teatër dhe ai të jetë funksional duke pas parasysh që shumë të rinj dhe të reja janë të interesuar të merren me këtë lloj aktiviteti, Komuna e Drenasit ka ngecur rreth kësaj çështje shpresoj që mos të jetë vetëm si iniciim por të përfundohet. Kërkoj që të na sjellin një plan se si e parasheh dhe ndarjen e mjeteve buxhetore nga viti në vit se si do të shkojnë më tutje.

Shqipe Zogu, vota ime do të jetë për, për këtë propozim vendim dhe ato që kanë të bëjnë me avancimin kulturor dhe sportiv në komunën tonë, Drenasi ka nevojë për teatër dhe për muze shpresoj që edhe në të ardhmen do të bëhet edhe iniciimi për themelimin e muzeut.

Vehbi Berisha, përmes këtij dokumenti ne vetëm po i hapin rrugë proceseve ligjore të themelimit të teatrit, sa ishte e mundshme që të njëjtën gjë ta bëjmë edhe për muze, edhe pse nuk i kemi fondet për me ndertu një muze të tillë, por të paktën ta kryejmë atë anën tonë formale që me themeluar edhe muzeun për arsye se është shumë i nevojshëm.

Sokol Bylykbashi, sa i përket themelimit të teatrit në qytetin tonë , është një vendim shumë i mirë dhe e mirëpresim për arsye që plotëson më një atribut shtesë sektorin e kulturës në komunën tonë, komuna jonë në sektorin e kulturës nuk është që nuk ka aktivitete të ndryshme, por është një aset që i ka munguar Komunës së Drenasit dhe e mirëpresim shumë. Nuk mundemi

me qenë shumë të pasur si shoqëri nëse nuk e kemi edhe kulturën e pasur me gjithë ato aktivitete që mundemi me i pas. Ndërsa sa i përket mënyrës se si ka me funksionuar dhe a ka ndonjë plan, por nëse nuk ka ndonjë plan është mirë që me fillu në mënyrë sa ma aktive dhe me ia mundësuar gjithë atyre talenteve që i kemi me zhvillu aktivitetin e tyre, gjithashtu edhe muzeu i mungon qytetit tonë, muzeu së paku i ka dy komponent që na kemi material të mjaftueshëm nga aspekti historik dhe kulturor, dhe reliktet nga mënyra e jetesës që ka ndodhë në të kaluarën dhe mundemi më pas një muze të pasur me këto dy komponentë.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ne po themelojmë një teatro amator, Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit në bazë të rregullores 04/2015 e përcakton se kush është teatro amator, teatro funksional nuk mundemi me bë sepse ato lejohen vetëm në 6 qendra kryesore, dhe këtu nuk bëhet fjalë për teatër profesional por për teatër amator, ne teatër amator mundemi me i ndihmu përmes donatoreve siç i ndihmojmë shumë shoqëri kulturore siç i kemi në Drenas dhe Komoran, siç i ndihmojmë klubet e sportit dhe klubet tjera, dhe në këtë aspekt nuk po kërkohet të votohet teatër profesional.

Sabrije Kukaj, është diskutuar shumë herë ku janë banesat e vogla një katëshe me u rrenu dhe me u ndërtuar një muze, e banoret me u bartë në banesat e komunës, aty kishe me qenë shumë mirë më qenë një muze i ndërtuar

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ne jemi duke e bërë planin zhvillimor të Komunës së Drenasit dhe Planin e hartës kadasrtale kështu që do t'i parashohim të gjitha do t'i diskutojnë, të iniciativa për me themelu një muze është shumë e mirë dhe do ta bëjmë, mjete nuk kemi por duhet ta ndajmë buxhetin, kur ta sjellim propozimin kemi me shqyrtuar mirë do të vendosim së bashku.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan: 26

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:
6. Për ndryshimin e lokacionit për ndërtimin e qendrës edukativo-kulturore, nga parcela 782-0 dhe pjesa e parcelës 768-1, në parcelën Nr.01001-3 në zonën kadastrale në Drenas.

Nexhmedin Balaj, mua më pëlqej ideja kryetarit për ndryshimin e lokacionit të ndërtimit të qendrës kulturore për gra sepse atje ishte në kontest një rrugë mirëpo nuk po më pëlqen ky vend për gra sepse është një vend një reklamë e mirë e qytetit të Drenasit është një vend shumë i ekspozuar dhe në atë vend t'i vendosim një shoqatë të grave kur kemi pas pozita tjera që kemi mundur me i vendos, rast konkret e përmendëm muzeun e qytetit të Drenasit dhe është një vend shumë i mirë për muze dhe është një reklamë e mirë për qytetin tonë, për mua propozim vendimi më pëlqen por nuk po më pëlqen lokacioni, nëse ju e ndërroni lokacionin unë jam në gjendje me prit vetëm të jetë një lokacion më i përshtatshëm por mos të nxihet ajo pozitë aq e mirë e qytetit të Drenasit më një objekt për gra, e kemi një objekt barakat dhe nuk do të kishim penguar për

këtë objekt, e kemi të HANDIKOS-i i Komunës së Drenasit kemi hapësira tjera të cilat mundemi me i shfrytëzuar, ne a duhet vetëm me nderru lokacionin apo duhet me anuluar atë vendim si e kemi marrë me herët pastaj me marr vendim për këtë vendim.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladroveci, vendimi i ri e anulon vendimin e kaluar. Kërkoj ta votoni këtë propozim vendim së është një lokacion shumë i mirë. Kjo qendër do të shfrytëzohet si qendër kulturore për gra të cilat do të zhvillojnë aktivitete të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, të propozim vendimi neni 6 thotë: pas aprovimit të këtij propozim vendimi shfuqizohet vendimi të datës: 25.09.2018 i Kuvendit Komunal me të cilën vendim është miratuar lokacioni i parcelës, çdo vendim i ri e shfuqizon të vjetrin.

Florentina Elezi, a nuk keni mundur para se me marrë vendim për atë token ma herët se kemi votuar me shiku planin rregullues të vitit 2012, ose me shiku atë rrugë, është dashtë me i ditë këto informacione para se me marr ne vendim, se këtu po i bien se dikush është duke bërë këto gabime pa i shikuar punët mirë, nuk keni ekspertë të fushës, dhe shumë vendime po i merrni më shumë emocione dhe vetëm sa me thënë se e kemi kaluar dhe e kemi bërë një punë. Dhe kjo qendër pajtohem me Nexhmedinin se nuk do të thonë me qenë në qendër të qytetit, mundemi edhe diku tjetër me ia dhënë, prandaj vota ime është kundër, arsyeja është se po merrni vendime shumë të ngutshme.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladroveci, para veti e keni hartën dhe e keni me pika ndarjen e pronës se komunës, por ajo lokacion nuk e zënë objektin të cilën e kemi planifikuar me e ndërtuar. Ne kemi marrë një vendim që ka qenë i arsyeshëm por më vonë janë parë defekte tjera. Por unë po kërkoj vetëm me e nderru vendin për me ndërtuar qendrën, kërkoj që ta votoni zonën që e kemi propozuar.

Adem Bucolli, ju bëjë thirrje ta përkrahni këtë objekt, dhe është në vendin e duhur.

Petrit Sinani, në herën e kaluar kur kemi diskutuar unë kam kërkuar që me u verifikuar kjo shoqatë dhe asnjëherë nuk e kam vënë në diskutim ose pikëpyetje më e votu ose jo një projekt të tillë, sipas meje pak rëndësi ka lokacioni të cilën ne vendosim ne sa ka rëndësi ligjshmëria e këtij vendimi, unë jam për ndërtimin e kësaj qendre, sepse është një projekt të cilën po dëtohet për të mirën e këtyre grave, ky propozim vendim është në interesin e qytetareve, por është mirë që ne kuvend mos me na sjellë vendime të ngutshme, prandaj herëve tjera me na sjellë materialin më kohë në mënyrë që secili prej neve më pas mundësi me shiku më kohë. Vota ime është për, për këtë propozim vendim.

Petrit Gashi, unë e dhashë qëndrimin tim qysh në fillim kur u bë ky propozim vendim, ne që nga fillimi kemi kërkuar kohë për këtë propozim vendim edhe për verifikim të asaj shoqate që do ta ndërton por edhe për lokacion, sepse ajo parcelë ka shumë probleme, tani e sjellni një propozim vendim menjëherë në seancë pa diskutuar dhe pa e verifikuar në materialin, ne nuk jemi për mos më e votu këtë propozim vendim por po kërkojmë që ky propozim vendim të shtyhet për seancën e ardhshme në mënyrë që ne me pas kohë me e verifikuar mjaftueshëm materialin dhe ta shohim kërkesën ligjrisht a është mirë për ndryshe nuk do ta votoj.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar:

Për votuan: 19

Kundër: 03

Abstenim: 05

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të Ditës: 7. Të Ndryshme

Sokol Bylykbashi, dua të flas për një çështje që ka të bëjë me blerjen e lendeve djegëse, peletit me prejardhje nga Serbia, nga Komuna Drenasit për nevojat e qendrës kryesore të mjekësisë familjare, kjo blerje është skandaloze, është e papranueshme, dhe është e ndaluar me aktet nënligjore, zyrtar të Komunës së Drenasit a nuk keni dëgjuar kurrë për fushatat sensibilizuese që i kanë bërë institucionet e ndryshme, por edhe Lëvizja Vetëvendosje me moton: Duaje Tënden, për vetëdijesimin edhe institucioneve dhe qytetareve për blerjen, konsumimin e produkteve vendore dhe njëkohësisht bojkotimin e produkteve serbe. Të nderuar zyrtar të Komunës së Drenasit a nuk keni parë kurrë strategji për fuqizimin e bizneseve vendore për rritjen e prodhimit vendor dhe cilësisë së prodhimit vendor, a nuk e keni parë kurrë strategjinë e Lëvizjes Vetëvendosje që ka të bëjë me blerjen dhe përkrahjen e prodhimeve vendore në radhë të parë nga institucionet, në strategjinë e Lëvizjes Vetëvendosje thuhet që: është mirë me fillu institucionet e ndryshme, lokale, qendrore që të funksionojnë në bazë të buxhetit të Republikës së Kosovës, që marrin buxhet nga taksat e qytetareve të Republikës së Kosovës, më fillu që të gjitha materialet gjitha mallrat dhe shërbimet me i ble nga prodhimet vendore. Le të jetë vërejtje dhe mos të ndodhë më kurrë, dhe vitin e ardhshëm gjitha ato mjete që i kemi ndarë sidomos në kategorinë mallra dhe shërbime t'i kenë parasysh dhe zyra e Prokurimit që i bënë këto procedura duhet ta këtë parasysh këtë, le t'i marrë gjitha ato kompani, gjitha ato oferta që vinë në radhë të parë nga prodhues vendor, nëse për ndonjë arsye nuk mundën me gjet mallra nga kompanitë tona vendore atëherë mund të këtë zgjidhje, e kemi Shqipërinë, Maqedoninë apo edhe vende tjera pra ta përjashtojmë Serbinë

Sabrije Kukaj, unë dua t'i ngriti disa çështje që mua dhe qytetaret na shqetësojnë shembull konkret është Lagjja e Re në Drenas që as një rrugë apo diçka nuk është bërë në këtë vit. Tjetra rruga e prishur po kjo rrugë që është të rrethi, është e vështirë me u kalu me vetura dhe është një gropë që e kanë lënë, është një pjesë e dëmtuar shumë, rruga të lagja Qorri sa kërkesa janë bërë dhe nuk është shtruar ajo rrugë. Pastaj rruga në Verboc, unë kam qenë pjesë e hartimit të buxhetit dhe e di për çka janë ndarë 40 mijë euro. dhe ajo rrugë është tmerr një shi më ra ato shtëpi nuk mundën me dal nga ajo rrugë, dhe kanalizimi i lagjes Kastrati nuk është kryer në atë pjesë. Buxheti i mbetur për shkollën e Polluzhes, pjesa e mbetur nuk besoj që është bartë diku tjetër, dhe asnjëherë nuk na kanë sjellë raport për atë.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, tenderin e ka fitu një firmë për pelet në QKMF dhe e ka sjellë paletin në një kategori krejt tjetër që është në procedura të prokurimit, dhe ne nuk i kemi pranuar ato, është vendim i Qeverisë së Kosovës për taksën 100% dhe ne kemi marrë masa dhe nuk kemi pranuar mall me mbishkrimin kundër kushtetutës së Kosovës.

Sokol Bylykbashi, prej që jam asamblist në Kuvendin Komunal, që pesë vite, unë si asamblist udhëhiqem së paku nga 3 parime, parimi kryesor është që jam munduar gjithmonë me fol vetëm për interes të përgjithshëm, unë flas çka shoh, nuk flas çka thonë të tjerët, unë kisha kërkuar me pas kujdes institucionet komunale ose komuna jonë është mirë me ble mallra nga prodhuesit vendor.

Arigon Sinani, dëshiroj para Kuvendit ta shpalosi një kërkesë banoreve të qendrës III, Drenasi II mbrapa gjykatës, banoret e kësaj lagje kanë bërë kërkesë që 6 muaj ndryshimin e koeficientit të pronës i cili aktualisht është 3.5 dhe kërkojnë që kjo të nivelizohet me koeficientin në qendër, prandaj kërkoj nga ju që ta përkrahni propozimin tim për futjen si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovi, nuk kemi të drejte me nderru koeficientin për një lagje.

Edollina Plakiqi, dua ta paraqes një problem që është evident në komunën tonë pasi që punët nuk po kryhen mirë nga Drejtoia e Urbanizmit, rrugët po lihen në gjysmë, në fshatin Nekoc, rruga e Islam Kastratit lagjen Zekaj rruga është lënë në gjysmë për 2-3 metra që nuk është e arsyeshme për 2 ose 3 metra të mos bashkohet me rrugën që ka qenë paraprake, dhe shihet dallimi me rrugën paraprake, gjerësia e rrugës ka qenë më e gjerë ndërsa tani që është shtruar ajo pjesë, asfaltimi i rrugës është më i ngushtë, përse po bëhen këto punë kështu?

Seanca përfundoj rreth orës: 12:20 min.

Proesmbajtëse:

Liridona Fejza-Ajazi




Kryesues/i i Kuvendit

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 18.01.2019, si vijon:

1. Procesverbali i mbledhjes së datës: 13/12/2018.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 6 anëtarë:

Për votuan: 06

Abstenim: 00

Kundër: 00

2. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit janar-dhjetor

Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa u pajtuan që kjo pikë të kalojë për Kuvend

3. Propozim vendim për Aprovimin e Programit Komunal tre vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 6 anëtarë:

Për votuan: 06

Abstenim: 00

Kundër: 00

4. Propozim vendim për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së Organizatave të Biznesit në Komunën e Drenasit.

Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa u pajtuan që kjo pikë të kalojë për Kuvend

5. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, prezantoi dy kërkesa: 1. Kërkesë për lirimin nga taksa komunale për shoqëri tregtare- Ordinanca Stomatologjike. 2. Kërkesë për ndërrimin e emrit të rrugës të fshatit Vuçak.


Janar, 2019



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

12 Nr.060-9706 dt. 20.02.2019



**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
31.01.2019**

PROCESVERBAL

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë:
31.01.2019

Mbledhjen e kryesoi: **LABINOT HALILAJ** – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 28 anëtar

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të datës: 21.12.2018
2. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit janar-dhjetor 2018
3. Propozim vendim për Aprovimin e Programit Komunal tre vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021
4. Propozim vendim për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së Organizatave të Biznesit në Komunën e Drenasit.
5. Raportet e Komiteteve Konsultative për vitin 2018:
 - a. Raporti i Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore.
 - b. Raporti Konsultativ Komitetit për Arsim Rini Kulturë dhe Sport.
 - c. Raporti i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale.
6. Propozim vendim për përkrahjen-subvencionimin e KRM "Pastrimi" SH.A.
7. Të ndryshme

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 31/01/2019 ishin: Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, Përfaqësues të KFOR-it, dhe përfaqësues të OSCE-së, Drejtor të Drejtorive përkatëse, anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të gjithë, hapi diskutimin për rendin e ditës dhe kërkoj nga anëtarët e kuvendit se a pajtohen me këtë rend dite, apo ka ndonjë propozim, dhe pasi që anëtarja e Kuvendit Komunal Shqipe Zogu tani më ka kaluar në pozitën e drejtorisë, grupi i PDK-së a ka vendos për shef të ri ?

Adem Bucolli, ne si grup parlamentar i PDK-së e kemi zëvendësuar shefin e grupit parlamentar të PDK-së që ka qenë Shqipe Zogu dhe tani shef i ri i grupit parlamentar të PDK-së kemi vendos të jetë z. Gani Podrimqaku.

Sokol Bylykbashi, Të nderuar, janë dy arsye që dua të flas sot, arsyeja e parë është se kjo është mbledhja e parë e Kuvendit Komunal për këtë vit, dhe arsyeja e dytë dua t'i shoh vendet si i keni ndërruar dhe pozicionet disa anëtar të kuvendit, meqë ka pas një ndryshim, grupi parlamentar i PDK-së është rrit, pra është rrit pa legjitimitet, ndërsa ne si opozitë jemi zvogëluar, dhe kjo nuk do të thotë se kemi humbur përkrahjen edhe peshën, me numrin e anëtarëve jeni shumicë legale por jo shumicë legjitime, dhe në politikë legjitimiteti është shumë më i rëndësishëm se sa legaliteti.

Kërkoj nga Grupi parlamentar i PDK-së mos lejoni më udhëheq nga arroganca e numrave për shkak se kjo shkakton përplasje, kërkoj që të punojmë në interes të qytetareve dhe mos u udhëhiqeni nga ideja se ne mund të bëjmë çfarë të dojmë.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci, i falënderoj asamblist që iu kanë bashkuar grupit parlamentar të PDK-së.

Gani Podrimqaku, i dëshirojmë mirëseardhje dy drejtoreshave në pozitën e re, e falënderoj Grupin e Kuvendit Komunal për mbështetje dhe përkrahje, mirëseardhje gjithë asamblistëve nga subjektet e tjera. Ne si PDK e përkrahim këtë rend dite dhe kërkojmë që ta hedhim në votim dhe të fillojmë me rendin e ditës.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar:

Për votuan: 23

Kundër: 01

Abstenim: 00

U miratua rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:
1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të datës: 21.12.2018

Pasi nuk pati diskutime dhe vërejtje **Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj**, hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 25 anëtar:

Për votuan: 25

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:
2.Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit janar-dhjetor 2018

Petrir Sinani, Krijimi i raporteve periodike financiare është një mënyrë e mirë e informimit, jo vetëm të anëtarëve apo personave përgjegjës jo vetëm në komunë por edhe një formë e mirë e informimit e gjithë qytetareve, kjo për arsyeje se krijimit i një raporti të tillë tregon gatishmërinë dhe përpjekjet e vazhdueshme drejt transparencës dhe llogaridhënies së parasë publike jep një rezultat me të cilën gjithë qytetaret ndajnë edhe shqetësimet dhe brengat dhe japin edhe sugjerimet e tyre.

Ajo çka unë personalisht dua të rekomandoj Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, se kur bëhen përgatitjet dhe raportet e financave është mirë të këtë organizimin e komunës, dhe çdo raport është mirë me pas: 1. Organegramin e komunës kjo për faktin se këto raporte nuk shikohen vetëm prej nesh, mirëpo shikohen edhe prej gjithë qytetareve, dhe gjithë qytetaret kanë me qenë te informuar se si funksionon komuna në tersi. Po ashtu një raport është mirë me pas : 2. Shtyllat kryesore ku planifikohen investimet fokusi kryesor dhe 3. Adresat e orientimit të qytetareve në mënyrë që kushdo që është i interesuar mund të jap çoftë kritika çoftë sugjerime.

Po ashtu mendoj sa i përket raportit financiar mendoj që është i përgatitur mirë. Mirëpo ajo çka kam shikuar dhe mendoj që është e rëndësishme është ngritja e të hyrave vetanake e cila është 125 % me e madhe së sa planifikimi.

Të gjitha dikasteret kanë bërë një punë jashtëzakonisht të mirë.

Vehbi Berisha, nuk kam ndonjë koment për raportin mirëpo e kam një pyetje:

Të investimet kapitale te Drejtoria e Urbanizmit kemi një prej planifikimit ose alokimit të mjeteve afër 700 mijë euro, këto mjete kanë tepruar, nuk janë shpenzuar, dhe a mundemi më ditë ne, se cilat projekte kanë mbet pa u përfunduar nga lista e projekteve kapitale e vitit të kaluar si mungesë e shpenzimeve të këtyre mjeteve.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, asnjë projekt nuk mbetet pa u realizuar, ato janë projekte me të hyra vetanake dhe asnjë projekt nuk humbet, dhe asnjë projekt nuk mbetet pa u përfunduar, dhe janë projekte që do të zhvillohen gjatë këtij viti.

Sokol Bylykbashi, sa i përket Raportit Financiar të Komunës së Drenasit për këtë vit dua të ndalem në dy çështje të suficiti të Drejtorisë e Urbanizmit, kategoria e investimeve kapitale, e kam shikuar janë afër 700 mijë euro, kjo na zgjon kureshtjen dhe na shqetëson me dit se ato mjete sa janë nga grandet qeveritare, që i bie se janë mundësi e humbur, i kemi pas mirëpo nuk kemi mundur me i shfrytëzu, dhe ato mjete a janë të gjitha grande qeveritare apo ka edhe të hyra vetanake, nëse janë të gjitha grande i bie që shumë projekte në infrastrukturë kanë mbet pa u realizuar. Është mirë më na tregu nëse jo këtë mbledhje, kur te vjen raporti i punës se aty përshkruhen në mënyrë specifike cilat punë janë kryer është mirë me na tregu edhe cilat kanë mbet pa u kry, dhe me bë një ndarje, sa janë grande që na kanë humbur neve.

Të drejtorisë e shëndetësisë tabela 14, të shërbimet e kujdestarisë primare shëndetësore, të mallra dhe shërbime ka një suficit 17.293 Euro, duke e pas parasysh gjendjen në QKMF dhe qendrat tjera varëse të kujdesit primar shëndetësor, duke pas parasysh që mungojnë shumë edhe barna edhe material shpenzues edhe aparatura, suficiti mbetja e këtyre mjeteve është e papranueshme për shkak që nevojat janë të mëdha, sa do që ne ndajmë mjete për shëndetësinë prapë nevojat janë të mëdha. Pse kanë mbet kaq shumë mjete të mallra dhe shërbime të tabela 14?

Petrut Gashi, me një buxhet prej 15 milion Euro dhe me tepër mbi 1 milion Euro është jashtëzakonisht shumë, ndërkohë që në vazhdimësi sillemi si komuna që me se paku kemi buxhet, tash një vit për herë të parë kur kemi fol në seancë ka qenë zotim i kryetarit që vitin e ardhshëm do të ketë edhe me pak mbetje dhe do të ketë realizim të projekteve, në fakt nuk doli ashtu por ndodhi dyfishimi i asaj të vitit të kaluar, dhe të shumë projektet nëpër fshatra nuk janë realizuar apo ato çka janë realizuar janë realizuar keq.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ne kemi arrit që shërbimet të janë 24 orë në QMF në Komoran në shërbim të qytetareve, 17 mijë euro kanë mbet mallra dhe shërbime, kanë mbet tepër prej shpalljeve të tenderëve sepse ato çka janë paraparë ka pas kompani që kanë hy më lirë dhe kanë mbet tepër, nuk kanë tepër mjete këto janë të hyra vetanake dhe prapë i kemi dhe do t'i zhvillojmë gjatë vitit 2019.

Drejtori për Buxhet dhe Financa Shyqeri Bublaku, Raportin Financiar e keni marrë secili nga ju dhe besoj që çdo tabelë ka qenë mjaft e qartë. Përqindja e realizimit këtë vit ka qenë e mirë 92% e shpenzimeve e buxhetit komunal, kjo përqindje në ekonomi është një përqindje e mirë sepse në ligjet ekonomike nëse shpengohet mbi 75 % është një përqindje e mirë, prandaj unë pres nga ana juaj që të jepni vërejtje dhe sugjerimet e juaja dhe në të ardhmen këto vërejtje dhe sugjerime do t'i inkorporoj në raportin financiar.

Petrit Gashi, realizim i buxhetit nënkupton një qeverisje të mirë dhe nënkupton një plotësim të standardeve të jetesës për qytetaret që jetojnë në atë vend.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:
3. Propozim vendim për Aprovimin e Programit Komunal tre vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021

Sokol Bylykbashi, më vjen mirë që një ekip nga komuna nga ekzekutivi ka menduar për çështje të banimit, dhe ka krijuar një dokument që nëse e she atëherë i ka dy pjesë, pjesa e parë është një lloj skanimit i gjendjes edhe sociale edhe në aspektin demografik dhe gjithçka që mundet me të ndihmu dhe me e analizu çështjen e banimit, dihet që në Komunën e Drenasit por edhe në komuna tjera ka varfëri dhe kërkesa të mëdha për banim, për shkak që ka familje që jeton edhe me asistencë sociale, jetojnë në vende ku nuk i plotësojnë as kriteret minimale për banim, paraqesin rrezik e shumë gjëra tjera, dhe kërkesat janë kogja të larta, sa i përket hapave konkret që i ka menduar komuna janë shumë të vogla, përmenden shifra pesë familje për çdo vit duke e pas parasysh kërkesat dhe gjendjen në teren siç është, është shumë minimale. Është mirë se paku nga viti tjetër është mirë me mendu më shumë për aspektin social. Ky është një projekt pozitiv, projekt i mirë por me mendu me bë diçka ma shumë se kjo është shumë minimale. Dhe diçka që me pëlqej që ka me u caktu një zyrtar i banimit për shkak se e ki një zyrtar që merret vetëm më atë punë dhe më pëlqen mekanizmat monitoruese.

Vehbi Berisha, natyrisht se edhe unë e përkrahi këtë propozim vendim se sa mirë me pas një program të tillë se sa mos me pas fare. Ajo çka unë personalisht mu dok mungesë, ka disa sqarime të cilat janë më shumë baza statistikore, se sa diçka që jepet një zgjidhje apo një hapësirë se si me ardh në deri të një mundësi që këta banor të banimit social në të ardhmen e afërt me pas një mundësi me pas një shtëpi të veten, qendra e banimit social në Drenas ka filluar të gemtohet dhe mendoj që këtu tek kjo strategji ka munguar edhe trajtimi e një pike që kishte me ardh si mundësi e bashkëfinancimit me donator të jashtëm, ne vetëm e kemi një mundësi është një shoqatë “Jetimat e Ballkanit” që e kanë bërë namin në gjithë Kosovën duke ndërtuar shtëpi, pse mos me qenë njëra prej pikave se si me ardh deri të një mundësi me nënshkrua një momerandum bashkëpunimi me donator apo shoqata të këtij lloji dhe në të ardhmen e afërt me i selektu kërkesat e këtyre banoreve me pas mundësi me ndertu një shtëpi dhe ata me e liru një vend tek qendra e banimit social. Si program më mirë me qenë se sa mos me qenë fare, dhe vota ime është, për.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ndërtimi i shtëpive nuk behet përmes programit social, përmes programit social i mundësojmë lëvizjen nga një familje që u vendos përkohësisht ne banim social dhe ka bërë zgjidhje të përhershme, ne i kemi 20 mijë euro për subvencionimin e kësaj fushe dhe ne kemi lidh momerandum me shoqatën “Jetimat e Ballkanit” që na me i ndertu 4 shtëpi për këtë vit dhe ata investojnë për çdo shtëpi, dhe i falënderoj shumë të gjithë.

Sokol Bylykbashi, ata banor që janë duke banu në ato banesa a janë vërtet që e meritojnë dhe kanë nevojë për banim dhe a ka ndryshu gjendja e tyre, dhe nëse ka të pashfrytëzueshme a ka me u bë diçka me ato nëse ka të lira mos me i lënë ashtu.

Drejtori i shëndetësisë Arsim Haxhiu, Komuna Drenasit deri më tani nuk ka pasur të hartuar Programin Trevjeçar për Banim prandaj Kryetari e ka nënshkruar një Momerandum mirëkuptimi si dhe ka formuar komisionin komunal me vendim për hartimin e programit trevjeçar për banim për periudhën 2019-2021. Qëllimi i këtij programi tre vjeçar do të mundësoj trajtimin e çështjeve kyçe të identifikuara, siç janë mungesa e banimit adekuat, përkeqësimi i banimit ekzistues etj. Pas këtij programi me punën tonë aktive priten të bëhen ndryshime dhe të krijohet baza ligjore për zgjidhje të qëndrueshme.

Petrit Sinani, ajo se çka neve na brengos se nuk kemi buxhet të mjaftueshëm për përkrahjen e këtyre kategorive, mirëpo para se me thënë këtë është më rendësi të ceket se edhe këtu kur kanë bërë planin e organizatave, dhe kur bëhet një plan është një nder shtyllat kryesore duhet me i pas tri shtylla të cilat ky program që mundet me zbatu e ato janë: që mundet me qenë i zbatueshëm, mundet me qenë i matshëm dhe i monitorueshëm, por kapacitetet të cilat Komuna i ka normalisht që mjetet buxhetore të cilat janë ndarë ekziston e vetmja arsye.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim pikën e tretë të rendit të ditës gjatë votimit prezent ishin 20 anëtar:

Për votuan: 20

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katert të rendit të ditës:

4.Propozim vendim për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së Organizatave të Biznesit në Komunën e Drenasit.

Petrit Sinani, kam biseduar me disa nga subjektet e barnatoreve dhe orari ndryshon vetëm për orarin e barnatoreve dhe jo për biznese tjera, pasi ka pas kërkesë prej këtyre subjekteve,ata e mirëpresin këtë propozim.

Adem Bucolli, disa lëmi tjera të cilat me shkrim nuk kanë pas kërkesë , por më janë drejtuar që me bë një kërkesë që të dielave mos të punohet edhe në këto subjekte dhe të njoftohen me shkrim.

Dhe për kujdestari të barnatoreve kemi ankesa nga shumë qytetar, barnatoret të cilat bëjë kujdestari sidomos vikendeve, të dal një inspektor i komunës sonë dhe t'i monitoron sepse kemi kërkesa dhe shqetësime te qytetareve qe barnatoret nuk po lëshojnë kuponë fiskal sidomos natën dhe i trefishojnë çmimet.

Haka Tahiraj, e kam një pyetje fjala është për ambulanten për fshatin Terdevc, qdo herë tekniku ka punuar ne ambulant por që një vit nuk punon, vjen mjeku një herë ne javë edhe tekniku një herë ne javë ndërsa 4 dit tjera nuk ka teknik, dhe fshati ka nevoj me pas një teknik çdo ditë.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, sa i përket teknikut ne ambulant tani më ligji nuk i lejon qe tekniku me qene pa mjek për shkak të komplikimeve qe munden me i pas pacientet

Sabrije Kukaj, a do të jetë funksionale ambulanca në Negroc?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, jemi duke e përgatit marrëveshjen për ambulanten në Negrov, dhe ne kemi shqetësime për ambulanca nëpër fshatra.

Fitore Morina, gjate ditës se diel si po mbetet orari që ishte deri në orën 14:00, që kanë kërkuar me e heq këtë orar, dhe për festa shtetërore.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, me ligj e kanë për obligim 2 dite ne jave apo 48 orë të lira, prandaj mundemi me vendos a me ia leju me punu ditëve te festave apo jo.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim pikën e katërt të rendit të ditës gjatë votimit prezent ishin 25 anëtar:

Për votuan: 25

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:
5.Raportet e Komiteteve Konsultative për vitin 2018:

- a. Raporti i Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore.
- b. Raporti Konsultativi Komitetit për Arsimit Rini Kulturë dhe Sport.
- c. Raporti i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale.

Sokol Bylykbashi, sa i përket raportit konsultativ për rini kulturë dhe sport, janë disa vërejtje që i kanë dhënë anëtarët e këtij komiteti konsultativ pasi e kuptova se shumica janë mësimdhënës dhe janë dy gjera që i kom parë këtu disiplina neper shkolla dhe mosndëshkimit dhe barra bien mbi drejtoret e shkollave, në bazë të këtij raporti është problem sepse nuk ka as disiplinë e as ndëshkim. Këto raporte është mirë me i pas drejtoritë përkatëse sepse janë raporte që ju hynë ne punë. Për raportin e zhvillimit ekonomik, mbrojtje të ambientit më pëlqyen disa propozime, por nuk e di pse nuk kanë fol për shëndetësi.

Nexhmedin Balaj, unë mendoj se drejtoritë përkatëse duhet me qenë në bashkëpunim vazhdimisht me këto komitete konsultative se kuvendi pikërisht këto komitete i ka themelua rreth problemeve që i ka çoftë në arsim çoftë edhe shërbime tjera. Kur flasim për raportin për Arsim kisha me kritiku më shumë anën e prindërve sepse po mungon bashkëpunimi prind,

mësimdhënës dhe nxënës. Raportet konsultative kanë mangësi por kanë edhe rekomandime të mira për drejtoritë përkatëse.

Sabirije Kukaj, sa i përket raportit për barazi gjinore dhe raportin që po flitet për shkolla në përgjithësi, unë në përgjithësi nuk po e shoh ndonjë raport ku me ditë sa që u dashtë më qenë një raport një vjeçar, të demonstruar me disa fotografi dhe nuk di çka me thënë në lidhje me këto raporte.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:
6. Propozim vendim për përkrahjen-subvencionimin e KRM "Pastrimi" SH.A.

Sokol Bylykbashi, sa i përket këtij propozim vendimi kërkesa e kompanisë "Pastrimi" tregon krizën financiare që është pasojë e krizës menaxheriale, çka mundemi me bë në si Komunë që me ndiku me dergu dikë atje që me ndiku sa do pak, dhe kjo kompani nuk i ka punët mirë dhe po keq menaxhohet.

Petrir Gashi, kur vijnë këso raste për subvencionim të detyrueshëm është mirë që me kërku një raport nga kompania, ne kemi marrë vetëm një vendim të gjykatës, përmbaruesit çfarë i ka ardhë kompanisë por nuk kemi pas një raport të detajuar për me e ditë se në çfarë forme dhe deri ku ka ardhë kjo krizë e kësaj kompanie dhe pse nuk ka kërkuar më herët që me mbështetjen tonë, nuk është e mjaftueshme që vetëm me një vendim të gjykatës përmbarimore ta votojmë një propozim vendim të tillë, megjithatë në bazë të përqindjen po na detyron me votu një propozim të tillë.

Vehbi Berisha, në bazë të kësaj propozim vendimi, ne vetëm po detyrohemi me votu këtë propozim vendim për shkak se gjykata apelit e paska kthyer në disfavor të kësaj kompanie, momerandumi na fuqizon këtë subvencionim të obliguar mirëpo pakënaqësitë e mija për pastrimin janë të shumta dhe aq është injoruese për qytetaret e Drenasit kur bëhet faturimi por nuk iu ofrohet shërbimi, për mbledhjet e radhës drejtoria përkatëse është mirë me e bë një raport sepse gjendjen me të vërtetë e kemi shumë keq në pastrim.

Sabirije Kukaj, edhe unë kam vërejtje sa i përket kësaj kompanie sepse nuk e mbulon komplet terrenin së paku atje ku shkohet me automjet, territori nuk është mirë i mbuluar me kanta të bërllokut është dashtë edhe një herë mirë me i rishqyrtu fshatrat dhe me i mbulu të gjitha.

Adem Bucolli, kërkoj më na sjellë një raport të detajuar të punës të kompanisë "Pastrimi".

Petrit Sinani, ne jemi anëtar të bordit të aksionareve dhe nuk jemi anëtar të bordit i cili merr vendime ekzekutive për kompaninë mirëpo në një far mënyrë jemi monitorues të gjithë procesit dhe normalisht i japim vërejtjet dhe sugjerimet tona. Komuna e Drenasit në bashkëpunim me drejtoreshën që prej mbledhjes së parë kemi dhënë vërejtje jashtëzakonisht të mëdha për kompaninë e pastrimit, aty është buxheti të cilën e kanë keqpërdor në masë të madhe si rezultat drejtori është shkarkuar, dhe kjo ka qenë arsyeja që janë dergu me përmbarues këta qytetar të Drenasit për arsye që ne nuk kemi mundur me iu thënë po atyre shkeljeve. Drenasi ka nevojë për themelimin e një kompanie dhe mendoj që edhe kryetari është i angazhuar për themelimin e një kompanisë komunale, kompani kjo e cila do të menaxhonte edhe sheshin do të menaxhonte edhe rrugët nga bora. Kërkoj që me votu.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, kisha kërkuar me votu këtë propozim vendim. Sa i përket kompanisë a do të behet komunale apo do të jetë regjionale do të vendosim të gjithë kryetaret e komunave se bashku.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës gjatë votimit prezent ishin 25 anëtar:

Për votuan: 22

Kundër: 00

Abstenim: 03

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e Shtatë të rendit të ditës.

7. Të Ndryshme

Haka Tahiraj, e kam një pyetje për një familje në fshatin Terrdevc janë ne gjendje jo të mirë të banimit sepse iu ka djeg shtëpia nese ka mundësi me i ndihmu asaj familje

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, në kemi një bashkëpunim me shoqatën "Jetimët e Ballkanit" dhe me shoqata tjera dhe jemi në shqyrtim jo vetëm për atë familje por edhe familjeve tjera.

Bedri Nika, unë e kam një propozim për emërimin e shkollave në ndërtim që janë, propozoj që shkollat në Fushticë që janë dhe në Shtrubullojë njërës nga këto t'i vihet emri i arkitektit të Pavarësisë së Kosovës Presidentit dr. Ibrahim Rugova.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, çështja e emërimeve vendoset në diskutime publike dhe pastaj përmes edhe fshatrave, unë jam dakord plotësisht me ju në Shtrubulloj kur ta vendosim më ndertu shkollën me e mbajt emrin e Liderit historik Dr. Ibrahim Rugova sigurisht nëse jeni të pajtimit edhe ju.


Adem Bucolli, kërkoj pajisjen me laptop dhe besoj që e kam mbështetjen edhe nga koleget

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, sa i përket laptopave ne nuk kemi planifiku por duhet me shiku

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, kërkoj nga ju asamblast me i kompletu komisionet dhe me fillu funksionalizimin sepse kam shumë shqetësime nga qytetaret sidomos për emërimin e rrugëve


Mbledhja përfundoi rreth orës 12:30 min.

Propagandistëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit


Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 20.02.2019, si vijon:

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj pasi hapi mbledhjen e K.P.F-ca i njoftoi me rendin e ditës ku në këtë rast kërkoj nga anëtarët e Komitetit që këtij rendi të ditës të iu shtohet edhe një propozim vendim: **Propozim vendim për ndryshimin e emrit të projektit për shpenzime kapitale, për të cilën u pajtuan të gjithë anëtarët e K.P.F-ca.**

1. Procesverbali i mbledhjes së datës: 18/01/2019.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtarë:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

2. Propozim vendim për formimin e komisionit për përgatitjen e Rregulloren për Organizimin e punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtarë:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

3. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtarë:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

4. Propozim vendim për formimin e komisionit për çështjet e banimit të përkohshëm social.
Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtarë:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

5. Raporti i punës janar-dhjetor 2018 i Kryetarit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtarë:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

6. Propozim vendim për planin e veprimit për përmbushje të transparencës 2019-2023.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin anëtarë:


Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

7. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, i njoftoj Komitetin për Politikë dhe Financa për skadimin e mandatit të dy Komiteteve Konsultative: Komiteti Konsultativ për Arsime Rini Kulturë dhe Sport dhe Komiteti për zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale.



Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/01 - 15267 dt. 20/03/ 2019

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
27.02.2019**

PROCESVERBAL

**I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë:
27.02.2019**

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 28 anëtar

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të datës së: 31.01.2019
2. Propozim vendim për formimin e komisionit për Përgatitjen e Rregulloren për organizimin e punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit.
3. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba.
4. Propozim vendim për formimin e komisionit për çështjet e banimit të përkohshëm social.
5. Raporti i punës janar-dhjetor 2018 i Kryetarit të Komunës.
6. Propozim vendim për planin e veprimit për përmbushje të transparencës 2019-2023.
7. Propozim vendim për ndryshimin të emrit të projektit për shpenzime kapitale.
8. Të ndryshme

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 27/02/2018 ishin: Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, Nënkryetar i Komunës z. Gani Sylja, Përfaqësues të KFOR-it, dhe përfaqësues të OSCE-së, përfaqësues i shoqërisë civile dhe Drejtor të Drejtorive.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të gjithë, hapi diskutimin për rendin e ditës dhe kërkoi nga anëtarët e kuvendit se a pajtohen me këtë rend dite, apo ka ndonjë propozim?

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 23 anëtar:

Për votuan: 23

Kundër: 00

Abstenim: 00

U miratua rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të datës: 31.01.2019

Pasi nuk pati diskutime dhe vërejtje **Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj**, hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 25 anëtar:

Për votuan: 25

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Propozim vendim për formimin e komisionit për Përgatitjen e Rregulloren për organizimin e punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci, Propozoi:

Laura Vrellaku- anëtare nga ekzekutivi

Hazir Elshani- anëtar nga ekzekutivi

Mehdi Kurrumeli - anëtar nga ekzekutivi

Arben Nika- përfaqësues nga shoqëria civile.

Gani Podrimqaku, propozoi :

Arta Xhylani- anëtare nga kuvendi

Nexhmedin Balaj- anëtar nga kuvendi

Vehbi Nika, propozoi :

Sabrije Kukaj- anëtare nga kuvendi

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, me këtë përbërje të komisionit:

1. Laura Vrellaku- anëtare nga ekzekutivi
2. Hazir Elshani- anëtar nga ekzekutivi
3. Mehdi Kurrumeli - anëtar nga ekzekutivi
4. Arta Xhylani- anëtare nga kuvendi
5. Nexhmedin Balaj- anëtar nga kuvendi
6. Sabrije Kukaj- anëtare nga kuvendi
7. Arben Nika- përfaqësues nga shoqëria civile.

Gjatë votimit prezent ishin 27 anëtar,

Për votuan: 27

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba.

Egzona Jetullahu Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik, propozoi:

Shehrije Mustafa-anëtare nga ekzekutivi
Hambi Krasniqi- anëtar nga ekzekutivi
Ruzhdi Lestrani- anëtar nga ekzekutivi
Visar Gashi- përfaqësues nga shoqëria civile.

Gani Podrimqaku, propozoi:

Hamit Kastrati- anëtar i kuvendit
Petrir Sinani- anëtar i kuvendit

Petrir Gashi, propozoi:

Burim Bujupi- anëtar i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, me këtë përbërje të komisionit:

1. Shehrije Mustafa-anëtare nga ekzekutivi
2. Hambi Krasniqi- anëtar nga ekzekutivi
3. Ruzhdi Lestrani- anëtar nga ekzekutivi
4. Hamit Kastrati- anëtar i kuvendit
5. Petrir Sinani- anëtar i kuvendit
6. Burim Bujupi- anëtar i kuvendit.
7. Visar Gashi- përfaqësues nga shoqëria civile.

Gjatë votimit prezent ishin 28 anëtar:

Për votuan: 28

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Propozim vendim për formimin e komisionit për çështjet e banimit të përkohshëm social

Arsim Haxhiu Drejtor i shëndetësisë, propozoi:

Lumturije Kiqina-anëtare nga ekzekutivi
Besart Bajrami- anëtar nga ekzekutivi
Jeton Prokshi -anëtar nga ekzekutivi
Jetmira Morina- përfaqësuese nga shoqëria civile.

Gani Podrimqaku, propozi

Naim Xheli- anëtar i kuvendit

Elmi Shala- anëtar i kuvendit

Vehbi Berisha, propozi:

Beqir Kiqina- anëtar i kuvendit

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, me këtë përbërje të komisionit:

1. Lumturije Kiqina-anëtare nga ekzekutivi,
2. Besart Bajrami- anëtar nga ekzekutivi,
3. Jeton Prokshi -anëtar nga ekzekutivi
4. Naim Xheli- anëtar i kuvendit
5. Elmi Shala- anëtar i kuvendit
6. Beqir Kiqina- anëtar i Kuvendit
7. Jetmira Morina- përfaqësuese nga shoqëria Civile

Gjatë votimit prezent ishin 28 anëtar:

Për votuan: 28

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Raporti i punës janar-dhjetor 2018 i Kryetarit të Komunës.**

Sokol Bylykbashi, kur flasim për raportin një vjeçar të Kryetarit të Komunës, duhet t'i kemi parasysh gjithë ato punë që janë bërë, por dua të fokusohem të disa çështje, kur kemi diskutuar në Kuvend Komunal për raportin financiar kemi thënë se ka një suficit prej 700 mijë euro, suficit për të cilin dihet që shumë projekte kanë mbet pa u përfundu, dhe atëherë kemi kërkuar që kur të vjen raporti i punës me përshkru edhe këtë suficit, me tregu se çfarë ka mbet pa u kry, po e them këtë për arsye se kur themi raporti i punës duhet me iu përmbajt edhe mos punën, e kur them mos punën e kam fjalën për deficitin që kanë mbet, dhe nuk e di saktë as sa është raporti në mes të hyrave, 700 mijë, sa janë të hyra-vetanake dhe sa grande, këtë nuk e dimë, dhe cilat projekte kanë mbet të grandet. Kur të flasim për diçka që ka mbet dhe nuk është kry për mua është dështim. Ky raport nuk e përmban mos punën. Ka edhe projekte kapitale që kanë filluar vitin e kaluar për arsye se Kuvendi Komunal e ka votu buxhetin që ato projekte kapitale me u kry, po nisem nga fshati

im, kur e kam fjalën për projektet që kanë filluar dhe nuk kanë përfunduar, e që është dashtë me i përfundu, dhe është mirë me tregu pse nuk janë përfundu, dhe si do të përfundojnë tani, edhe nga aspekti financiar. Aneksi i qendrës së mjekësisë familjare në Terstenik ka filluar mirëpo nuk është përfundu ende dhe është mirë me dit pse nuk ka përfunduar ende?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ne jemi të detyruar me ligj me bë raport të punës brenda një viti, jo mos punës.

Petrit Gashi, pasi që kryetari e ceku se duhet me u përfshi vetëm punët që janë bërë, unë ia kisha dhënë një këshillë të sektori i arsimit me përshkru edhe punën që e ka bërë mbylljen e tri shkollave, por kur jemi të mos puna keni thënë që ka me u përfundu qendra e mjekësisë familjare në Komoran dhe nuk ka përfundu, por edhe funksionalizimi i qendrës QMF-së në Negroc dhe nuk ka përfundu, ka thënë që ka me u bërë edhe zyra e vendit në Arllat, ajo është jo funksionale, keni thënë që keni me kriju klimë të mirë për biznese dhe e kam prit këtë raport të punës me e përshkru se sa biznese apo sa investitor të huaj kanë ardh në Kosovë, por në fakt i keni mbyll bizneset, e keni bërë punën në të kundërtën e asaj që e ka prit qytetari i Drenasit, nuk ka kriju klimë të mirë për biznese.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, qendra e mjekësisë familjare në Komoran nuk mundet me u përfundu për një vit kur është projekt 3 vjeçar.

Petrit Gashi, është mirë që me u kriju klimë e mirë investuese për të gjithë ata që dëshirojnë me investu në Drenas, për dy vite të mandatit tuaj në asnjë investitor të huaj nuk e keni sjellë në Drenas.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, klima në Drenas është vetëm brenda ligjit, mjaft më jashtë ligjit, dhe pa ligje nuk ka me punuar askush në Drenas, gjithçka në Drenas behët vetëm me ligj dhe brenda ligjit.

Sabrije Kukaj, mbledhjen e kaluar kur patëm fol për buxhetin u tha që janë 700 mijë suficit, por janë prej të hyrave vetanake, faktikisht doli që 424 mijë janë projekte kapitale që kanë mbet pa u realizu. Këtu nuk jemi vetëm për me kritiku por me dhënë propozime dhe me gjet zgjidhje ndoshta kish qenë mirë edhe mbledhjen e kaluar por edhe këtë mbledhje me tregu në cilat drejtori kanë mbet projekte pa u përfundu dhe mjetet që janë marrë për shkak të mos kryerjes të punëve, a është fajtor procedurat a puna e mos drejtorive apo çka është çështja, se ndoshta edhe ne kemi gabuar kur kemi ndarë buxhet që ne të ardhmen me mendu pak më mirë për projekte për ndarje të buxhetit ku mund të realizohet dhe nuk

mbesin suficit, ku munden me u kry dhe mos me u kry punët, prandaj ka qenë mirë më na sjellë cilat projekte kanë mbet pa u pa u kry dhe në cilat drejtori?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, jeni duke fol për grande qeveritare sigurisht jo për projekte kapitale se projektet kapitale nuk kanë humb dhe nuk humbin, ato grande nuk kanë humb sepse projekti i ujërave të zeza në Polac-Drenas është duke u zhvillu dhe do të zhvillohet, nuk na kanë humb.

Beqir Kiqina, sa i përket transparencës të këtyre gjerave dhe raportit të kryetarit për vitin e kaluar dhe për transparencën në përgjithësi, nuk e di çfarë transparence kur mungon transmetimi i seancave, janë incizimet tejet të dobëta, pastaj mbyllja e shkollave, nuk është transparente me i mbyll shkollat, nuk është transparente kur Drejtoria e Urbanizmit mos me i kry punët psh. në Nekoc ka shumë punë, kur edhe ne seancën e kaluar e kemi përmend për 6 ose 7 metra e ka lënë një projekt pa u përfundu e shumë gjera të tjera.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, sa i përket transparencës, nuk ka grand qe i kanë dhënë dhe nuk e kemi fituar.

Vehbi Berisha, ajo se çka deshta unë me theksu është njëra nder fushat qe zakonisht është më e prekshme për qytetarët, dhe unë personalisht nuk kom pa dallim në fushën e shëndetësisë prej asaj ditë që nuk ka qenë kryetari dhe prej asaj që ka ardh, nuk e kam vetëm me kritiku mirëpo realisht gjendja në shëndetësi për mua personalisht ka qenë gjithmonë shqetësuese, kam shkuar edhe vet për shërbime shëndetësore ku vazhdimisht kam parë probleme, radhë të gjata në korridoret e QKMF-së në Drenas, i kam parë disa organizime që disa mjek i kanë dergu nëpër fshatra, dhe ata mjek nuk kanë pas punë, për arsye se fluksi i madh i pacientëve është në Drenas, konsideroj që ka një keq menaxhim krejt çka kemi mundur me bë, nuk kemi mundur me stabilizu menaxhimin cilësor në shëndetësi, këtë duhet ta pranojmë të gjithë sepse kemi dobësi të menaxhim shëndetësor në Drenas, dhe është njëra ndër pikat kyçe që po lëngon komuna jonë dhe shëndetësia në Drenas nuk është duke lengu për arsye të mungesës se hapësirës se ka objekte mjaft moderne por ka probleme me pajisje ka probleme edhe me inventar përçjellës dhe pajisje medicinale shëndetësore, kemi pas probleme të vazhdueshme me rëntgenin, dhe me shqetësuese ka qenë kur ne repartin e gjinekologjisë kanë qene vetëm motra kujdestare eventualisht dy motra.

Komuna e Drenasit duhet të reflektoj sidomos në aspektin e shëndetësisë, deri më tani keni provuar me të gjitha metodat e rregullimit të infrastrukturës, pak ma shumë ta leni anash infrastrukturën dhe të fokusoheni në shëndetësi tek menaxhimi

cilësor, tek organizimi i stafit dhe tek pajisjet, është koha e zhvillimit teknologjik që duhet të pajiset edhe QKMF-ja me të gjitha aparatet e nevojshme.

Si pikë tjetër që e kam vërejtur pastrimi i rrugëve këtë vit nuk ka qenë cilësor pastrimi i rrugëve .

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, në QKMF e në gjinekologji e kemi vetëm një doktor, ka mungesë të doktorëve dhe numrit të mjekeve në komunën tonë. Sa i përket që nuk ka pas ndryshim në shëndetësi, ka pas ndryshme , sepse shërbimet në QKMF në Drenas dhe Komoran janë bërë 24 orë por edhe orarin e mjekeve nuk e kemi më deri 18:00 por e kemi deri në ora 21:00 shërbim i rregullt, dhe emergjenca që punon 24 orë.

Nexhmedin Balaj, me vëmendje i dëgjova të gjithë parafolësit dhe ajo që më preku më së shumti ishte fjalim me ven që foli kolegu Vehbi Berisha sepse gjendja në shëndetësi është si është por nuk është pasoj e kësaj qeverisje, është pasoj që janë grumbullu problemet aty dhe duhet t'i qasemi problemeve drejt, desha me qenë shumë objektiv për këtë raport sepse është një raport shumë voluminoz një raport i përshkrimit i çdo pune që është kry me statistika me shifra, me rrënime, me leje të punës, me vizita mjekësore , me vizita specialistike me të gjitha, edhe në arsim, raporti i punës paraprakisht nuk ka ardh asnjëherë në këtë mënyrë siç ka ardh tani, me përshkrim dhe po asnjë gabim gjuhësor me një dizajn shumë të mirë, ne duhet të nisemi nga ajo që është më e mirë dhe ta synojmë të mirën, kurrë nuk duhet të kënaqemi këtu ku jemi, po ndërlihem me fjalimin e Vehbiut, kur kemi qendru në seancë në votimin e buxhetit kam qenë pjesë e opozitës dhe kam qendru dhe e kam kundërshtu, kom thënë që nuk mundem me votu një buxhet i cili nuk parasheh asnjë pajisje për shëndetësi me ble, dhe kush është fajtor këtu a është kuvendi apo drejtori, në atë raport financiar e kemi shiku që kemi me pagu vetëm një mjek specialist gjinekolog, në atë raport i kemi parë që i kemi 10 mjek specialist të mjekësisë familjare dhe nëse logojnë shërbime për qytetaret edhe në Drenas edhe në Komoran atëherë pjesëtohen ata mjek dhe na nuk mundemi me i angazhu jashtë orëve që e parasheh kontrata për një mjek, dhe na jemi kuvendi që mundemi me ia lehetesë punën e ekzekutivit, po të kishim vendos në për pajisje shëndetësore sot, rëntgenin, ultrazërin e shumë pajisje tjera që do të ishin në Drenas, në të njëjtën kohë e kam kundërshtuar edhe në arsim, nuk mundemi me akuzu drejtorin e DKA-së për cilësi në arsim, se nuk po ka cilësi në arsim kur mësuesit tanë sot në arsim ende punojnë vetëm me një shkumës dhe një table të zezë dhe nuk kanë kurrfarë mjete konkretizuese tjera kjo ka qenë brenda meje që kam abstenuar dhe kam thënë që nuk mundem me votu, kundër nuk mundem me votu por edhe për nuk mundem me votu për hir të qytetarit që nuk i ka këto specifika që po i ceki, të bëhemi konsekuent dhe të shikojmë përpara çka mundemi

me ndryshuar vitin e ardhshëm që ekzekutivi të ketë kushte më ta mira për me i menaxhuar situatat e caktuara.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, unë kam thënë që do t'i bëjë tri gjera për komunën, funksionalizimin e rëntgenit të cilën e kemi bërë, ultrazërin kemi thënë që do ta bëjmë dhe e kemi bërë, mamogramin kemi me e fituar prej qeverise japoneze dhe besoj që drejtori i shëndetësisë është duke punuar dhe duke e funksionalizon çdo drejtim çdo aspekt.

Petrit Sinani, sa i përket raportit të punës janar-dhjetor 2018 të kryetarit, mendoj që disa koleg nuk e kanë lexuar këtë raport, kjo për faktin që raporti i kryetarit është mirë me ditë secili prej neve se nuk i behet nje analize e cila i paraqet edhe mangësitë edhe dorësit, por u behet një analizë e cila i paraqet punët e kryera dhe disa drejtori në raport i kanë paraqitur edhe vështirësitë e tyre, psh. Të drejtorja e infrastrukturës ka thënë: që jemi munduar të japim prioritet projekteve te mbetura në gjysme dhe disa projekteve që kanë qenë të domosdoshme, dmth kanë treguar se ku i kanë pengesat dhe vështiruesit, drejtorja e arsimit e ka tregu pengesat e vështirësisë, kjo tregon që disa nga koleget nuk e kanë lexuar raportin. Sa i përket qendrës kryesore të mjekësisë familjare në Drenas mendoj që ka përmirësime të dukshme, sot nëse shkon të mjeku t'i merr të dhënat dhe i fut ne sistem dhe herëve tjera nëse shkon e ka një pasqyrë ma te mirë, kjo duhet me u përshëndet prej të gjithëve sepse është një projekt i cili duhet me u përshëndet nga të gjithë.

Arta Xhylani, kam një koment për Drejtorinë për Planifikim Urban, nëse ju i shkruani pengesat dhe vështirësitë dhe aktivitetet, kur i shkruani aktivitetet tregoni që keni pas takime me përfaqësues evropian për emërtimin e rrugëve dhe për numërimet e rrugëve në gjithë territorin e Drenasit, sa i përket pengesave dhe vështirësive u dashtë me cek që Komorani nuk ka numra neper objekte qofte të banimit apo bizneseve.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ne i kemi formu komisionet për emërtim të rrugëve por në pritje të z. Gerguri dhe ju kisha ftuar që me e funksionalizuar këtë komision dhe kur KQZ-ja ta certifikon z. Gerguri me ia liru vendin ai i cili do ta caktojme për me qenë ky komision funksional sepse jemi mbrapa.

Sabrije Kukaj, buxhetin e vitit të kaluar, se Komiteti për Politikë dhe Financa nuk ka mendu me nda buxhet dhe as ne kuvend kemi harruar me cek kështu që vitin e kaluar nuk ka pas buxhet dhe për këtë arsyeje kemi mbet mbrrapa për emertim e numrave dhe emrave.

Bedri Nika, ne e kemi një raport të punës janar-dhjetor, 2018 të Kryetarit të Komunës dhe është prej 60 faqeve, dhe është për çudi që asnjë nga ne nuk e kemi asnjë vërejtje në asnjë rresht të 60 faqeve që është shkruar dhe nuk është kry një punë nga kryetari dhe është raportuar gabimisht apo vetëm e ka përshkru ne raport, unë dua t'i përgëzoj për këtë raport edhe kryetarin edhe stafin e ti, që për herë të parë po vjen një raport i punës prej 60 faqeve të detajuara për punët e kryera, dhe ne po flasim për punët e pakryera, punët e pakryera nuk është punë e pushtetit me bë raport për punët e pakryera, ne e kemi obligim në të ndryshme me bë një raport për punët e pakryera, këtu janë të pasuruara punët e kryera dhe unë dua ta përgëzoj kryetarin për një raport me te vërtetet voluminoz dhe dua ta përgëzoj edhe Komunën e Drenasit që komuna e Drenasit për herë të parë merr titullin Komuna më transparente nga të gjitha komunat tjera. Ne rast për një vjet pune mund të flasim për një afërt korruptive atëherë ne kemi çka të diskutojmë, por unë nuk po shoh dhe nuk ka asnjë nga ne dhe as nga qytetaret.

Burim Bujupi, e kemi lexuar raportin dhe kemi te meta që ka shumë, ka mundur me qënë edhe me i mirë psh. Të Drejtoria e Urbanizmit të infrastruktura i ka cek projektet kapitale që kanë përfunduar mirëpo ka mundur me cek psh. sa metra asfalt janë shtruar nëpër fshatra të ndryshme ne cilën lagje. Ka të meta edhe te Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport të ndarja e subvencioneve që është berë nuk është cek të cilat klube kanë shkuar për arsyeje se mbi 60% e subvencioneve kane shkuar vetëm të një klub ndërsa klubet tjera kanë marrë shumë pak, janë disa gabime teknike të Drejtoria për Bujqësi, ku është të shpëzëtaria që subvencionohen në bashkëpunim më ministrinë nuk është 50 cent për kokë të pulës por është 40 cent edhe për fëllënza është njëjte. Në raport mungon edhe “merita” e Drejtorit të Arsimit për mbylljen e tri shkollave, Për fshatin Arllat transporti i nxënësve nuk po behet apsulisht kurrqysh, po i shikoj fëmijët duke prit nga dy orë kushtu që nuk po e merrni asnjë hap.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, sa i përket subvencioneve, për klube private nuk e kemi obligim me i subvencionuar, ndërsa sa i përket mbylljes se shkollave , ne nuk i kemi mbyll shkollat por i kemi fuzionu shkollat.

Nexhmedin Balaj, unë aludova, thash kom pas dëshirë me qenë me një pozitë ku kam mundur me lindu këtë raport, por për hir të korrektësisë nuk desha ta lëvdoj këtë raport edhe pse ka shumë të mira, por po i bejë 9 vite në asamble dhe asnjëherë një raport më të kompletuar, më të detajuar dhe të shkruar mirë pa asnjë gabim drejtshkrimor, unë nuk kam parë.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për planin e veprimit për përmbushje të transparencës 2019-2023.**

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, plani i veprimit për përmbushjen e transparencës në komunë për vitin 2019-2023 është Komuna e Drenasit që ka me e aprovu më së shpejti, menjëherë pas udhëzimit që na ka dergu MAPL-ja. Ju ftoj që na votoni. E falënderoj z.Bekim Dobra për planin e veprimit që e ka bërë.

Pasi nuk pati diskutime tjera dhe vërejtje **Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj**, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 27 anëtar:

Për votuan: 25

Kundër: 01

Abstenim: 01

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7.Propozim vendim për ndryshimin të emrit të projektit për shpenzime kapitale.**

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, kjo është vetëm një ndryshim i emrit të projektit për shpenzime kapitale, ju ftoj që ta votoni, sepse ne do të vendosim kamera edhe ne Komoran ndërsa në projekt e kemi në qytetin e Drenasit, është fjala për mirëmbajtjen e kamerave në qytetin e Drenasit dhe zgjerimi i rrjetit dhe mirëmbajtja e kamerave në Komunën e Drenasit jo në qytetin e Drenasit.

Sokol Bylykbashi, sigurisht që shtrirja e rrjetit të kamerave publike ndihmon shumë në sigurinë publike dhe është mirë edhe në Komoran si qendër e madhe me pas këtë sistem, por edhe Drenasi me u zgjeru në hapësirat publike, por shqetësim mbetet monitoruesit, ne e dina që monitorues është policia por mundësit janë edhe për keqpërdorim, kjo është edhe shqetësim.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 26 anëtar:

Për votuan: 26

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Të ndryshme**

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, sqarim, deri më tani ka qenë shqetësim i mos plotësimit të anëtarit të komisionit të rrugëve ne mungesë të z. Gerguri, unë kisha propozu që me shku me këtë ndryshim, ne urojmë që kjo çështje të zgjidhet, por nuk mundemi me prit më gjatë këtë zëvendësim, kisha kërkuar që me u bë një propozim vendim dhe me u be ndryshimi i z. Gerguri me propozimin e ri.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ligjërisht duhet me shkarku atë që e zënë vendin e tij dikush tjetër, nëse doni me plotësu me Gentritin në të ardhmen.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, kisha propozu që seancën e radhës me qenë si pikë e rendit të ditës.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, edhe një sqarim, i kemi dy komitete konsultative që iu ka skadu afati, Komiteti për kulturë Rini dhe sport, dhe komiteti për zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit, e bëjmë një propozim vendim për këto dy komitete për seancën e radhës.

Edolina Plakiqi, kam një kërkesë për Drejtorin e Arsimit që të marrë masa për të gjithë profesorët e shkollat e mesme që t'ia ndaloj mbajtjen e kurseve private për arsyje që po i detyrojnë nxënësit për me shku me i mbajtë kurset për një not më të mirë, ose për ndryshe ka shumë raste që mbesin në provim ose nuk munden me marr një not që ju duhet për sukses, kisha kërkuar që me marr masa sa më shpejt për ata profesorë.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, nëse din cili profesor duhet me tregu sepse ne nuk e dina kush mban kurse private, ju lutem që të kemi një bashkëpunim dhe kudo që dini na shpjegoni dhe ne konform ligjit veprojmë.

Edolina Plakiqi, drejtoret e shkollës ata tregojnë cilët janë ata profesorë dhe qfar kurse mbajë.

Nexhmedin Balaj, është faktike që disa profesorë mbajë kurse jashtë procesit mësimor mbajnë, por ne duhet me u konsultuar mirë me ligjin, sepse ata dhanë mësim psh. Një shkollë të gjuhës angleze dhe ai lidh kontratë me atë shkollë dhe drejtori i arsimit nuk guxon me pengu një kontratë shtesë sepse ligji ia lejon, këtu duhet me specifiku saktë a ka kurse ilegale private, të cilat mbajë mësuesit e caktuar, nëse shkolla është e regjistruar dhe ka lidhë kontratë me një mësimdhënës nuk mundemi më sanksionuar, por konsultohu me ligjin dhe shikoj veprimtaritë të cilat po i zhvillojnë.

Kimete Bardhi, unë e kam një kërkesë prej banoreve të fshatit Gradice ma konkretisht banoret e lagjes Saliuki dhe Muja, ata po kërkojnë ata po kërkojnë një pronë me shfrytëzu për varreza, ndërsa pronën që janë përcaktu ata është shkolla që ka qenë më herët ajo pronë ishte pronë shoqërore, a kishim mundur me ia lejuar atë pronë?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, se pari ata duhet me sjellë kërkesë më shkrim dhe me iu mundësi tjera dhe jo me dhënë pronën e shkollës ka zona publike tjera të cilat mundemi me i dhënë dhe jo oborrin e shkollës.

Arigon Sinani, pasi pranova disa kërkesa nga qytetaret e komunës është që të filloj zbatimin matës i komestacionit në komunën tonë, zbatimin i masës së komestacionit ka filluar në vitin 1983 dhe pjesërisht ka përfunduar në vitin 1988 edhe pse shumë punë janë kryer ende kanë mbetur pa u përfunduar edhe shumë ngastra dhe familjet të cilët nuk i shfrytëzojnë pronat e tyre as në gjendjen e komestacionit as pas, kurse në vitin 2014-2016 Ministria e Bujqësisë ka formuar një komision i cili realisht nuk po shihet që ka zgjedhur deri më tani problemet në teren, po e theksoj se për mungesë e dokumentacionit, qytetaret respektivisht pronaret e këtyre pronave nuk po kanë mundësi t'i realizojnë grandet dhe subvencionet në bujqësi që ndahen nga Ministria e Bujqësisë.

Po ashtu theksoj se shtati i lumit Drenica shtrihet në pronën e qytetareve, përderisa sipas projektit shtrati i lumit në fjalë duhet të zhvendoset dhe të behet në pronat e dedikuara, kjo zonë fillon nga zona kadastrave në Nekoc deri afër gurit të

plakës, ne si përfaqësues të qytetareve të Drenasit jemi të obliguar të ngritim zërin për këto probleme që i kanë tash që 40 vite. Nga këto arsye i propozoj kuvendit të formoj një komision në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Gjeodezisë dhe agjencisë kadastrale dhe të marrë të gjitha masat për përfundimin dhe zgjedhjen kontestuese që kanë qytetaret tanë dhe të pajisen me këto dokumente përkatëse.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ne e kemi ngrit këtë shqetësim edhe ne nivel qendror edhe ne Ministri të Bujqësisë, ky komision nuk e ka përfunduar punën e vet sepse zyrtarë të komunës sonë kanë dhënë dorëheqje, Ministria e ka pagu kompaninë e cila ka qenë duke u marrë me këtë punë dhe besoj që është çështje do të rregullohet. Sa i përket Grandeve në Bujqësi unë besoj që iu kanë dhënë qasje apo dokumentacione dhe besoj që nuk kanë pas problem në dhënien e vërtetimeve për grande në bujqësi.

Hamit Kastrati, duke pas parasysh se fshati Nekoc është nder fshatrat me të mëdha në Komunën e Drenasit, kam një kërkesë për ndërtimin e një palestre sportive në oborrin e shkollës, pasi që shkolla jonë ka nevojë për këtë objekt, fusha sportive nuk i plotëson kushtet se aktivitete në të mund të zhvillohen vetëm kur është koha mirë, pasi të prishet koha nuk mund të zhvillohet asnjë sport, fshati Nekoc e pret këtë investim nga Kryetari dhe Drejtoresha e Sportit që ta marrë këtë hap.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ky është një shqetësim i drejt por kemi problem me palestër edhe në shkollën e gjimnazit që i ka mbi 1000 nxënës e prej që është ndertu shkolla është paraparë që me u ndertu edhe palestra, të premtoj se do të bëjmë përpjekje për këtë çështje.

Sabrije Kukaj, sa i përket kurseve komuna më ia mundësi që të organizojnë kurse dhe fëmijët tanë t'i ndjekin këto kurse. Dhe çështja tjetër çështja e ujesjellsit a është gati me u mbush bazeni me ujë dhe a është gati rrjeti për fshatrat, Verboc, Polluzhe, Terstenik dhe për disa fshatra tjera.

Idriz Hysenaj Drejor për Infrastrukturë Lokale, projekti është në vazhdim e siper, pompat i kemi montuar, trafo janë në proces dhe brenda këtyre muajve besoj që do ta mbushim rezervarin me ujë, me vendosjen e trafos hyn ne funksion pompat dhe mbushet rezervari me ujë, dhe janë 22 fshatra që do të furnizohet nga ai rezervar. Me 15 mars fillojnë punimet zyrtarisht dhe jemi para përfundimit të këtij projektit.

Petrit Gashi, unë i kam dy kërkesa, ndërsa njëra është seanca e tretë po e përsëriti, njëra për Drejtorinë për Shërbime dhe Emergjencë, për rrugën “Burim Gashi” që të paktën më bë të kalueshme me zhavor, dhe rrugën “Shqiponja” në Llapushnik ku frekuentojnë 57 nxënës të shkollës fillore dhe 19 të shkollës së mesme, faktikisht këto dy rrugë ne i kemi rinovu vet me vetëfinancim të fshatit në vitin 2016, por për shkak se e kemi vendos rrjetin e kanalizimit ajo pjesë ka mbet jashtëzakonisht keq, dhe është pjesa më e frekuentuar e nxënësve që shkojnë në shkollë.

Beqir Kiqina, kërkoj nga Drejtoria e Urbanizmit që në fshatin Baicë, tek rampa e Baicës lidhen tri lagje dhe po kanë problem banoret në atë pjesë, kërkojmë një pasqyrë reflektuese për atë pjesë.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, pasqyrën do ta vendosim, dhe kjo është në kuadër të drejtorisë të shërbimeve publike.

Vehbi Berisha, kam një pyetje për tatimin në pronë, tani i kemi marrë faturat e reja të tatimit në pronë, se kur është miratuar rregullorja prej 1 janari ka qenë e parapame me u tatimu edhe parcelat tjera te tokës, mua personalisht nuk më ka ardh fatura vetëm e tatimit në pronë por jo edhe parcelave tjera, nuk e di a është ky fenomen vetëm në fshatin tonë apo në përgjithësi.

Shyqiri Bublaku Drejtor për Financa, është problem në tërë komunën e Drenasit për shkak se regjistrimi i pronave nuk është kry ende, dhe po kemi probleme ne të gjitha fshatrat jo vetëm tek ju.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30 min.

Procesmbajtëse:

Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 19.03.2019, si vijon:

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj pasi hapi mbledhjen e K.P.F-ca i cili njoftoi me rendin e ditës ku dhe ceku se kemi dy propozime shtesë: Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake, dhe propozim vendim për formimin e ndërmarrjes publike, nga ish NP"Kosova Trans", në ndërmarrje Publike Lokale, Stacioni i Autobusëve- Gllogoc, Shoqëri Aksionare.

Të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan ku votuan:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

1.Procesverbali i mbledhjes së datës: 20/02/2019.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës me ndryshime, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtar:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

2. Propozim Vendim për Aprovimin e Programit Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021, i plotësuar.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtar:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

3. Propozim Vendim për plotësimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtar:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

4. Propozim Vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim , Kulturë Rini dhe Sport.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtar:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

5. Propozim Vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtar:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

6. Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin anëtar:


Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

7.Të ndryshme.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, njoftoi K.P.F-ca se në mbledhjen e Kuvendit do ta sjelli edhe një propozim vendim shtesë.


Kryesuesi i Kuvendit

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

Nr. 060-20905 dt. 18.04.2019



**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
27.03.2019**

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë:
27.03.2019 në sallën e Kuvendit Komunal

Mbledhjen e kryesoi: **LABINOT HALILAJ** – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 28 anëtar

Kuvendi filloi punimet më këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 27.02.2019
2. Propozim Vendim për Aprovimin e Programit Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021, i plotësuar.
3. Propozim Vendim për plotësimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit.
4. Propozim Vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport.
5. Propozim Vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
6. Propozim Vendim për rritjen e të hyrave vetanake nga viti 2018.
7. Propozim Vendim për bartjen e të hyrave vetanake.
8. Propozim Vendim për formimin e ndërmarrjes publike, nga ish NP "Kosova Trans" në ndërmarrje Publike Lokale, Stacioni i Autobusëve-Gllogoc, Shoqëri Aksionare.
9. Propozim Vendim për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci".
10. Propozim Vendim për lejimin e rrënimit të objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale në Drenas, ish objekti për sigurime sociale.
11. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 27/03/2018 ishin: Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, Nënkyetar i Komunës z. Gani Sylja, Përfaqësues të KFOR-it, dhe përfaqësues të OSCE-së, dhe Drejtor të Drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të gjithë, hapi diskutimin për rendin e ditës dhe kërkoi nga anëtarët e kuvendit se a pajtohen me këtë rend dite, apo ka ndonjë propozim?

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, pasi nuk pati ndonjë sugjerim, kritikë apo propozim kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 23 anëtar:

Për votuan: 23

Kundër: 00

Abstenim: 00

U miratua rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 27.02.2019.**

Sokol Bylykbashi, në mbledhjen e kaluar kur kam fol për Raportin e Punës së Kryetarit për vitin e kaluar, me gjasë e kanë bërë një lëshim, në vend që të shkruhej fjala suficit e kanë shkruar fjalën deficit dhe kërkoi që kjo fjalë të zëvendësohet.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar:

Për votuan: 24

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, Hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim për Aprovimin e Programit Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021, i plotësuar**

Arsim Haxhiu Drejtor i shëndetësisë, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale në mbledhjen e kaluar patëm bërë një propozim vendim për Programit Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2019-2021, dhe në atë propozim vendim është bërë një

gabim teknik ku nuk është përfshi ligji Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe dispozitave tjera të këtij Ligji, dhe për këtë arsye e kemi sjellë edhe një herë në kuvend ta përmirësojmë pjesën e preambulës të këtij propozim vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 22 anëtar:

Për votuan: 22

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, Hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për plotësimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit.**

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, kërkoj me heq këtë pikë të rendit të ditës për arsye që janë kriju kushtet që me qenë funksional KQZ-ja dhe besoj që shumë shpej, në mbledhjen e ardhshme asamblisti i cili është me radhë z. Gerguri do të jetë pjesë e asamblesë,

Petrit Gashi, edhe unë pajtohem me mendimin e kryetarit pasi që kemi pritur një kohë të gjatë për me ardh në asamble komunale Gënit Gerguri, dhe tani janë krijuar mundësit që ai të jetë pjesë e asamblesë komunale, mendoj që është një lajm i mirë për të gjithë ne, dhe kisha kërku nga të gjithë që këtë pikë të rendit të ditës ta heqim sepse ai është i emëruar dhe kështu seancën e radhës mund të jete pjesë e komisionit.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ju duhet të votoni kundër kësaj pike të rendit të ditës, për me mbet ne fuqi vendimi i vjetër

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan: 00

Kundër: 26

Abstenim: 00 mbetet vendimi i njëjtë që ka qenë për formimin e komisionit.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, Hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim , Kulturë Rini dhe Sport**

Qendrim Mulaj, le të jetë si vërejtje, numri është shkruar 5 ndërsa me shkronja e keni shkruar shtatë, përmirësoni këtë, sepse edhe në arsyetim thuhet që duhet të jenë 5 anëtar ndërsa këtu është shkruar shtatë (5).

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, propozoi:

Kajtaž Kastrati- anëtar nga ekzekutivi

Kadire Tahiraj- anëtare nga shoqëria civile.

Gani Podrimqaku, propozoi: Qendrim Mulaj- anëtar nga kuvendi
Kimete Bardhi- anëtare nga kuvendi

Petrit Gashi, propozoi: Beqir Kiqina-anëtar nga kuvendi.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin këtë pikë të rendit të ditës me këtë përbërje të komisionit, prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar:

Për votuan: 27

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, Hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5.Propozim Vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, propozoi:

Haki Bekolli- anëtar nga ekzekutivi

Behxhet Binaku- anëtar nga shoqëria civile

Gani Podrimqaku, propozoi: Petrit Sinani-anëtar nga kuvendi
Malsore Cakiqi- anëtar nga kuvendi

Petrit Gashi, propozoi: Sokol Bylykbashi-anëtar nga kuvendi

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar:

Për votuan: 27

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, Hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim Vendim për rritjen e të hyrave vetanake nga viti 2018.**

Petrit Sinani, jam konfuz sa i përket kesaj pike apo ndoshta nuk po mundem me kuptu mirë, mirëpo Propozim Vendim për rritjen e të hyrave vetanake nga viti 2018, nuk e kam të qartë, a është e vitit 2019 apo 2018? Si mundemi me i rrit të hyrat vetanake për vitin 2018 kur ne jemi në vitin 2019, nuk po mundem me kuptu, kërkoj një sqarim.

Shyqiri Bublaku Drejtor i Financave, propozim Vendim për rritjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 për arsye që gjatë vitit 2018 ne kemi pas tejkalim planifikim të hyrave vetanake ku buxheti i planifikuar për të hyrat vetanake ka qenë 1,577,676.00 € ndërsa realizimi i të hyrave i vitit 2018 është 1,673,969.70 € për këtë arsye është kërku më i bo rritje të hyrave vetanake të vitit 2018 sepse nuk munden me u aloku mjetet të cilat realizohen në vitin kalendarik por përcillen në vitin vijues.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan: 26

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, Hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim Vendim për bartjen e të hyrave vetanake.**

Petrit Gashi, ne fakt për tejkalim e te hyrave vetanake kuptuam qe vitin 2018 kemi pruar ma shumë së sa kemi planifiku, por pse nuk i kemi shfrytezu ehe duhet me bart mjete prap këtë nuk po e kuptoj fare, megjithatë pasi që janë projekte dhe është në interes të qytetareve ne do ta mbështesim këtë propozim vendim.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, të hyrat vinë për gjatë gjithë vitit, por te hyrat hynë zakonisht në fund të vitit kur nuk lejohet shpallja ose procedurat e prokurimit prandaj behet bartja.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan: 26

Kundër: 00

Abstenim: 01

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, Hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim Vendim për formimin e ndërmarrjes publike, nga ish NP "Kosova Trans" në ndërmarrje Publike Lokale, Stacioni i Autobusëve-Glllogoc, Shoqëri Aksionare.**

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje dhe sugjerime **Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj**, hodhi në votim rendin këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan: 26

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, Hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim Vendim për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin " Fehmi Lladrovci.**

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, të nderuar asamblast siq e dini sheshi "Fehmi Lladrovci " është një shesh shumë i rendesishem për komunën tonë, shtatorja e Ilaz Kodrës dhe Bedri Shalës janë në përfundim, dhe kemi marrë vendim që deri më 29 nëntor t'i përfundojmë dhe t'i vendosim ehe shtatoret e heronjve Shaban, Hamez dhe Adem Jasharit, ju ftoj që ta votoni këtë propozim vendim sepse i bëni nder jo vetëm vetes por edhe gjeneratave të juaja që në Drenas të vendosen këto 8 shtatore të cilat i kemi bërë dhe po i bëjmë pa ia harxhuar asnjë cent komunës sonë dhe nivelit qëndor por të gjitha po i bëjmë duke i bërë me donator dhe miq me shok dhe këto do të jenë pjesë e vlerës së Komunës sonë.

Adem Bucolli, unë vetëm dua ta përshende këtë propozim të kryetarit, dhe nuk po e lavdëroj por po e cekim që kush do tjetër që kishe me qenë mendoj se nuk do ta bente kete veprim përderisa janë shtatoret e Fehmi e Xhevë Lladrovci dhe është për tu admiruar dhe i ftoj të gjithë ta votojme dhe ta mbështesim këtë propozim vendim.

Sabrije Kukaj, pati një pyetje: kur do të merrni një vendim të tillë që t'i vendosni pllaka në vend masakrat, se paku pllaka me emra e të masakruarve në vendet ku ka ndodh masakra gjate kohës se luftes sepse edhe ato e kanë një peshë të madhe në histori të kësaj lufte dhe kësaj lirie, sepse me duket se kanë mbet si në harresë, kurrë nuk është diskutuar

për masakren e Verbocit, Qikatovë , Abri në Poklek ku do që janë bërë, kur do ë merret një vendim që të veprohet diçka spaku të vendoset një pllak më të gjithë emrat e të masakruarve në ato vende.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ne kemi thënë që do t'i rregullojmë vend varrezat e gjithë martireve dhe të rënëve gjatë luftes, dhe ne ato vend varrime do të vendosim pllaka përkujtimore, një prej tyre e kemi vendos në fshatin Shtyticë, por do t'i vendosim edhe ne vende tjera.

Sabrije Kukaj, ndoshta nuk me kuptuar mirë, a do të vendoset në vendet ku ka ndodh masakra diçka që tregon që në atë vend ka ndodh masakra, nuk e pata për shtatoret,

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ne po i nderojmë dhe po krijojmë mundesi që me pas pllakën përkujtimore .

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar:

Për votuan: 28

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, Hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Propozim Vendim për lejimin e rrënimit të objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale në Drenas, ish objekti për sigurime sociale.**

Sokol Bylykbashi, siç e dimë kemi një gjendje reale, pra ish objekti për sigurime sociale është i djegur, unë nuk e di pse u djeg dhe si u djeg ky objekt dhe nuk e di organet e hetuesisë çka kanë bërë dhe a kanë e ndonjë raport për shkaqe të djegies të këtij objekti, është një objekt që është djegur dhe ka mbet keq dhe duhet me bërë zgjidhje, dhe zgjidhja momentale që mundemi me bë është po besoj që duhet me votu është me rrenu atë objekt për shkak qe mundet me paraqit rrezit, por edhe mund të keqpërdoret.

Në të ardhmen nëse vjen ndonjë dokument si propozim vendim që i përmban dy fjal: 1. Private dhe 2. Koncesion unë ka me kundërshtu dhe ka me votu kundër çfarëdo dokumenti që i përmban këto dy fjalë sa i përket kësaj parcele, për shkak se ajo parcelë është pronë komunale është publike dhe duhet me u shfrytezu për qëllime publike komunale në të mirën e të gjithëve, të përjashtuar çdo segment që ka të bëjë me privaten.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, e ke ngrit një shqetësim me vend, ky objekt është djeg para vendosjes së shtatoreve të Fehmi e Xhevë Lladrovci që ka

qene nje imazh jo i mire per te gjithë, se çka do të vendoset aty është temë tjetër, komuna jonë në bashkëpunime GIZI-in Gjerman është duke e bërë planin zhvillimore të komunës sonë dhe hartat zonale, qka do që të vendos kjo asamble me votat e saj, qytetaret në debate publike, a do ta votosh pro apo kundër është çështje individuale.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar:

Për votuan: 18

Kundër: 00

Abstenim: 07

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Të ndryshme.**

Petrit Gashi, sigurisht që ditëve të fundit jeni njoftuar përmes mediave dhe opinionit publik për një krizë të zbritur në Drenas tash e sa kohë, dhe kjo tendencë e komunës për të shtirë në dorë çdo biznes të rëndësishëm ose për ta eliminuar të përfundimisht po vazhdon të jetë e pranishme në mesin tonë. Me datë: 21.03.2019 në kuadër të postimit tim në facebook kam bërë një denoncim i cili ka qenë publik për vendosjen e një taksë komunale një biznesi në mënyrë të paligjshme në vlerë prej 550 mijë euro, fillimisht para vendosjes se kësaj takse 550 mijë euro, duke e klasifikuar si shkretore së pari ia vendos një taksë prej 250 euro duke e klasifikuar si SHPK një taksë të cilën në bazë të rregullores për Taksa Tarifa dhe Gjoka ka kaluar në këtë Kuvend Komunal, dhe si duket as kryetari as ata që e ndihmojnë kryetarin nuk e shohin akt vendimin se çka shkruajnë, në pjesën e dytë të akt vendimit shkruan: ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e këtij akt vendimi, dhe në fund të këshillave juridike thotë i japin mundësi që 30 ditë të ankohet për këtë akt vendim, dmth pjesën e parë e konteston vetëm vetveten thotë nuk ka drejt me u anku, kena me ekzekutu këtë akt vendim dhe pjesën e fundit thotë këshillë juridike. Dëshmia e pagesës "KMI"- shpk ndërmarrje të cilën e ka mbyll tani kryetari ne Drenas dhe u zhvendos në pjesë tjera të Kosovës ajo është jo aktive.

Akt vendimi i dytë i dhen me 18.01.2019 sikur i duket pak taksa prej 250 euro dhe e ngarkon pa kurrfarë baze ligjore me një taksë tjetër që është 550 mijë euro, pra duke e ngarkuar prej vitit 2011 e deri në vitin 2019, dhe çka ndodh pasi personi në fjalë i drejtohet institucioneve gjegjëse vërteton shkeljet që po i bënë kryetari ky e dërgon edhe një akt vendim tjetër, dhe akt vendimi tjetër thotë: sikur i duket pak 550 mijë euro, thotë i shfuqizohen dy aktvendimet e para dhe ia vendosim një taksë tjetër prej 139.750 €, dhe të këshilla juridike në fund thotë: kundër këtij akt vendimi nuk është e lejuar ankesa, pala mund te ushtrojë padi në gjykata përkatëse

në lidhje me këtë akt vendim pra biznesmeni në fjalë ne vend që Drenasi të kishte investor të rinj për gjatë këtij mandati të cilat i ka premtuar z.Lladrovci, e një nder premtimet esenciale të tij për mandatin e dytë ka qenë heqja e taksës komunale për të gjitha bizneset dhe ka thënë kështu nder mbledhjet e para, pra bizneset të nderuar, asnjëherë nuk e ka propozuar heqjen e taksës komunale, dhe ketu para bizneseve thotë qartë me ndihmën e asamblastëve të PDK-së që do të jene shumica ne do ta heqim atë taksë, dhe me ndihmën e asamblastëve të PDK-së ky po vazhdon më mbajtë atë taksë. Tjera që është më e rëndësishme nga drejtimet e personit ne fjalë drejtuar "KMI" e vërteton që kryetari ka bërë shkelje ligjore, dhe çka ndodhë, e mbylle komplet biznesin dhe zhvendoset me një vend tjetër duke i lënë 12 punëtor të pa punë dhe duke ia shtuar edhe një hije tjetër komunës së Drenasit si vend i pasigurt për investitor dhe si vend i pasigurt për bizneset ekzistuese që janë në Drenas, kjo klimë me nje formë e shantazhimit dhe e presionit ndaj biznesit për interesa krejtësisht personale dhe pa kaluar nëpër këtë kuvend komunal dhe pa u diskutuar asnjëherë mendoj që është e dëmshme për Komunën e Drenasit, për keqqeverisje dhe keq mundimi për qytetaret me bizneset me administratën komunale e gjera tjera nuk ndalen vetëm këtu. Po ia tregoj vetëm një rast për z. Zahrie, këtë person që po e shihni këtu ka qenë aktivistja e parë për të drejtat dhe liritë e njeriut, aktivistja e parë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, ka qenë ushtarë u Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, ka qenë aktivistja e parë që e ka ngrit zërin për barazi gjinore dhe për të drejtat e gruas në Komunën e Drenasit atëherë kur kërkush në Drenas nuk ka pas guxim me fol, dhe çka ndodhë kryetari për me pru renë e motrës se vet ne zyrën për barazi gjinore i bënë presion për mu heq prej pune dhe 3 or mbeti pa vetëdije në zyrën e saj dhe asnjë zyrtar komunal nuk shkon me i ndihmuar, e thirrin familjen e saj dhe emergjenca vjen, pra presioni nuk është rrit vetëm ndaj bizneseve, ndaj neve si asamblast dhe qytetareve jashtë, por edhe ndaj atyre që çdo ditë punojnë në të mirën e këtij vendi. Storia tjetër në takim me qytetarë, takimet publike me qytetarë vjen një zonjë dhe kërkon ndihmë dhe thotë se më ka vdes burri dhe i kam tre fëmijë dhe kërkoj ndihmë për strehim, a din çfarë përgjigje i jep kryetari, komuna Drenasit thotë nuk ka hap vend për me i martu gratë që janë pa martu. Të nderuar koleg dhe kolege të keqen mund ta ndalim se bashku, të keqen mund ta ndalim te gjithë si qytetarë, askush, qoftë edhe ai përfaqësues i popullit, qoftë ai kryetar komune, qoftë ai ministër kryeministër nuk duhet të luaj me ndjenjën e qytetareve.

E dini shumë mirë edhe mbylljen e shkollave ne Komunën e Drenasit të cilat të nderuar koleg dhe kolege te PDK-së vetëm me një votë të tuajën ato shkolla ishin te hapura. Kërkoj nga Drejtori i Arsimit spaku me dha dorëheqje se me u bë një objekt në gjendje të tillë shek XXI është turp për qytetaret e Drenasit dhe për qeverisjen ne Drenas. Ju bëjë thirrje secilit që mblidhni guximin fuqishëm kundër qeverisjes dhe ta denonconi çdo ditë këtë qeverisje ne Drenas.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, i ke bërë dy shpifje gjatë diskutimit tënd. Sa i përket çështjes se taksave, gjithçka që kam deklaruar i kam bërë, unë i kam heq taksat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ndërsa sa i përket kompanisë KMI, as nuk i ka ik por as nuk mundet me i ik taksave të cilat është i obliguar me i pagu sipas rregullores të këtij kuvendi, pra kompania në fjalë, është një kompani e cila merret përveç tjerave me shkrirjen e barnave, që e dëmton ambientin e komunës tonë dhe ju e dini miliona euro ka pas tenderë, ku janë shkri në atë shkritore barnat, kjo kompani merret me shkrirjen e hekurit, dhe licencën e saj e ka me i shkri brenda vitit 3 mijë ton hekur, dhe cilësohet si kompani si shkritore, dhe çdo shkritore a është e madhe a është e vogël, ka me e pagu taksen të cilën e ka vendos ky kuvend. Taksat që duhet të ia kthejmë qytetareve që duhet me i pagu janë taksa të cilat i ka vendos Kuvendi i Kosovës, nuk është taksë që e kam vendos unë, por është taksë që e ka vendos niveli qendror e ka vendos Parlamenti i Kosovës, dhe ato që i vendos parlamenti unë nuk mundem me i heq.

Sa i përket asaj që thatë takim me qytetar që unë gjeja e pasna thënë një gruaje që që i paska vdes burri me tre fëmijë, që komuna nuk është institucion për martesën e atyre që iu vdes burri është e pavërtetë, dhe do ta keni padinë e radhës. As nuk është në moralin tim dhe nderin tim, as traditën time, as nuk i takoj një familje që them gjera të tilla. Sa i përket mbylljeve të shkollave, unë asnjëherë nuk i kam mbyllë shkollat unë i kam fuzionu shkollat, dhe fuzionimin ma lejon dhe ma ka leju ligji, sepse shkollat kanë qenë duke punuar jashtëligjshëm. Në këtë rast me ish shkollën që ka ndodhë në Abri më respekt për gjithë qytetaret e Abrisë, i lutem që ata t'i ndihmojnë organet e hetuesisë ta zbulojnë krimin të cilën e kanë bërë ata kriminel që nuk ia donë të mirën vendit tonë, komunës sonë dhe shkollave tona.

Petrit Gashi, asnjë nga pyetjet të cilat i ngrita unë nuk iu dhe përgjigjeje, as për heqjen e taksës komunale, as për zonj. Zahrie!

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, sigurisht që nuk të dhashë përgjigje në shumë pyetje tuajat, zonj. Zahrie është këtu, zonj. Zahrie e ka bërë një ankesë dhe komisioni për shqyrtimin e ankesave është duke u marrë më atë punë, reja e motrës time është e autorizuar përkohësisht për kryerjen e asaj detyre, as nuk e kam zgjedh dhe as nuk do ta zgjedh, dhe me vie mire se është e zoja profesionaliste.

Arta Xhylani, këtu kom dal të flas për shumë shqetësime të Komoranit, mirëpo nga takimi që kam realizuar me koordinatoret e Komoranit përveç pikave që janë të rëndësishme si: asfaltimi, kanalizimi i ujërave të zeza, desha me i cek tri çështje që ndoshta janë shqetësuese për pjesën e Komoranit në bazë të kërkesave të qytetareve, dhe koordinatoret e Komoranit I-II-III-IV, ma kanë realizuar si

shqyrtim dhe realizim të këtyre mundësive që është: rreth rrotullimi të ambulancës, që e ndërlidh rrugën e Caraleves dhe Komoranit për shkak që paraqet një rrezik shumë të madh për qytetaret, po ashtu edhe për nxënësit, pastaj kërkesa tjetër është tregu, tregu në Komoran është një lokacion shumë i keq për shkak se dalin shesin neper rrugë të Komoranit, nuk është i definuar, kërkoj të jetë i definuar dhe mos të ketë jashtë rregullave dhe jashtë lokacionit të tregut, jo në tërë Komoranin të këtë treg dhe pastaj të këtë edhe mbeturina pasi të përfundon tregu. Si dhe kërkesa tjetër e qytetareve të Komoranit është edhe kërkesa e një parku që i takon pjesës lindore tek lagjja ose Komorani II, thirret "Palanat" ka pisha që kërkohet të behet një park lokal sepse e dimë që ka edhe ne komuna tjera parqe lokale që është atraktive, këtë rast mungon vetme një infrastrukturë dhe heqje të mbeturinave dhe do të jetë shumë i frytshëm edhe për qytetaret tanë dhe mund të ketë edhe benifite të mira komuna jonë të jetë një park i tillë sepse e kemi lokacionin shumë të përshtatshëm. Kërkesë tjetër për drejtorinë përkatëse, kompania që po e ndërton rrugën në lagjen në qendër të Komoranit mos të hidhen mbeturinat e rrugës që po e ndërtojnë rrugën, në Komoranin II të varrezat, mirëpo tek pjesa e lagjes Mulaku që është pjesë adekuate për atë që të hidhen mbeturinat e për rregullimin e rrugëve.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, Komorani është duke bërë zhvillim të paparë këto dy vit të qeverisjes time, më rrugë, më drita, me kamera tani, me shkollë, me stadium, me pishina për gjithçka që është e mirë për qytetaret. Sa i përket rreth rrotullimit ka ma shumë se një vit e gjysme që jemi duke bërë përpjekje me nda një buxhet ose me zgjidhe më buxhet të nivelit qendror sepse rruga deri aty është e nivelit qendror. Megjithatë e kemi në projekt por kur nuk e di sepse nuk kemi buxhet të parapamë. Sa i përket tregut dhe mbeturinave nuk e kemi problemin vetëm me tregun e Komoranit, ne jemi të gatshëm me gjet një vend për treg, por duhet me shiku se ku kemi prona që mundemi ne me e dedikuar për treg. Ndërsa sa i përket parkut, jam në gara duke fitu gara për shkak të performances që mbërrijmë më fitu ehe ndonjë grand tjetër besoj nëse nuk ka me pas ndonjë kërkesë ma të rëndësishme, kemi me i pru aty.

Sokol Bylykbashi, i kam dy kërkesa që në të vërtetë janë edhe vërejtje për Drejtorinë e Inspektoratit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, sa i përket Drejtorisë së Inspektoriatit mendoj që duhet me qenë shumë ma aktive për shkak se tani është koha po flas për sektorin e ndërtimtarisë sepse tani është koha ku punohet më shumë ne sektorin e ndërtimtarisë dhe dihet që është shumë e rëndësishme që inspektorati me u siguruar që ato kompani që e ushtrojnë këtë kompani janë duke iu përmbajtur udhëzimeve pra akteve ligjore, e kam fjalën për arsye që unë po i shoh ndërtimet e larta që po bëhen nuk janë duke e siguruar vendin e punës ato punishte nuk janë të sigurt, është diçka që vërehet nga larg.

Kështu që është mirë me qene ma aktive kjo drejtori në këtë fushë por është në fusha tjera. Sa i përket Drejtorisë të Shërbimeve publike, po shihet që ka shumë gropa në qendër dhe e shikova që disa ishin mbyll ndërsa disa jo, është mirë që herëve tjera si të kalon dimri apo si të përmirësohet koha me e rregullu këtë problem.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, sa i përket inspektoratit, inspektorati e ka për detyrë te veten me i ndjek ndërtimet pa leje, ndërsa ndërtimet kolektive e ka për obligim me i përcjell a po kryhen sipas paramasave dhe planit që e ka dorezu dhe e ka marrë lejen, ndërsa sa i përket punëtorëve a i kanë helmetat mbrojtëse është përgjithësi e nivelit qendror, ne raportojmë kur i shohim në ministri por është e nivelit qendror dhe nuk është pjesë e jona. Ndërsa sa i përket drejtorisë së shërbimeve publike ne e kemi një kompani që merret me shërbimet verore ose me eliminimin e gropave në rrugë lokale.

Haka Tahiraj, parashtroj një pyetje për Drejtorinë e Urbanizmit: nuk e di a i ka ardh një kërkesë nga fshati Terdevc për një kanalizim? Është fjala për një kanalizim që është shumë keq, kanalizimi ka ardh deri te shkolla dhe gjendja e saj është shumë e keqe. Ju kisha lut që kur ta merrni kërkesën ta bëni një zgjidhje.

Idriz Hyseni Drejtor i Urbanizmit, e di atë problem, gjatë këtij viti e kemi pjesën tjetër të kanalizimit dhe do ta kthejmë në pjesë tjetër kanalizimin dhe besoj se do ta rregullojmë.

Beqir Kiqina, pati një shqetësim lidhur me drejtorinë përkatëse për arsye se shumë kërkesa vinë nga përfaqësues të lagjeve përfaqësues të fshatrave, por edhe nga qytetarë të Komunës së Drenasit edhe ato nuk marrin përgjigje definitive, po, jo apo ndoshta por në mënyra të ndryshme ndërsa punët po mbesin pa i kry, janë disa punë në Komunën e Drenasit përkatësisht janë disa rrugica që realisht janë ndoshta duken të vogla por ato e kanë një peshë të madhe, dhe nëse ato përfundojnë edhe jeta e qytetareve përmirësohet për arsye se rruga është vendi kryesor ku ata kalojnë çdo ditë, do të ndalem të drejtorinë për shërbime publike , në seancën e kaluar po thuajse një muaj kem pas kërkesë për me vendos një pasqyre reflektuese tek rampa Baicës quhet ajo nuk është vendos, e kemi rastin e kolegut tonë Perparim Shala që e ka bërë një kërkesë dhe nuk janë realizuar kërkesat, e kemi rastin e Edolina Plakiqit për një rrugë të caktuar për disa metra që ka mbet pa u shtru në fshatin Nekoc. Ndërsa të fshati Baicë është rruga “Sabit Leku” që lidhë rrugen ose lagjen “Faton Xhylani” e cila është në një gjendje të mjerueshme, gjysma e fshatit Baicë detyrohet me shku në Drenas pastaj më shku në Skenderaj, kështu që ajo rrugë nuk funksionon është 300 ose 400 metra, kërkojmë më shtru të paktën me zhavorr për

me u përmiresu ajo rrugë. Pastaj është rrugë “Elmi Lestrani” një pjesë e saj është e pa asfaltuar që lidhet me lagjen Kiqina, pastaj kemi rrugën tjetër “Ganimete Xhylani” të cilën kemi thënë vetëm me shtru xhavor, kërkesën e ka sjellë në Drejtorinë për Shërbime Publike, përfaqësuesi i fshatit, ndërsa sot ato kërkesa nuk po realizohen. Prandaj ju lutem që Drejtorinë për Shërbime Publike dhe drejtoritë tjera të paktën të kthejnë përgjigje definitive po ose jo për arsye se qytetaret po mbesin të shqetësuar.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, sa i përket pasqyrës reflektuese është miratu dhe do të bëhet ajo, por jemi në muajin maj dhe ende nuk kemi fillu me procedura për shkak se u shty votimi i buxhetit në parlament, dhe pa u miratu buxheti na nuk kemi pas të drejtë as me zhvillu procedura të prokurimit. Të rruga në Baicë të atyre lagjeve do të bëjmë përpjekje për më shtru rrugën por jemi duke shtruar rrugën për Skenderaj.

Beqir Kiqina, për këto rrugë që bëra kërkesë besoj që nuk është buxheti ku me ditë sa i madh.

Elmi Shala, parashtroj një pyetje Ne fshatin Gjergjicë pse nuk është funksional ujësjellësi për shkak se gypat janë por ujësjellësi nuk funksionon gjithashtu dhe një pasqyre reflektuese.

Idriz Hysenaj Drejtori i Urbanizmit, shqetësimin e juaj e kam përcjell edhe ne Ministri të Ambientit, por nuk është vetëm projekti i Gjergjicës por për momentin nuk kemi marrë ende përgjigje.

Petrit Sinani, parashtroj një pyetje në lidhje me organizimin dy turnirëve që do të vinë në muajin maj është turniri tradicional dhe e dimë që është turnir tradicional dhe mbledhen një numër i madh i ekipeve po ashtu edhe të shikuesve. Pyetja imë konkrete për Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport a është paraparë që këto dy turnirë të organizohet nën patronatin e Kryetarit të Komunës siq ka ndodhë edhe më herët ose në patronatin për Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit apo nuk kjo drejtori nuk ka parashiku një gjë të tillë. Po ashtu kam edhe një shqetësim sa i përket Drejtorisë së inspeksionit ju e këni parë që tani kemi dy kompani të auto-taxi në Komunën e Drenasit, kompani të cilat nuk e di a janë të pajisura me licencë nuk dua as të dyshoj, mirëpo më intereson kjo drejtori a ka kry edhe kërkesa tjera nëse kanë bërë qytetaret kërkesë për leje?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, mu mbajt do të mbahet turniri por në patronat timin apo Drejtorisë së Kulturës nuk e di. Kërkesa për leje shikoni në faqe të Komunës çdo gjë është transparente me leje me të gjitha. Dhe nuk ka kërkesë që nuk i japim përgjigje

Sabrije Kukaj, ndoshta jeni të informuar që janë ndarë për 500 familje nga Ministritë mjete për rregullimin e kulmeve , të banjave apo diçka emergjent, a është pjesë e tërheqjes së mjeteve komuna jonë, e di që është nda një buxhet për 500 familje që kanë më përfitu kulm, banjë, apo renovime. A ka mundësi së paku në pjesën e ku ka mbet lumi pa u rregullu kanalizimi me u kry në atë pjesë të lumit, dhe me u pastru ajo pjesë për arsye se është pjesa ma e ndotur ajo pjesë e lumit.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, drejtorja e inspeksionit ka me u interesu sa i përket ndotjes së lumit, besoj së shumë shpejt kemi me i fut gypat për skaj të lumit dhe kemi me i largu ujërat e zeza.

Mbledhja përfundoj rreth orës 11:50 min


Procesmbajtëse:

Zahrie Podrimqaku-Subashi

Liridona Fejza Ajazi

Kryesuesi i Kuvendit

Labinot Halilaj





Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 18.04.2019, si vijon:

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj pasi hapi mbledhjen e K.P.F-ca i cili njoftoi me rendin e ditës ku dhe ceku se kemi dy propozime shtesë si dhe njoftoi anëtarët se në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal do ta bëjnë betimin dy asamblist e rinj.

Propozim vendim për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Iliaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci" i plotësuar, dhe propozim vendim për lejimin e rrënimin të objektit që ndodhet në parcelen 767-5, në zonen kadastrale Drenas, ish objekti për sigurime sociale, i plotësuar për arsye të plotësimit të preambulës.

Të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan ku votuan gjatë votimit prezent ishin 5 anëtar,

Për votuan: 05

Abstenim: 00

Kundër: 00

1.Procesverbali i mbledhjes së datës: 19/03/2019.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës me ndryshime, gjatë votimit prezent ishin 05 anëtar:

Për votuan: 05

Abstenim: 00

Kundër: 00

2. Raporti Financiar i Zhvillimit të buxhetit Janar- Mars, 2019

Të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan që ky Raport të kalon në kuvend.

3.Propozim vendim për lejimin e largimit/demolimit të disa ndarjeve, sporteleve dhe kryerjen e disa punimeve brenda hapësirës së QKMF-së "Dr.Hafir Shala" në Drenas.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 06 anëtar:

Për votuan: 06

Abstenim: 00

Kundër: 00

4. Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me:

a) Komunën e Vushtrrisë, b) Komunën e Skenderajt, c) Komunën e Obiliqit.

Pastaj Nga pika 4 deri të pika 11 të gjithë anëtarët e K.P.F rekomanduan që të kalojnë në kuvend këto propozim vendime.

11. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues, për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtar:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

12. Propozim vendim për formimin e komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afat gjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtar:

Për votuan: 07

Abstenim: 00

Kundër: 00

13. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj njoftoi K.P.F.-ca se a pajtohen me këto dy pika të kalojnë në kuvend

1. Propozim vendim për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Iliaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci" i plotësuar

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtar:

Për votuan: 03

Abstenim: 04

Kundër: 00 kaloi edhe kjo pikë e rendit të ditës në kuvend.

Propozim vendim për lejimin e rrënimin të objektit që ndodhet në parcelen 767-, në zonen kadastrale Drenas, ish objekti për sigurime sociale, i plotësuar për arsye të plotësimit të preambulës

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, gjatë votimit prezent ishin 07 anëtar:

Për votuan: 04

Abstenim: 03

Kundër: 00 kaloi edhe kjo pikë e rendit të ditës në kuvend

Dhe njoftoi anëtarët në mbledhjen e radhës në Kuvend do bëjnë betimin dy-asamblist.

Kryesuesi i Kuvendit


Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060-27839 dt. 22.05 2019

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
24.04.2019**

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 24.04.2019

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 30 anëtar

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Betimi i asamblistëve të rinj në Kuvendin Komunal në Drenas, Florentina Kukaj e cila zëvendësohet me Shqipe Zogu nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Gentrin Gerguri zëvendësohet me Xhavit Drenorin nga subjekti politik, Vizioni për Drenasin.
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të mbajtur më dt. 27.03.2019
3. Raporti Financiar i Zhvillimit të buxhetit Janar- Mars, 2019
4. Propozim vendim për lejimin e largimit/demolimit të disa ndarjeve, sporteleve dhe kryerjen e disa punimeve brenda hapësirës së QKMF-së "Dr.Hafir Shala" në Drenas.
5. Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me:
a) Komunën e Vushtrrisë, b) Komunën e Skenderajt, c) Komunën e Obiliqit. Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Vushtrrisë.
6. Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Obiliqit.
7. Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Lipjanit.
8. Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Fushë Kosovës.
9. Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Malishevës.
10. Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Klinës
11. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues, për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

12. Propozim vendim për formimin e komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afat gjatë të pronës se paluajtshme të komunës .
13. Propozim Vendim për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin " Fehmi Lladrovci" i plotësuar.
14. Propozim Vendim për lejimin e rrënit të objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale në Drenas, ish objekti për sigurime sociale, i plotësuar
15. Të ndryshme

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 25/04/2019 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Përfaqësues të KFOR-it, dhe përfaqësues të OSCE-së, përfaqësues KDI-së Drejtor të Drejtorive përkatëse, media (Star Tv).

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të gjithë, hapi diskutimin për rendin e ditës dhe kërkoi nga anëtarët e kuvendit se a pajtohen me këtë rend dite, apo ka ndonjë propozim?

Beqir Kiqina, unë jam në pajtim me rendin e ditës por pasi që sot po kompletohet Kuvendit Komunal edhe me dy asamblist tjerë, a kish qenë e mundur që sot me shti edhe si pikë të rendit të ditës për shqyrtimin e ankesave për emërimin e rrugëve të komunës sonë?

Burim Bujupi, meqenëse tani është Gentriri dhe e bënë betimin më mirë kishe me qenë sot me fut si pikë e rendit të ditës se mos të vonohemi se ashtu kështu kemi vonesa, ta votojmë komisionin dhe nëse kemi diçka e lemë për seancën e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, sigurisht që me ligj mundemi me fut edhe një pikë të rendit të ditës a jeni të pajtimit të gjithë që me u fut kjo pikë e rendit të ditës për emërimin e rrugëve dhe formimi i komisionit, e futim tek pika e 16 me votimin e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, me kërkesën e z. Kiqina hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 24 anëtar:

Për votuan 24 anëtar

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim votuan 00 anëtar

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, pika e parë e rendit të ditës është Betimi i asamblistëve të rinj në Kuvendin Komunal në Drenas, Florentina Kukaj e cila zëvendësohet me Shqipe Zogu nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Gentriri Gerguri zëvendësohet me Xhavit Drenorin nga subjekti politikë, Vizioni për Drenasin.

Florentina Kukaj dhe Gentriri Gerguri dhanë betimin në këtë Seancë.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të mbajtur më dt. 27.03.2019.

Kryesuesi Labinot Halilaj, pasi që nuk pati diskutim vërejtje apo sugjerime hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar:

Për votuan 27 anëtar

Kundër votuan 0 anëtar

Abstenim votuan 0 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:
3.Raporti Financiar i Zhvillimit të buxhetit Janar- Mars, 2019

Vehbi Berisha, Raporti Financiar i Zhvillimit të Buxhetit janar-mars 2019 është më të vërtet një raport i periudhës së hershme financiare që tregon shumë pak lidhur me zhvillimin e buxhetit mirëpo në aspektin tjetër jep edhe disa informata detale sidomos kur kemi të bëjmë me të hyrat e buxhetit, unë dua të ndalem tek tabela nr. 2, ku për tre muajt e parë të këtij viti janar, shkurt, mars janë të prezantuara tabelat me shifra e buxhetit të Komunë së Drenasit për këta tre muaj, dhe raporti tregon se kemi një bilanc negativ -13.57% , krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, nuk kemi arrit me i inkasu 20% të mjeteve më pak në buxhetin e Komunës së Drenasit. Në raportet e kaluara në faqen e fundit të përfundimi jepet edhe një koment tek vlerësimi dhe komentimi i këtij raporti se pse kemi këto shifra, këtu fare nuk përmendet ose nuk është dhënë një pasqyrë ose një raportim se pse kemi të hyra më pak në këta tre muaj, a do të thotë kjo që bizneset tona po shuhen, a do të thotë kjo që njerëzit që paguaj në për komunën e Drenasit kanë zgjedh diku tjetër të paguajnë, a do të thotë që kemi të hyra të pakta si pasoj e keqqeverisjes, se ne e dimë që një komunë e cila është e varur nga grandet qeveritare e ka shumë problem zhvillimin e projekteve të ndryshme kapitale, një komunë e cila varet vetëm nga buxheti i grandeve që ndahen në nivel qeverie.

Kam një pyetje: kur janë ndarë drejtorit kam menduar që drejtorit do të ndahen edhe në staf ndërsa në bazë të këtij raporti duke u bazuar të paga dhe mëditje e pash që rrogat janë ndarë vetëm për drejtor, a do të thotë që stafi mbetet përsëri në ato drejtori që ka qenë apo për çfarë arsye nuk janë paraparë mjete?

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku, sa i përket raportit të hyrave për tre mujorin e parë 2019, ne kemi qenë shumë transparent dhe kemi paraqit gjendjen reale të hyrave, mirëpo janë shumë elemente të cilat kanë ndikuar në mos përmbushjen e plotë të hyrave vetanake për tre muajt e këtij viti. Për periudhën janar-mars kemi mosrealizim të planifikimit mirëpo ky është si rezultat i faturave të tatimit në pronë të cilat nuk kanë arritur me u shpërndarë komplet në komunën tonë. Ky është një prej elementeve kyçe që ka ndikuar në mos realizimin e plotë të buxhetit sa i përket të hyrave .

Sa i përket buxhetit të drejtorive ju e dini që buxheti është ndarë tek në muajin mars për shkak të vonesave të aprovimit të buxhetit në nivelin qendror, dhe deri me 10 mars nuk është ndarë buxheti për drejtori dhe në atë muaj nuk kanë mundur me hy dhe tek muajin prill kanë fillu me u nda buxheti për paga për staf dhe menaxhim.

Petri Gashi, kam një pyetje: ne shpeshherë kemi ngrit çështjen për ikjen e bizneseve nga Drenasi dhe është mirë me dit qytetari i Drenasit se a është ky si rezultat i mbylljes së bizneseve ose ikjen apo heshtjen bizneseve për arsye se mbi 4 mijë biznese sa kanë qenë të regjistruara të fundit kujtoj se kanë dal 900, dhe kjo në mënyrë të heshtur po tregon që nuk janë duke funksionuar bizneset në Drenas dhe janë duke ikur bizneset në Drenas. Sa i përket asaj faturat e tatimi në pronë me ia dergu njerëzve shpresoj që me ia dergu edhe kryetarit Lladrovci sepse dje sipas mediave thuhej që i kishe mbi 2 mijë euro tatim në pronë dhe në seancën e radhës ta dimë që i ka kry obligimet sipas ligjit, dhe mos të këtë të paktën ai obligime ndaj komunës.

Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Biznese Egzona Jetullahu, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik varësisht viteve paraprake që asnjëherë nuk ka pas regjistrim të bizneseve aktuale në Komunën e Drenasit për herë të parë ka bërë regjistrimin e bizneseve që janë aktive në Komunën e Drenasit dhe prej janarit të këtij viti 2019 janë 124 biznese të reja të cilat janë të paraqitura, këtë mund ta shihni edhe ne metabazën e Komunës së Drenasit. Shqetësimi tjetër është që po thoni që po ka ikje të bizneseve, rregulloren jeni ju ata të cilët e keni votuar dhe bizneseve iu shkon taksa në bazë të asaj rregulloreje të cilën ju e keni votuar. Nuk është e vërtetë që ka humbje apo ikje të bizneseve. Ndoshta munden me qenë dy prej tyre të cilat kohë më parë e kanë bërë regjistrimin e bizneseve për çështje të riatdhesimit e kanë hap ndonjë biznes dhe për t'i marrë mjetet ata që kanë qenë të riatdhesuar. Ne jemi duke bërë përpjekje të mundshme që me sjellë sa ma shumë investitor në Komunën e Drenasit.

Vehbi Berisha, sa biznese të reja kemi?

Drejtoreshë për zhvillim ekonomik dhe biznese Egzona Jetullahu, prej janarit të këtij viti i kemi 124 biznese të reja dmth që nuk kanë ndikuar aspak negativisht.

Petrit Gashi, biznesit në fjalë të cilës i referoheni me një takse 550 mijë euro duke e ngarkuar mbi 70 mijë euro në vit nuk e ka votuar asnjë prej asamblistëve që janë këtu dhe nuk i referohet atij, biznesi në fjalë e ka mbyll biznesin dhe ka shkuar në Qagllavicë, i cili ka hap biznes të ri atje.

Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Biznese Egzona Jetullahu, arsyeja në fjalë ndaj biznesit ndaj një X biznesi të caktuar, ai biznes ka ekzistuar si shkritore dhe asnjëherë nuk është definuar, i kemi të gjitha shkresat në bazë të Ministrisë të Tregtisë në bazë të MAPL-së dhe Financave që do të thotë ajo duhet të definohet në bazë të rregullores që e kanë votuar asambleistët e Kuvendit Komunal dhe biznesi në fjalë e ka shuar veprimtarinë ish shpk për shkrirjen e mbeturinave metalike që asnjëherë nuk e ka e ka bërë ripërtrirjen e certifikatës së tij që u dashtë në arbk pastaj me ardh këtu për arsye që e ka pas taksen 70 mijë euro për çdo vit, dhe nuk është e vërtetë që ka shkuar gjobë apo vendimi 550 mijë euro për arsye se dy vite paraprake, s'di sa herë z.Lleshin, e kom pas në zyrën time dhe mundesh me diskutuar dhe ti dhe kush do tjetër e kemi diskutuar këtë çështje janë dëshmi prej inspeksionit, janë dëshmi prej Ministrive të ndryshme, prej AKPM-së, prej ARBK-së dhe të gjitha dëshmitë që e definojnë si shkritore dhe atëherë mua më ka mbet vetëm në bazë të rregullores të K.K më ia dhënë ngarkesën, 3 mijë ton i ka çdo vit që bënë shkrirje, dhe në të gjitha dokumentet unë e kam

dosjen komplet nëse je i interesuar që mundesh më paraqit pala ka drejtën e ankesës së saj është komisioni që e bënë shqyrtimin e asaj ankese dhe në bazë të dëshmive të sjellura kanë mbet dy vitet paraprake që ministritë në fjalë e kanë definuar si shkritore biznesin në fjalë dhe biznesi në fjalë është duke operuar në Komunën e Drenasit dhe prapë e ka bërë regjistrimin por jo si KMI shpk.

Burim Bujupi, sa i përket raportit tre mujor ende nuk është përfundimtar sepse ka qenë më mirë në gjashtë mujorin e parë me marrë raportin, por këtë shqetësim e kam ngrit edhe në K.P.F-ca se duke e krahasuar me vitin paraprak me tani ne kemi një ngecje prej 13.57% është një humbje për ne, unë mendoj se krejt kjo është për shkak të pamundësive të bizneseve me operu në komunën tonë për shkak se nuk e kemi një qeverisje si duhet, psh ne e kemi votuar rregulloren për Taksa Tarifa dhe Gjoha dhe kishte qenë mirë me ardh edhe një herë ajo propozim rregullore dhe me i bërë disa ndryshime. Sa i përket drejtorisë për biznese ne e kemi një statistike që kanë bërë regjistrimin e bizneseve momentalisht janë 980 biznese por pse nuk po na jep një arsyetim ku janë mbet 4 mijë biznese që kanë qenë të regjistruar, pse kanë ik ato?

Sabrije Kukaj, për hir të transparencës dhe që po flitet për 4 mijë biznese që ekzistojnë në Komunën e Drenasit, po iu njoftoj që unë kam punuar në institucion bankar dhe kur e kam marr prej komunës sa biznese janë në Drenas ka qenë një shifër kështu afër diku, por realisht nuk janë këto biznese dhe nuk kanë qenë kurrë, faktikisht ose janë hap si biznese janë mbyll brenda 3-4 muajve dhe nuk e kanë bërë çregjistrimin e biznesit, ka pas në komunë, ka pas firma që ka pas dy firma të regjistruara njërën vetëm në letër jo efektive dhe tjetrën funksionale dhe asnjëherë kurrë nuk kanë qenë 4 mijë biznese efektive në Komunën e Drenasi, këto kanë qenë biznese të regjistruara dhe nuk kanë vazhduar, nuk ka ik bizneset.

Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Biznese Egzona Jetullahu, prej vitit 2000 e tutje ekzistojnë biznese të shumta të cilat ishin të regjistruara në Komunën tonë, arsyeja është që biznese të shumta deri në vitin 2019 në bazë të listës të ATK-së që unë i kam kërkuar janë 2024 biznese arsye është që bizneset e ndryshme e kanë bërë hapjen e tyre dhe nuk kanë vazhduar veprimtarinë ndoshta për një vjet, dhe nuk i kanë sjellë deklaratimet me 0 prej ATK-së për me mbyll biznesin, çdo here që kam kërkuar unë të dhëna nga ATK çdo here ma kanë dhënë një shifër shumë të madhe të bizneseve, arsyeja pse na ka shti neve me bën regjistrimin kemi dal ne teren dhe kemi bërë regjistrimin e tyre. Do të bëjë përpjekjen maksimale që Drenasi të jetë qelës i zhvillimit ekonomik.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, asnjë biznes në komunën tonë nuk është larguar nga Drenasi për shkak të taksës që është vendos në Kuvendin Komunal. Komisioni është duke punuar në këtë drejtim është në dorën e juaj me i caktu taksat.

Petrit Sinani, ne se bashku me kolegun Burimin dhe Hamitin jemi në komisionin për hartimin e rregulloren për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoha, kemi pas një takim dhe u ngrit i njëjti shqetësim që në komunën tonë në bazë të ARBK-së janë 4 mijë biznese ndërsa në bazë të ATK-së janë 2 mijë e diçka në bazë të regjistrimit fizik ka dalë që janë afër 980 biznese, nuk po jam bash i saktë në shifra. Normalisht që ka shumë indikator që ndikojnë në shuarjen e bizneseve

për ata që janë me ekonomi, janë tjerë indikator, për mendimin tim taksa nuk është njeri prej indikatorëve të cilët i detyron bizneset me u largu, mirëpo unë nuk pajtona me drejtoreshën kur e përmend rregulloren për taksen për taksa tarifa dhe gjoba kjo nuk ka të bëjë me shuarjen e bizneseve. Rregullorja ia cakton taksen bizneseve për me operu, ne i kemi ngarkuar me taksa ato biznese të cilat kanë mundësi me pagu ndërsa i kemi heq apo i kemi largu me një taksë minimale ato biznese që nuk kanë mundësi me i pagu, ndërsa ekziston edhe një faktor psh. disa biznese që janë të regjistruara si NTP ndërsa qarkullimin vjetor e kanë afër 2-3 milion euro dhe duhet me pas parasysh që ai biznes nuk mundet me kalu me 0 taksë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, grupi të cilën e kemi marrë me momerandum me ministrinë e mirëqenies sociale janë duke e kry punën e vet dhe duke i regjistruar çdo biznes dhe me GPS e regjistrojnë çdo biznes ku e ka biznesin, ne po i regjistrojmë bizneset për here të pare pas 20 viteve.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:
4. Propozim vendim për lejimin e largimit/demolimit të disa ndarjeve, sporteleve dhe kryerjen e disa punimeve brenda hapësirës së QKMF-së "Dr.Hafir Shala" në Drenas.

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu, e kemi këtë propozim vendim për ndarjen largimin apo demolimin e disa sporteleve për implementimin e mjekësisë familjare që janë në fazën fillestare të gjashtë muorit të parë, janë gjithsej dy ordinanca që të krijojnë kushte të parapara sipas këtij udhëzimi administrativ janë ndarje plastike me qelq, ky implementim ka qenë me herët diku në vitin 2010 dhe tani me hapjen e sportelit të ri dhe rianzhimit të pacienteve poshtë ka lind nevoja që këto kushte të nevojshme për implementim të mjekësisë familjare, dhe dy pika janë në hyrje të emergjencës ku njëra duhet të jetë një sportel paraqitesh dhe tjetra një muri për ndarje. Qëllimi i këtij propozim vendimi është këto janë punë të lehta të cilat nuk kërkojnë shtim të buxhetit por do të kryhet nga kategoria mallra dhe shërbime që janë të qendrës së mjekësisë familjare, janë korniza të xhamit të vendosura e cila është e nevojshme të hiqen ato në mënyrë që të rritet kualiteti i shërbimeve, në mënyrë që të zvogëlohet koha e pritjes dhe të përmirësohet evidentimi i statistikave me sistemin e digjitalizimit që tani e kemi në funksion. Kërkoj ta votoni këtë propozim vendim.

Sokol Bylykbashi, sa i përket propozim vendimit për lejimin e largimit/demolimit të disa ndarjeve, sporteleve dhe kryerjen e disa punimeve brenda hapësirës së QKMF-së, nuk është formuluar me terme të sakta, do të ishte mirë me qenë fjala konstruksion (ndërtim i brendshëm) dhe kjo demolim i bien shkatërrim dhe nuk shkon fare, do të ishte mirë me formulu si duhet.

Sa i përket këtij propozim vendimi është se unë mendoj që Kuvendi Komunal nuk merret me këto rikonstruksione, nëse një objekt i komunës që menaxhohet nga komuna dëshiron të bëjë ndryshim nuk është punë e Kuvendit Komunal nuk merret me rikonstruksione të objekteve që i menaxhon vet, nese kërkohet leje për më bë ndonjë ndryshim është mirë me dhanë leje drejtoria e urbanizmit, pra ajo jep leje për ndërtim dhe ajo mund me dhënë leje për me ndryshu diçka. Sa i përket kërkesës së këshillit drejtues të QKMF-së duhet me i përkrah se ata më së miri

e dinë se si iu përshtatet hapësira e brendshme dhe konstruktive të hapësirës së brendshme për me punu në mënyrë më efektive.

Vehbi Berisha, sa i përket këtij propozim vendimi unë i kam disa paqartësi prandaj dua t'i shpreh ato paqartësi, me sa di unë nuk ka shumë ditë që keni bërë një përrurim që janë krijuar disa sportele të reja në QKMF në katin e parë, me sa di unë kuvendi nuk ka marrë asnjë vendim për ato, sa i përket demolimit nuk është punë e doktorit me u merr me demolime, ndoshta është ide e tyre apo rekomandim, na si institucion na takon me punu sipas procedurave standarde që kur është puna e inxhinierit me fut ne këtë komision një inxhinier që kupton këto gjera. Pyes për ato sportele tjera që i keni ndërtuar kush ka marr vendim e pse për ato po bejka me i ndertu për këto nuk po bejka me i demolu?

Sabrije Kukaj, edhe mua më duket pak e paarsyeshme me ardh kjo në kuvend për arsye se ne i kemi dhënë 100 mijë euro për rinovim dhe rinovimi është dashtë me i paraparë edhe largimin e sporteleve edhe ndërtimin e tjerave dhe të gjitha, mua nuk më duket e arsyeshme kjo me ardh në kuvend me marr vendim me i heq disa plastika e me i vendos tjetër kund, kur kemi marr vendim dhe kemi ndarë mjete për rinovim të shtëpisë së shëndetit u dashtë këtu me hy te gjitha atëherë, nëse e keni për me dhënë mjete për me ndryshu atëherë është dashtë me nda mjete për me rregullu diçka dhe kaq.

Petrit Sinani, unë po mendoj që arsyeja e këtij propozimi është në mënyrën dhe formën ma të mirë, drejtori po konsideroj që e ka sjellë këtë propozim vendim që me qenë formën ma të rregullt në të gjitha format ligjore të këtij propozimi dhe nuk ka dashtë me thy a diçka, pas i që drejtori tha që do t'i marrim mjetet prej kategorisë mallra dhe shërbime, implikim buxhetor nuk ka, kategorinë ku kanë më u marrë ekziston, unë mendoj ky propozim realisht mos nuk po jemi në rregull në rast nëse e votojmë këtë propozim.

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu, qëllimi i krejt kësaj është se ajo çka është bërë me herët ka pas një kosto dhe nuk po dojmë ne atë material me hedh diku se është shpenzua diçka, projekti i ndërtesës është i viteve të 80-ta dhe tjetër sistem ka qenë i funksionimit të shtëpisë së shëndetit atëherë dhe tjetër sistem tani me udhëzimin administrativ 08/2017, ato ndarje nuk kanë ekzistuar po ndërkohe janë bërë dhe ne vetëm kërkojmë pëlqimin tuaj t'i heqim.

Vehbi Berisha, unë pyeta qartë, ju i keni ndërtuar sportelet poshtë nuk na keni na keni pyet, e për këto po na pyetni, çka është kjo punë, mos po tentoni me këtë propozim vendim, se dikush e ka dëmtuar buxhetin kur i ka ndërtuar ato tash me mbulu me thënë që kuvendi e ka marrë vendim!

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu, ajo është investim që e ka bërë AQH-ja, vlere e te cilit ka kushtu 25 mijë euro dhe është dhënë leje sipas udhëzimit administrativ 08/2017.

Burim Bujupi, realisht ne nuk e morëm përgjigjen e duhur kur e pyeti kolegu jonë Vehbia drejtorin, shumë qartë po thotë kur është bërë punimi ma herët ka pas koso sigurisht dhe nuk

ka ardh ne kuvend ndersa tani po behet prape pune dhe e keni sjelle ne kuvend cka po fshihet mbrapa kesaj? Kerkojme pergjigje adekuat!

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, kuvendi i Drenasit ka miratu buxhet për meremetimin e QKMF-së vite më parë dhe i ka bërë ato ndarje për cka po flasim, rregullorja 2017 thotë ndryshe atë sportel që tha drejtori që tha ka kushtuar 25 mijë euro që me pas të qartë ju nuk ka kushtuar sporteli 25 mijë euro, ka kushtu krejt teknika me softuerë, me kompjuterë me regjistrim se çdo pacient që regjistrohet dhe të gjitha këto kanë kushtuar 25 mijë euro ndërsa në dhomat e mjekeve kërkohet me u heq investimi që e ka miratuar kuvendi vite me parë dhe ai ka pas kosto dhe për këtë kërkohet leje, leja duhet t'i jepet nga kuvendi.

Sokol Bylykbashi, unë nuk po flas se cka ka ndodh më herët se është temë tjetër vetëm edhe një herë dua të flas për rendësin e propozim vendimeve, kur bëhet një propozim vendim dhe vjen këtu gjeja e parë që duhet me pas parasysh është si është ligjshmëria në aspektin normativ pastaj vjen qëllimi përmbajtja e kështu me radhë, nuk është punë e Kuvendit Komunal me u marrë me rikonstruktime të objektit që e menaxhon.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, një mall që është vendos dhe ka kushtuar ka pas kosto na duhet me marr leje me e heq se ka investuar komuna vetëm për këta.

Nexhmedin Balaj, isha konfuz kur e pash propozim vendimin sepse janë punë që është dashtë t'i takojnë ekzekutivit mirëpo kur e pash që është një vendim i Kuvendit Komunal për vendosjen e sporteleve atëherë është bërë një punë e paplanifikuar mirë dhe normal që kërkohet nga kuvendi me u shfuqizu apo me marr vendim të ri që e hedh poshtë atë dhe nuk kanë ata përgjithësi në të ardhmen, thjesht është një punë e paplanifikuar mirë që ka ndodh në një periudhë të caktuar, kuvendi i ka ndarë ato mjete dhe na sot kerkojme që me bërë një propozim vendim të ri dhe gjera me ec përpara, mua me gëzon fakti që ne QKMF në Drenas ka fillu të ketë përmirësime të mira këtu dhe jemi një mandat komplet i ri dhe nuk jemi një mandat që i kemi marrë ato vendime gabim, dhe te shkojmë përpara nëse dojmë të jem në shërbim të qytetareve dhe të shikojmë vetëm përpara atëherë t'i marrim vetëm anët pozitive të këtij propozim vendimi mos t'i marrim anët negative se cka ka ndodh para disa viteve. Ju ftoj me votu për sepse nuk ka ndonjë përgjithësi as ndonjë implikim buxhetor, qenka mallra dhe shërbime.

Kryesuesi Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar:

Për votuan 25 anëtar

Kundër votuan 0 anëtar

Abstenim votuan 03 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me: a) Komunën e Vushtrrisë, b) Komunën e Skenderajt, c) Komunën e Obiliqit.

Beqir Kiqina, këto propozim vendime janë veprime shumë të qëlluara, por nuk e di a ka një plan serioz konkret që edhe komuna Drenasit që me bashkëpunua me ato, me komunën e Skenderajt deri më tani nuk ka pas diçka ndonjë veprim komunal institucional mes dy komunave e aq më pak ne pjesën e infrastrukturës, por mua çka po me pengon fakti që komuna e Drenasit nuk e ka shfrytëzuar buxhetin në mënyre racionale dhe ka pas suficite, unë kisha dashtë që Komuna Drenasit me i kryt gjitha obligimet ndaj qytetareve pastaj me hy ne ndervepime nderkomunale, bashkëpunime me komuna tjera.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Komuna Drenasit ka bashkëpunim edhe me komunat tjera rruga Baks-Shtuticë tash e kemi përfunduar Qirez-Likoshan ka qenë me herët, rrugën Skenderaj-Drenas, kanalizimin e ujërave të zeza po e ndërtojmë bashkërisht me projekt të përbashkët dy komunave, rrugën Abri e Ulet- Abri e Naltë e kemi bërë vitin e kaluar, rruga po ashtu Abri – Likoc.

Sokol Bylykbashi, është një kornizë ligjore që na mundëson dhe është mundësi me pas bashkëpunim nderkomunal dhe këtë duhet me shfrytëzuar, është hera parë që kemi propozim vendime të tilla dhe si nismë është për tu mirëpritur. Ajo çka na mbetet neve është me i votu këto propozim vendime që na jep mundësinë më bashkëpunuar me komuna tjera për interesa të përbashkëta dhe në bazë të këtyre propozim vendimeve pra mbetet të shohim ne si asamblist propozim marrëveshjet që i bënë kryetari i komunës sonë më kryetaret e komunave tjera, e kur t'i kemi propozim marrëveshjet mund të flasim se çka konkretisht dhe sa ja vlen me u merr me këto propozim vendime. Si mundësi është e mirë dhe unë e mirëpres.

Kryesuesi Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar:

Për votuan 28 anëtar

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim votuan 00 anëtar

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:
6.Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Obiliqit.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar:

Për votuan 28 anëtar

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim votuan 00 anëtar

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:
7.Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Lipjanit.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar:

Për votuan: 28

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

8.Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar:

Për votuan: 28

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës:

9.Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Malishevës

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan: 24

Kundër: 02

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Propozim vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Klinës.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar:

Për votuan: 27

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues, për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.**

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ka ndryshuar ligji, ligji në fuqi tani 03-L/093 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës neni 17 të këtij ligji i cili specifikon se zbatimin e procedurave dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës formon komision vlerësues me përbërje prej 5 anëtareve 2 ekzekutiv, 2 asamble dhe 1 shoqëri civile, deri tani kanë qene 7 anëtar, ne përbërje te tij kanë qene komision Flutura Avdiu dhe Safet Hoxha i cili

mbetet prapë i njëjtë me këta dy anëtar, ndërsa nga pozita ka qenë Qendrim Mulaj ndërsa nga opozita kanë qenë 2 anëtar tani e keni një këta i zgjidhni ju një nga pozita dhe një nga opozita.

Gani Podrimqaku, në emër të grupit parlamentar të PDK-së propozojmë Florentina Kukaj.

Petrît Gashi, pasi që unë kam qenë pjesë e këtij komisioni tërhiqem, dhe ne si opozitë propozojmë Sabrije Kukaj.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, a pajtoheni që komisioni ta ketë këtë përbërje:

1. Flutura Avdiu- anëtare nga ekzekutivi
2. Safet Hoxha-anëtar nga ekzekutivi
3. Florentina Kukaj – anëtare nga kuvendi
4. Sabrije Kukaj –anëtare nga kuvendi
5. Arben Kuliqi- anëtar nga shoqëria civile, ju ftoj të votoni

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit me këtë përbërje të komisionit prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar: **Për 29 anëtar, Kundër: 00, Abstenim:00**

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: **12. Propozim vendim për formimin e komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afat gjatë të pronës se paluajtshme të komunës.**

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, prej shoqërisë civile ju që e keni propozuar Alban Bujupin nëse ju jeni dakord me këtë anëtar prapë, ndërsa në kuadër të ekzekutivit është Armend Hajdini, ndërsa opozita e ka pas Adem Bucollin

Gani Podrimqaku, nga PDK-ja propozojmë prapë Adem Bucolin.

Burim Bujupi, ne opozita propozojmë Sokol Bylykbashin.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, meqenëse ende nuk me ka ardh anëtari i ekzekutivit propozoj Rinore Zymberin.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, a pajtoheni që komisioni ta ketë këtë përbërje:

- Rinore Zymberi- anëtare nga ekzekutivi
Armend Hajdini- anëtar nga ekzekutivi
Adem Bucolli- anëtar nga Kuvendi
Sokol Bylykbashi-anëtar nga Kuvendi
Alban Bujupi-anëtar nga shoqëria civile

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit me këtë përbërje të komisionit prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar: **Për 29 anëtar, Kundër: 00, Abstenim:00**

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës: 13. Propozim Vendim për vendosjen e shtatoreve të heronjve Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Ilaz Kodra e Bedri Shala në sheshin "Fehmi Lladrovci" i plotësuar.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, Ministria e Planifikimit dhe Ambientit ka kërkuar dokumente shtesë në u dashtë me ia bashkëngjit edhe lejen e ndërtimit, prandaj ju ftoj ta votoni këtë propozim vendim me bashkëngjitjen e vendimit për leje ndërtimi.

Sokol Bylykbashi, unë e kuptoj hezitimin e asamblistëve për me fol për këtë pikë të rendit të ditës për shkak se ekziston mundësia më u keqpërdor fjala, mendimi, me u keqkuptua dhe me u keqinterpretuar, ne e dimë që vitin 2009 sheshi në qytetin tonë është emëruar me emrin e heroit Fehmi Lladrovci i cili është një vendim i drejt, po ashtu e dina që ne si asamble kemi miratuar një buxhet simbolik për ndërtimin e shtatoreve dhe mendoj që është një vendim shumë i drejtë. Të gjithë mendoj se pas miratimit besoj që keni fol, po është mirë të flasim edhe këtu, për shkak se jemi asamblist dhe kur janë temat e ndejshme është mirë me marr guxim dhe përgjithësi me fol. Sa i përket propozim vendimit të kryetarit besoj që është qellim mirë, mirëpo sa i përket kësaj duhet me fol pak ma shumë dhe me shterr debatin për shkak se kjo punë është e ndejshme, por unë nuk jam kundër kësaj, por si shesh janë disa kriteret që kërkon ndoshta debat më shumë, po sipas mendimit tim nuk mundet me qenë shtatorja Adem Jasharit në sheshin "Fehmi Lladrovci" anasjelltas po, si mundet me qenë Adem Jashari në sheshin "Fehmi Lladrovci". E sa i përket numrit të shtatoreve mua më kanë thënë qytetaret ndoshta shumë, por ndoshta ka qenë mirë me ia lënë vet qytetareve me pas ndonjë dëgjim publik a ndonjë konsultim.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ne me Sokolin dhe disa asamblist tjerë e kemi diskutuar këtë çështje, por rendësi ka me u vendos shtatoret, e ceke se komuna ka nda buxhet për shtatore por komuna ka nda buxhet për shtatore prej vitit 2009, por krejt ai buxhet ka shkuar suficit ose ka shkuar tjetër kund sepse nuk kanë fillu me këtë punë. Në prill edhe 4 dit bëhet inaugurimi i shtatores Iliaz Kodrës në datat dhe kohen standarde që kemi thënë se ne do t'i përfundojmë këto punime dhe po bëhen pa ia harxhuar asnjë cent komunës ndërsa po ia rrit vlerën e pasurisë se komunës, kjo temë se a duhet me qenë shtatorja e Adem Jasharit në sheshin "Fehmi Lladrovci", se pak rendësi ka emri i sheshit. Ju ftoj që t'i votoni, me 30 maj po presim me vendos edhe shtatoren e Rasim Kiqinës dhe Bedris përnjëherë. As një cent as e komunës, as e qeverisë as e buxhetit të shtetit tonë nuk është harxhuar dhe nuk harxhohet për këto çështje.

Adem Bucolli, ky propozim vendim është shumë i qëlluar por mendimi im është pak rendësi ka se si e mban emrin sheshi apo vendi ku vendoset shtatorja e Adem Jasharit heroit kombëtar, rendësi ka me u vendos. Unë kam një propozim tjetër me e rrit sheshin prej bankave me bashku sheshin dhe me vendos ende shtatore tjera se vetëm në atë formë mundemi me ia kthi dëshmorëve tanë dhe familjareve të tyre.

Petrit Gashi, siç e dini kur ka ardh ky propozim vendim në anonimish e kemi përkrah e gjithë grupet të gjithë asamblistët që janë këtu në kuvend, mirëpo ky vendim ka hapur edhe shumë

shqetësime dhe familjareve të dëshmoreve të tjerë jashtë këtyre listave të cilët ne nuk i përmendem prandaj më të drejtë qytetaret na pyesin në rrugë na pyesin se pse po ndahen dëshmoret apo po seleksionohen ata, pse psh nuk është edhe Ragip Halilaj, pse psh. Nuk është edhe ushtari më i ri i UÇK-së Mentor Gashi pse nuk është shtatorja e Ymer Alushani, Gani Kastrati, Mentor Morina, Ramadan Bytyqi, Halim Bajraktari, Azem Kastrati, Abedin Bujupi e shumë dëshmorë të tjerë , pra qëllimi nuk është pse ne nuk po e përkrahim këtë, ne po e përkrahim fuqishëm se sa do që vendosim qoftë shtatore apo diçka tjetër ne nuk do t'i dalim hakesh atyre që kanë dhënë jetën për këtë vend por me një far forme si do t'ju përgjigjemi familjareve të tyre të cilët mendojnë se po iu behet seleksionim edhe i dëshmoreve edhe vendosjeve të shtatoreve të dëshmoreve në këtë shesh. Dhe është mirë që unanimisht ashtu siq e votuam, të gjejmë edhe zgjidhjen për përgjigjet e atyre që asnjëri nga familjalet e dëshmoreve mos të ndihet i lënduar.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci , unë i kam lexuar shkrimet disa prej familjareve të dëshmoreve, sa viktimat dhe dëshmoret i ka komuna jonë, ne përmes këtyre shtatoreve që po i bëjmë pa asnjë cent po i bëjmë me para të njerëzve vullnet mirë që dojnë me ndihmu dhe me i ndërtuar, këta për momentin, nuk e ka mohu askush se ne do të ndërtojmë shtatore të reja, asnjë hero nuk e ka rëndësinë ma te vogël ose ma te madhe, lufta nacional çlirimtare ia ka pas 28 mijë dëshmorë në Shqipëri, po nuk janë 28 mijë shtatore, por mos luani me ndjenja të familjareve sepse askush nuk mundet me i nderu dhe respektuar më shumë se ne që i kemi familjar.

Gani Podrimqaku, ne këtë propozim vendim vetëm e kemi kaluar vetëm kërkoj që te votohet ky propozim për arsye të disa ndryshimeve teknike që janë bërë.

Beqir Kiqina , sa i përket këtij propozim vendimi nuk mendoj që ndonjëri prej asamblistëve të Kuvendit Komunal do të ishte kundër që ato të jenë prezent në mesin tonë, sa i përket shqetësimeve të mija është që historia e popullit shqiptar me u përkujtuar edhe më herët, e dimë që të gjithëve nuk mundemi me i ndertu shtatore sepse Drenasi është një vend i vogël dhe sheshi nuk mjafton për të gjitha shtatore, por kisha dhënë propozim që mos të harrohen edhe luftërat e tjera psh. Lufta e Shaban Polluzhes , Shaban Polluzha të këtë të paktën pllakë përkujtimore edhe komuna t'i bëjë kërkesë ministrisë përkatëse që të përfundojë kulla e Shaban Polluzhes, dhe të përkujtohen në mënyra të ndryshme edhe Mehmet Gradica e disa dëshmorë të tjerë. Mirëpo padyshim që lufta e UÇK-së është Emblema e Lirisë sonë, por sheshi jonë për nga madhësia është i vogël por nëse ka shtatore tjera mos t'i vendosim të gjitha në këtë shesh por t'i gjeni hapësira tjera për arsye se mos të bëhen mbi popullim i shtatoreve përsëri në këtë shesh.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit,prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar:

Për votuan 30 anëtar

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim votuan 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katërbëdhjetë të rendit të ditës: **14. Propozim Vendim për lejimin e rrënimt të objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadastrale në Drenas, ish objekti për sigurime sociale, i plotësuar .**

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, siç e cekem për ndërtim kërkohet leje nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit hapësinor njëjtë kërkohet leje edhe për rrenim, kështu që edhe këtë dokument na ka kërkuar Ministria e Planifikimit Hapësinor përmes MAPL-së, tani jemi pasi me të gjitha dokumentet me leje rrënimi, ju ftoj që ta votoni.

Sokol Bylykbashi, mbledhjen e kaluar për këtë propozim vendim kam votuar për, dhe prapë do të votoj për, se e kam dhënë arsyetimin, por në propozim vendim puna e lejes që vjen nga Drejtoria e Urbanizmit leje rrënimi dhe vendimit tonë këtë nuk po mundem me kuptu dhe po më duket që nuk është mirë, Kuvendi Komunal në raport me objektet, ne marrim vendim psh nëse do të ndërtohet një objekt në kuadër të komunës, atëherë neve na bien me votu për dy arsye, e para se paret ne i dhajmë vet nëse dojmë më investu dhe e dyta në shfrytëzim toka që jepet, këtu në aktvendim thuhet që brenda 15 ditëve, pyes se çka nëse në mënyre hipotetike Kuvendi Komunal nuk e voton? Mendoj që nuk është punë e jona kjo, mendoj se është punë e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Inspektoratit pa ardh në asamble hiq, por unë prapë votoj për.

Vehbi Berisha, natyrisht që edhe unë e përkrahi këtë propozim vendim, për arsye që objekti në mënyrën që është paraqet edhe rrezik edhe për fëmijët sidomos që shkojnë në atë zonë. Kur është djegur ky objekt, policia e Kosovës ka nis një procedurë hetimi, nuk e di a ka ardh ndonjë njoftim a ka qenë djegie e dyshimtë apo diçka e ngjashme apo rastësisht ka ndodh zjarri sepse nuk pash diçka të tillë në arsyetim dhe me interesoj me ditë a u merr dikush më këtë rast.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, policia nuk jep njoftime a ka qenë e dyshimtë apo nuk ka qenë e dyshimtë, është gjykata që vendos pas gjitha procedurave se si ka ardh deri aty, por policia si për aneksin e shkollës në Abri, dhe na kanë thënë që mundesh me i zhvillu gjitha procedurat se ne i kemi perfundu procedurat tona.

Nexhmedin Balaj, mendimin tim për rrënimin e këtij objekti e kam dhënë seancën e kaluar, prapë qëndroj të njëjtin mendim, por kam një kërkesë në kundër të qytetit të Drenasit ka edhe objekte tjera të cilat janë në një shkallë të rrezikshmërisë dhe drejtoria e inspektoratit dhe urbanizmit në të ardhmen të na sjellë edhe ato objekte për rrenim.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit, prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar:

Për votuan 21 anëtar

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim votuan 06 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës: **15. Propozim vendim për plotësimin për emërtim të rrugëve, rrugicave në Komunën e**

Drenasit. Emrat që i keni propozu dhe prapë propozohen janë këta: Bekim Lestrani, Kimete Bardhi, Burim Bujupi Gentrit Gerguri, dhe Petrit Gashi, propozimi është i njëjtë, ju ftoj të votoni.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan 26 anëtar

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim votuan 00 anëtar..


Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës: **16. Të ndryshme.**

Adem Bucolli, kam një pyetje për drejtorinë lidhur me hapësirën me qira ku është destinacioni ku janë lodrat e fëmijëve, kam një ankesë prej disa të interesuarve që dojnë me marr atje që kosto është shumë e lartë dhe nuk e kanë përcaktuar çmimin që për ata është e papërballueshme.

Drejtoresha e Planifikimit hapësinor Flutura Avdiu , siç e dimë ka kaluar komisioni për tarifa ngarkesa dhe gjoba, ne këtë shqetësim tuajin do t'ia përcjellim komisionit që të përcaktohet saktë edhe për ato hapësira në të cilën nuk është specifikuar, të gjitha jemi duke i plotësuar por përcillemi në email dhe të gjitha do t'ia përcjelli kryetares së komisionit, dhe këtë rekomandim do ta vendosim në rregulloren e ardhshme që pritet të vij në kuvend.

Mbledhja përfundoj në ora 14:10 min

Procesmbajtëse:
Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 22.05.2019, si vijon:

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj pasi hapi mbledhjen e K.P.F-ca i cili njoftoi me rendin e ditës dhe kërkoj që a ka diçka lidhur me rendit të ditës apo diçka shtesë?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, kërkoj që për kuvend të futet dhe një pikë shtesë propozim vendim për

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 18.04.2019, pasi nuk pati diskutime dhe vërejtje kaloj kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Propozim vendim për ridestitim të mjeteve.

Edhe ky propozim vendim kaloj për kuvend pa ndryshime me: 07 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Propozim vendim për formimin e këshillit drejtues për NPL-SHA Stacioni i Autobusëve- Glllogoc

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

për votuan 07 anëtar

Kundër asnjë

Abstenim asnjë.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria për mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:


për votuan 07 anëtar

Kundër asnjë

Abstenim asnjë.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Të ndryshme. Nuk pati asgjë konkrete.





Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 22.05.2019, si vijon:

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj pasi hapi mbledhjen e K.P.F-ca i cili njoftoi me rendin e ditës dhe kërkoi që a ka diçka lidhur me rendin e ditës apo diçka shtesë?

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, kërkoi që për kuvend të futet dhe një pikë shtesë propozim vendim për plotësim/ndryshimin e komisionit ndryshimin e Stëmës dhe Vulës së Komunës së Drenasit.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 18.04.2019, pasi nuk pati diskutime dhe vërejtje kaloi kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Propozim vendim për ridestnim të mjeteve.

Edhe ky propozim vendim kaloi për kuvend pa ndryshime me: 07 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Propozim vendim për formimin e këshillit drejtues për NPL-SHA Stacioni i Autobusëve- Glllogoc

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

për votuan 07 anëtar

Kundër asnjë

Abstenim asnjë.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria për mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

për votuan 07 anëtar

Kundër asnjë

Abstenim asnjë.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Të ndryshme. Nuk pati asgjë konkrete.



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060 - 34197 dt. 20.06 2019

Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
31.05.2019

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 31.05.2019

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 30 anëtarë mungoi Adem Bucolli.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 25.04.2019
2. Propozim vendim për ridestinin të mjeteve.
3. Propozim vendim për formimin e këshillit drejtues për NPL-SHA Stacioni i Autobusëve-Gllogoc.
4. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria për mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale.
5. Propozim vendim për plotësim/ndryshimin e komisionit ndryshimin e Stemës dhe Vulës së Komunës së Drenasit
6. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 31/05/2019 ishin: Nënkrjetari i Komunës z. Gani Syla, përfaqësues të OSCE-së, si dhe drejtor të Drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- pasi përshëndeti të gjithë, hapi diskutimin për rendin e ditës dhe kërkoj nga anëtarët e kuvendit se a pajtohen me këtë rend dite, apo ka ndonjë propozim?

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan 26 anëtar,

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 25.04.2019.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar:

Për votuan 25 anëtar

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Propozim vendim për ridestnim të mjeteve.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar:

Për votuan 25 anëtar

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: 3.

Propozim vendim për formimin e këshillit drejtues për NPL-SHA Stacioni i Autobusëve-Glllogoc.

Beqir Kiqina- pasi përshëndeti të gjithë, të kjo pikë e rendit të ditës propozoi që ky komision të reflektoj përbërje nga Kuvendi Komunal edhe nga pozita edhe nga opozita pasi që ky numër

është dy propozoi që një të jetë nga pozita dhe një nga opozita, dhe shpresoj që ky komision të kryej punën e vet në pajtim me rregulloren e kuvendit.

Drejtoreshë për shërbime të qytetareve dhe emergjencë Lumniye Krapi- propozoi: *Ruzhdi Lestrani - anëtare nga ekzekutivi*

Nga Stacioni i Autobusëve përbehet nga dy anëtar:

Heteme Rrusta - anëtare nga ekzekutivi

Remzi Dervishi - anëtare nga ekzekutivi

Vehbi Berisha- krejt këto që po i themelojmë a do të miratohet në kuvend?

Drejtoreshë për shërbime të qytetareve dhe emergjencë Lumniye Krapi- ky këshill që formohet kanë më e hartu statusin pastaj vjen në kuvend, del në dëgjim publik dhe mandej shkojmë me procedura tjera.

Gani Podrimqaku- nga pozita propozoi: Bujar Dervishin-anëtar nga kuvendi.

Vehbi Berisha, nga opozita propozoi- Petrit Gashin- anëtar nga kuvendi.

Petrit Gashi- unë nuk jam kundër asnjë anëtari të komisionit por Bujari Dervishi nëse është pjesë e anëtarit të komisionit MAPL-ja do të ia kthejë mbrapa dhe prapë në kemi me bisedu për këtë pikë se është konflikt interesi, përderisa stacioni i autobusëve e ka pjesë të saj është konflikt interesi.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës me këtë përbërje të komisionit:

Ruzhdi Lestrani - anëtare nga ekzekutivi

Nga Stacioni i Autobusëve përbehet nga dy anëtar:

Heteme Rrusta - anëtare nga ekzekutivi

Remzi Dervishi - anëtare nga ekzekutivi

Bujar Dervishi-anëtar nga Kuvendi Komunal

Petrit Gashi- anëtar nga Kuvendi Komunal

Prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar:

Për votuan 27 anëtar

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria për mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale.**

Arta Xhylani- kërkoj një sqarim nga drejtoresha pse po kalohet këto mjete më gjerësisht për shkak se dyjat i kemi diskutuar më herët në kuvend edhe për qentë endacak edhe për tegun?

Drejtoreshë për shërbime publike dhe emergjencë Lumnije Krapit- problemi i qeneve endacak është problem që na preokupon të gjithëve jo vetëm neve, ne si kod e kemi pas edhe vitin e kaluar edhe tani, ministria ka marr vendim që të gjitha mjetet të barten në agjencion të veterinarisë ata e kanë shpallë projektin kanë aplikuar, nuk na lejohet dy projekte me apliku me të njëjtin qellim dhe për këtë arsye mos me shku mjetet i kemi vendos me i qit në mirëmbajtje të tregut.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan 26 anëtar

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për plotësim/ndryshimin e komisionit ndryshimin e Stëmës dhe Vulës së Komunës së Drenasit**

Sokol Bylykbashi- ka më shumë se një vit kur është formuar komisioni për ndryshimin e stëmës dhe vulës së komunës së Drenasit, këtë komision në e patëm kundërshtuar fuqishëm përmes fjalimeve dhe aktiviteteve jashtë Kuvendit Komunal për shkak se kemi menduar edhe atëherë edhe tani kemi të njëjtin qëndrim se komuna Drenasit nuk është dashtë me prek as stemën as vulën për shkak se reflektojnë vlerat kombëtare tonat, Komuna Drenasit respektivisht Kryetari i Komunës u dashtë me sjellë një propozim vendim që e shfuqizon këtë komision dhe mos të merret me këtë çështje fare për shkak se kemi shumë probleme të cilat komuna Drenasit duhet të merret me ato për të cilat ka shumë edhe ankesa edhe kërkesa, kështu që ne si opozitë nuk do të marrim pjesë fare në votim, do ta bojkutojmë këtë pikë të rendit të ditës ashtu siç kemi bërë saktësisht para një viti.

Gani Podrimqaku- ky propozim vendim ka kaluar mirëpo vetëm ta bëjmë ndryshimin meqë Shqipe Zogu ka kaluar ne ekzekutiv propozojmë Qëndrim Mulaj.

Nënkryetari i Komunës z. Gani Sylaj- propozoi nga ekzekutivi në vend të Shqipe Kuliqit propozoi Shqipe Zogu.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës me këtë përbërje të komisionit, Shqipe Kuliqi të zëvendësohet me Shqipe Zogu dhe Shqipe Zogu të zëvendësohet me Qendrim Mulaj prezent gjatë votimit ishin 18 anëtar:

Për votuan 18 anëtar

Kundër votuan 00 anëtar

Abstenim 00 anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: 6. Të ndryshme.

Fitore Morina- në mbledhjen e fundit në Komitet për Politikë dhe Financa pata kërkuar që për këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës të jetë si pikë e rendit të ditës mirëpo mbeti tek të të ndryshmet, bëhet fjalë për problemin që banoret e fshatit Qikatovë e Vjetër po përballen që disa muaj nga skoria (shlaka) që po deponohet nga fabrika e Feronkelit në vendin e quajtur Dushkajë, shumë afër shtëpive të banoreve të fshatit Qikatovë e Vjetër por edhe Dritan dhe Gllanasellë, banoret janë ankuar në mënyrë të vazhdueshme madje edhe me protesta për shkak të rrezikut që kjo skorie do t'i shkakton në shëndet e njerëzve, tashmë jemi njoftuar që Ministria e Mjedisit për këtë deponi e kishte pajisur me leje përkatëse fabrikën sa do që banoret nuk ishin pyetur fare për këtë e që ligji i kishte obliguar. Banoret janë shqetësuar me faktin se ministria e ka pajisur fabrikën me këtë leje por edhe më të habitur që kjo leje nuk po respektohet nga kompanitë që kanë marrë tenderin për të deponuar atë skorie aty e që del që ky është një i afërt i kryetarit të komunës sonë, dhe mos respektimi i saj do të ketë pasoja të drejtpërdrejta në shëndetin e banoreve sidomos të fshatit Qikatovë sepse skoria përmes kanalit të ujit do të depërtoj ne pusët ose bunarët e këtyre banoreve si dhe mos mbulimi me dhe do të bëjë që erërat të ngritin skorien lart dhe qytetaret e fshatit Qikatovë do ta thithin këtë skore gjë që është shumë e rrezikshme për shëndetin e tyre. Unë kërkoj nga kryetari që të përgjigjet se cili ka qenë veprimi i tij për të dalë ne ndihmë banoreve që të mos rrezikohet shëndeti i tyre nga kjo materie e rrezikshme, apo përfitimet e me kontrata nga feronikeli me transportin e kësaj kontrate ia kanë verbuar sytë kryetarit Lladrovci. A keni pas ndonjë inspektim apo keni kërkuar nga ministria që të inspektoj këtë deponi. Të nderuar kolegë asamblist një nga detyrat tona themelore është diskutimi i brengave dhe hallet të qytetareve të komunës sonë banoret e fshatit Qikatovë por edhe të fshatrave për rreth deponisë të lartpërmendur kanë probleme esenciale për shëndetin e tyre prandaj unë sot kërkoj urgjentisht të marrë masa kryetari që brenda kompetencave të tij por edhe duke kërkuar nga ministria e mjedisit të stopohet urgjentisht deponimi i skories në këtë lokacion dhe të analizohet në perpikmeri leja se si është lëshuar nga ministria dhe gjithë skoria e cila është vendosur pa iu ndërtuar baza e cila do të parandalon kontaktin me ujëra nëntokësor.

Beqir Kiqina- unë dua të jap një propozim që kuvendi të sjellë në seancën e radhës një propozim që e diela të jetë ditë pushimi, kërkoj nga drejtorja e ekonomisë që t'i propozoj Komitetit për Politikë dhe Financa një propozim rregullorë e cila do të rregullojë këtë çështje që e diela të jetë ditë pushimi për arsye se deri më tani janë stërngarkuar punëtorët duke punuar edhe vikendeve, kjo shpresoj që nuk i bënë dem as bizneseve që të kenë një ditë pushimi, unë shpresoj që në këtë rregullorë të futet të gjitha kompanitë edhe publike edhe private edhe marketet edhe kompanitë e ndërtimit për arsye se deri më tani është një orar i stërngarkuar.

Sokol Bylykbashi- pati një pyetje për drejtorin e infrastrukturës, pyetja është në lidhje me projektin e ujësjellësit për lidhjen e rezervarit nga Feronikeli deri të Kamenica një projekt i cili ka dështuar, dua të di sa ka qenë vlera e projektit, sa është dëmtuar Komuna Drenasit nga mos realizimi i punëve ashtu siç kanë qenë të parapame me kontratë nga operatori ekonomik, cili operator ekonomik i ka bërë këto punime me gjithë këto shkelje të medha edhe si komunë si drejtori a keni parapa ndëshkim dhe çka keni bërë në këtë aspekt, cili është ndëshkimi për këtë kompani që e ka dëmtuar buxhetin e Komunës së Drenasit respektivisht taksat e qytetareve të Drenasit.

Drejtor për Urbanizem Idriz Hysenaj- e tërë lënda ka shkuar në prokurori, demi që është bërë ne i kemi vlerësuar përafërsisht 25 mijë euro, lënda është në hetime kështu që presim rezultatet e hetimeve, është firma "Verllaku" demi është bërë kemi konstatuar kemi kryer hulumtimet edhe kemi menduar që është e përfunduar kur kemi ardh në përfundim me i ngjit pompat i kemi dashtë me ngjit gypin në atë pjesë nuk ka gyp ekzistues.

Sokol Bylykbashi- deponija "Vrellaku" nëse aplikon për ndonjë tender në të ardhmen ju si drejtori a do ta keni parasysh që nuk mundet me marr më projekt nga Komuna Drenasit për shkak se ka bërë shkelje të madhe e ka dëmtuar shumë buxhetin e komunës.

Drejtor për Urbanizem Idriz Hysenaj- është problem që i takon prokurimit por që dy vite që jam drejtor me sa kam njohuri nuk ka pas kërkesë mirëpo këto probleme nuk janë të drejtorisë tonë janë të prokurimit por megjithatë ky është një problem që ajo as nuk mundet me konkurruar.

Sabrije Kukaj- një herë kam pas pyet edhe ceva që është shtri prej donacionit zviceran a është duke punuar me rregull a është duke u fut me rregull ajo cevë apo jo se askund zallë nuk ka fut, edhe pjesa tjetër neper fshatra se unë këtë çështje e kam ngrit me herët që nuk janë ë të futura cevate askund, dhe një herë të kam pyetur, mos ka prapë problem ajo pjesë se edhe tani janë të shkëputura ato ceva se ka u ndertu asfalti që edhe dy vjet a tri vjet ato fshatra nuk kanë me pas ujë me qita hapa siç janë duke shkuar punimet.

Drejtor për Urbanizem Idriz Hysenaj- ne jemi duke u ballafaquar me atë problem, faktikisht ka qenë një firmë jo e angazhuar nga ne që i ka krye ato punime që i kanë fut gypat nuk i kanë përfunduar as pusetat, i kanë futur gypat rreth rrugës që nuk kanë marr leje nga ministria, kanë marrë ndëshkim për ata gypa që i kanë shtre në pronën që kanë mendu të zgjerohet traseja rrugës kështu që nuk ka përfunduar ne jemi në shqyrtim, ne vetëm jemi monitorues dhe i kemi dergu vërejtjet tona, ne jemi duk e bërë përpjekje t'i mbushim rezervarët dhe çdo defekt që ka shkojmë duke e përcjellë se bashku me ujësjellësin e Prishtinës, para dy dite kemi pas drejtorin gjeneral të ujësjellësit të Prishtinës pikërisht për këto probleme dhe kontratën që e kanë pas për ujësjellësin për furnizimin e rezervarit me ujë dhe se shpejti do ta bëjmë një momerandum bashkëfinancimit për defektet që janë gjatë rrugës t'i eliminojmë dhe t'i furnizojmë qytetaret me ujë.

Nexhmedin Balaj-u diskutua rreth firmës të cilën e ka përfunduar këtë projekt mirëpo komuna konkretisht ekzekutivi i ka edhe organet përgjegjëse të cilat i mbikëqyrin gjatë punës se punimeve dhe komisionin pranues, unë e kam një pyetje konkrete për drejtorin dhe e përgëzoj që e ka ngrit këtë çështje dhe e kanë dërguar deri ne prokurori mirëpo a ka sanksione ndaj atyre

komisioneve dhe a kanë emra ata persona, pse po e bëjë këtë pyetje. Po e bëjë pikërisht për komisionet e tanishme që janë që punimet mos të shkojnë shkel e shko por të kenë kujdes kur t'i marrin detyrat dhe përgjithësitë.

Drejtore për Urbanizem Idriz Hysenaj- lënda kur shkon në prokurori shkon më të gjitha elementet, dmth është kompania mbikëqyrëse, komisioni dhe punëkryesi me të gjitha këto është duke u marrë prokuroria.

Vehbi Berisha- unë do të flas për një çështje tjetër me datë 12 këtij muaji iu kam drejtuar më një shkresë zyrtare juve kryesues, kryetarit Lladrovci po ashtu iu kam njoftuar edhe anëtarët e kuvendit, qëllimi ka qenë të bëj një propozim për shpallje e qytetare nderi të Komunës së Drenasit znj. Sophije Levesque ish ushtar kanadeze që ka shërbyer në misionin e KFOR- it në bazën e atëhershme në fshatin Korreticë, znj Levesque është shndërruar në promotorë e Republikës së Kosovës nga ajo vjen. Sigurisht që zonja vazhdimisht ka kontakte të cilat i poston në rrjetin social Facebook me qytetarët e Drenasit dhe vazhdimisht poston gjera për Drenasin dhe qytetarët e Drenasit dhe lidhet ngushtë me qytetin tone dhe në bazë të informatave që kam ajo në fillim të muajit qershor do të jetë prezentë në qytetin tonë për vizitë private, duke u nisë edhe nga praktikët e mëhershme që bashkërisht me vota unanime i kemi miratuar të gjitha propozimet që na kanë ardh për qytetar nderi e kam dhënë këtë propozim, me rendësi është që miqtë tanë botëror t'i ruajnë më aq sa kemi mundësi prandaj e kam dhënë këtë propozim si ide.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj- jemi duke e shqyrtuar çështjen si mundësi.

Arta Xhylani- kur e ke dërguar imellen edhe unë e kam shikuar mirëpo ndoshta kishe qenë me mirë me kerku me u taku komisioni që e kemi caktuar për dekorata mirënjohje apo gjera të tilla, përderisa ne si komision që jemi themeluar që një vit ende nuk kemi mbajtur asnjë mbledhje.

Sabrije Kukaj- dua të ndërlidhem të skoria, sa i përket kësaj çështje të gjithë duhet të brengosemi. Skoria tek feronikeli është e dëmshme dhe të gjithë duhet të shqetësohemi për këtë fakt.

Beqir Kiqina- pati një pyetje për Drejtorinë e kulturës rinisë dhe sportit, pasi që do të mbahet turniri tradicional, por unë jam interesuar me ditë pasi që vjet nga kuvendi kanë shkuar tre anëtar dhe është zhvilluar turniri, tani sa anëtar nga komisioni janë nga kuvendi apo kush e përben sepse nuk ka kaluar në kuvend dhe sa mjete buxhetore janë ndarë, sepse nëse ndahen mbi 1000 euro atëherë duhet të kalohet në kuvend komunal që me e miratuar atë propozim.

Petrit Gashi- i kam disa çështje, e para është se janë krijuar disa gropa në urën e Komoranit a i keni njet me i rregulluar apo jo, sepse përveç që po i shkatërron veturat po shkakton edhe rrezik në komunikacion dhe një barnatore në Komoran që duhet të punoj 24 orë për arsye që me ka renë ditëve të fundit ta vizitoj qendrën e mjekësisë familjare në Komoran mirëpo përderisa kontrollohesh në Komoran dhe vjen i blen barnat në Drenas sepse nuk ka barnatore hap në Komoran cila është arsye e hapjes së qendrës së mjekësisë familjare 24 orë në Komoran, a e keni ndërmend me marr masa që edhe një barnatore të punoj 24 orë në Komoran. Në premtime të

z. Lladrovci ne vitin 2016 ishte edhe rrjeti i ujësjellësit, ne fakt na u dashtë 30 muaj me ditë që mungojnë disa ceva.

Egzona Jetullahu - sa i përket orës se kujdestarisë ne Komoran ke të drejtë, unë i kam ftuar përfaqësuesit e barnatoreve të Komoranit dhe jemi duke diskutuar që edhe barnatoret në Komoran të kenë orar të kujdestarisë. Sa i përket e diela të jetë ditë pushimi, edhe këtë çështje e kemi ngrit që e diela e gjitha bizneseve private të jetë ditë pushimi, shumica e bizneseve ndaj punëtorëve e kanë një ditë pushimi brenda javës por nuk e kanë të dielën, do të bëjë përpjekje që e diela të jetë pushim.

Petrir Sinani- pati një shqetësim sa i përket barnatoreve të kujdestarisë me ka renë vet personalisht psh. një bari e kam blere 5 ose 6 euro në kushte normale ndërsa kur ka qenë kujdestaria te njëjtin bari e kam blerë 6.90 euro ose 7 si shembull, ne jemi munduar me bërë mirë në të mirë të qytetareve por në këtë rast duhet një monitorim i shtuar sidomos i drejtorive përkatëse drejtorisë së inspeksionit, sepse këto biznese po e shfrytëzojnë përfitimin e tyre në kurriz të qytetareve, sa i përket pushimeve të dielën unë personalisht jam kundër sepse tregu i lirë nuk funksionon kështu, jam pro punëtorëve dhe sipas informacioneve punëtorët e kanë një ditë të lirë gjatë javës dhe kjo ndodhë po thuajse më të gjitha bizneset, e diela nuk mundet me u be ditë pushimi por janë aktivitete të caktuara të cilat nuk mund me ia bë pushim kështu që konsideroj që para se mu hartu edhe rregullore tjetër ose para se me u marrë me hartimin e një rregullore me i marrë parasysh gjitha indikator të cilët janë pozitiv dhe negativ.

Egzona Jetullahu- sa i përket inspektimit të barnatoreve në Drenas jemi duke i inspektuar që tri herë, barnatorja që punon pa kupon fiskal, barnatorja e cila i ngrit çmimet të cilat i kam në dosje ne drejtorinë time mund te vini dhe t'i shihni. Por nuk do të ndodhë më arsyeja është që ekonomia është një treg i lirë dhe kërkoj nga gjithë ju dhe qytetaret që ta marrin atë kupon fiskal dhe ta kenë të drejtën e ankesës.

Beqir Kiqina- sa i përket të deles është ditë pushimi, por të mos punojnë gjatë ditës së diel, kjo nuk ndodh vetëm në Drenas por edhe në disa komuna tjera kështu që edhe unë kërkoja nga ju që ne seancën e radhës të vjen një propozim për këtë çështje.

Egzona Jetullahu- punëtorët e kanë një ditë pushimi gjatë javës, sa i përket rregullores që kemi kërkuar ndryshimin e rregullores iu kisha lut që ju keni me qenë ata që keni me miratu këtë rregullore, mos të ndodh sikur herëve të tjera që vijnë bizneset dhe të thonë që taksa shumë e lartë, kisha kërkuar nga ju që kur të vjen në kuvend kjo rregullore me ditë se çka po votojmë që në të ardhmen mos të kemi problem me biznese dhe vendimet të cilat iu dërgohen atyre bizneseve për ushtrim të asaj veprimtarie.


Bedri Nika- e diela është punë për të gjitha bizneset neper botë nuk mundemi me i sanksionua bizneset tona Drenasi, punëtorët të gjithë e kanë një ditë pushimi, kështu që mos hajdi me një propozim të tillë. Sa i përket barnatoreve në Komoran Kuvendi Komunal mund të bëjë zgjidhje, me pas një ofertë që brenda shtëpisë së shëndetit në Komoran me pas një barnatore.


Petrir Gashi- komuna e ka zyrtarin për integritet evropiane dhe duhet me iu tregu se marrëveshja për stabilizim asociim mes Kosovës dhe Bashkimi Evropian e obligon Kosovën e që

nënkupton edhe Komunitat me i plotësuar ca standarde që rrjedhin prej saj e kështu që nëse na pretendojmë që me i plotësuar si komuna kushtet për me vazhdu tutje duhet me u përgjigje në bazë të standardeve të BE-së pra kjo nuk rrjedhë pse ne dëshirojmë me u hap bizneset te dielën a me u mbyllë, këto janë standarde te përcaktuara cilat biznese lejohen me punu, gastronomi s'mund me ndal 24 or duhet me punu, pompat s'mund me i ndal por kategorizohen bizneset dhe ato biznese të cilat nuk lejohen, ndërtimtarisë nuk i lejohet me punu të dielën as maketeve


Seanca përfundoj ne ora: 11:45 min

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza- Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit


Labir Hoti



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 22.06.2019, si vijon:

Pasi kryesuesi përshendeti të pranishmit njoftoi anetaret e K.P.F-ca se se kemi edhe një pikë shtesë në rendin e ditës: informatë lidhur me Raportin e SMPK-së, për vitin 2018.

Të gjithë anetaret e K.P.F-ca u pajtuan që të futet edhe kjo pikë dhe kaloj rendi i ditës me:

07 vota për, Kunder: 00, dhe abstënim: 00

1.Procesverbali i mbledhjes së K.P.F-ca të datës 22.05.2019

Nuk pati vërejtje dhe diskutime për këtë pikë të rendit të ditës.

2.Propozim–Rregullore komunale për transparencë.

Edhe kjo pikë e rendit të ditës kaloj me;

07 vota për, 00 kunder, 00 abstënim

3.Propozim vendim për financimin për projektin KH “Drenica”

Kjo pikë e rendit të ditës u votua si;

3 vota për, 04 kunder dhe 00 abstënim

4.Propozim vendim për financimin për projektin KF “Feronikeli”

Kjo pikë e rendit të ditës u votua si;

3 vota për, 04 kundër dhe 00 abstënim

5.Propozim vendim për financimin për projektin KF “Drenasi”

Kjo pikë e rendit të ditës u votua si;

3 vota për, 04 kundër dhe 00 abstënim

6.Propozim vendim për financimin për projektin Këshillit për veprim Rinor Lokal në Drenas

Kjo pikë e rendit të ditës u votua si;


3 vota për, 0 kundër dhe 04 abstënim

7.Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2020-2022

Të gjithë anëtarët e K.P.F-sa u pajtuan që edhe kjo pikë e rendit të ditës të kaloj në kuvend .

8. Të ndryshme

U diskutua pse nuk ka shofer për ndihmën e shpejtë në QMF në Komoran, pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime mbledhja përfundoj rreth ores 11:05 min

Kryesuesi / Kryeditari

Labiriot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060-41580 dt. 10.07 2019

Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
27.06.2019

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 27.06.2019

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 23 anëtarë

Kuvendi filloi punimet më këtë :

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 31.05.2019.
2. Propozim–Rregullore komunale për transparencë.
3. Propozim vendim për financimin për projektin KH “Drenica”
4. Propozim vendim për financimin për projektin KF ”Feronikeli”
5. Propozim vendim për financimin për projektin KF “Drenasi”
6. Propozim vendim për financimin për projektin Këshillit për veprim Rinor Lokal në Drenas
7. Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2020-2022
8. Informatë lidhur me Raportin e SMPK-së për vitin 2018
9. Propozim vendim për ndryshimin e Komitetit për Komunitete.
10. Të ndryshme

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 27.06.2019 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, përfaqësues të OSCE-së, KDI-së si dhe drejtorët e drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj, hapi diskutimin për rendin e ditës duke kërkuar nga anëtarët e Kuvendit, se a pajtohen me këtë rend dite, apo ka ndonjë propozim?

Në mungesë të diskutimeve, vërejtje apo sugjerime, Kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, ku prezent gjatë votimit ishin 23 anëtar:

*Për votuan 19 anëtar,
Kundër votuan 01 anëtar
Abstenim 03 anëtar.*

Kryesuesi i Kuvendit Halilaj-vijoi me diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 31.05.2019, për të cilën nuk pati vërejtje apo sugjerime, kryesuesi e hodhi në votim ku: prezent në votim ishin 23 anëtar:

*Për votuan 23 anëtar,
Kundër votuan 00 anëtar,
Abstenim 00 anëtar.*

Lidhur me pikën 2:- **Propozim-Rregullore komunale për transparencë.** Drejtuesi ia kaloi fjalën Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci, i cili theksoi se Rregullorja komunale për transparencë ka të bëjë me ndryshimin dhe harmonizimin e rregullores me rregulloren e MAPL-së.

Pas kësaj kryesuesi e kaloi në votim, ku:

*Për votuan 26 anëtar,
Kundër votuan 00 anëtar,
Abstenim 00 anëtar.*

Me procedimin e pikës pikës **3. Propozim vendim për financimin për projektin KH "Drenica".**Drejtuesi i seancës tha se meqë janë 4 pika propozime vendime,propozoj që debatet të bëhen të përbashkëta kurse votimi të bëhet për secilën pikë. Pas miratimit nga të gjithë anëtarët, fjalën ia kaloi;

Shqipe Zogu:Procedura e subvencionimit për të gjithë përfituesit ka kaluar përmes rregullores së nivelit qendror, Rreg. Nr.4/17 mbi procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Në implementimin ka hyre edhe pjesa e dispozitave të cilat nuk kanë qene në kundërshtim me këtë rregullore.

Ne kemi propozuar për financimin e katër projekteve dhe në pjesën e preambulës kemi specifikuar saktë se në cilat procedura ligjore jemi thirrur. Këto propozim vendime kanë dalë nga komisioni për ndarjen e subvencioneve, të cilat kanë qenë publike.

Petrit Gashi: Lidhur me këto propozim vendime nuk kemi parë se çfarë kriteresh janë zbatuar. Këtu u tha se këto propozim vendime i ka bërë kryetari. Ne si asambleistë duhet të dimë saktë raportet financiare,pasi propozohen disa propozim vendime pa asnjë arsytim. Çdo propozim-vendim duhet të ketë një arsytim. Nuk ka vend në botë që paraqet propozim vendime me dy tre rreshta dokument, pa u shoqëruar me një raport të detajuar se si do të shpenzohen këto para. Më duket e palogjikshme dhe e paarsyetuar.

Shqipe Zogu. Nuk është ashtu si thoni ju sepse nuk kam thënë që janë propozim vendime për ndarjen e subvencioneve nuk i ka bërë kryetari, por është Komisioni shqyrtues për kritere. Këto

propozim vendime janë për shkak të një vendimi nga kryetari, i cili cakton limitin se në cilin nivel duhet të përcillen nga kuvendi këto propozim vendime.

Beqir Kiçina; Sa i përket këtyre pikave të rendit të ditë për subvencione të klubeve sportive, ajo që më brengos është se ka shumë gjëra që po vijnë në Kuvendin Komunal dhe nuk po kalojnë nëpër Komisione ligjore, të cilat janë formuar dhe kanë marrë legjitimitetin në këtë Kuvend. Është komiteti për politika dhe financa, i cili i shqyrton pikat e rendit të ditës para se të vijnë për shqyrtim në Kuvend. Kemi proces verbalet këtu se janë diskutuar nga Komiteti i politikave dhe financa nuk i ka kaluar këto propozime dhe ne përsëri i kemi në Kuvend.

Ramiz Lladrovci Ja u kam shpjegua disa herë dhe besoj se ato që janë më të mençur e kuptojnë se çfarë është Komiteti për politika dhe financa. Komiteti për politika dhe financa është këshillëdhënës me letu kuvendin, pra vetëm i shqyrton dhe nuk është vendimmarrës.

Shqipe Zogu; Të gjitha klubet sportive që kanë aplikuar, përveç një klubi që nuk dua t'ia përmend emrin, për shkak të mosplotësimit të një kriteri janë subvencionuadhe gati 85% e klubeve u janë shtuar subvencionet.

Adem Bucolli; Jemi në një pikë ku ka nevojë të diskutohet po të ketë transparencë. Unë jam i vetmi që nuk jam përfitues i benifiteve. Kur vjen fjala për subvencionimit nga ana e Kuvendit 38 500 euro është një shumë shumë minimale, pasi vetëm në këtë fazë përgatitore të ndeshjeve për Champions Lige na kanë kushtuar rreth 68.000, mijë euro. Dhe i gjithë financimi i Komunës nuk zë veç 0.05% të shpenzimeve vjetore. Unë e vlerësoj se seriozisht duhet të mendojmë që të gjejmë mundësi për të rritur financimet jo vetëm për klubin futbollistik të Feronikelit, por për të gjitha klubet.

Petrit Gashi: E para si anëtar i Kuvendit nuk duhet të flasim në zhargonin e kryetarit. Thjesht ne kërkojmë të ketë transparencë dhe arsyetim. Psh kemi raporte dhe informim për arsyetimin e 7500 eurove dhe akoma nuk kemi asnjë raport apo faturë arsyetimi për 38500 euro. Këto janë procedura që duhen respektuar.

Arta Gjylani; Nuk po më duket shumë tragjike që të financojmë disa klube. Duhet më shumë dëshirë dhe vullnet për me i financu sa më shumë. Unë do desha edhe klubet hendbollistike të kenë sa më shumë financime pasi janë dy klube, që na përfaqësojnë në nivel shteti, bilës edhe të shkojmë në stadione me i pa ndeshjet, i ndihmojmë këto klube.

Petrit Sinani; Para së gjithash i uroj fitoren klubit të Feronikelit. Jam dakord me kolegët për të sjell një pasqyrë financiare. Mirëpo sa i përket klubit futbollistik Feronikeli është pranë nga UEFA dhe normalisht kanë një raport të pasqyrave financiare pasi është detyrim nga UEFA. Realisht 38000 euro është një shumë minimale për këtë ekip sportiv. Normalisht vlerësoj që duhen financuar sa më shumë klubet tona. Nuk kam paragjykuar dhe nuk ka pse ndihet keq ndokush. Mua më ka ardhur keq që nga opozita nuk kanë votuar, por kanë abstenuar. Sa i përket subvencionimeve unë nuk do doja të mbetej vetëm tek klubet e futbollit Feronikeli dhe Drenica, por edhe të gjitha klubet e tjera të cilat kanë nevojë për rritje të tyre. Kemi rezultate mjaft të mira nga klubet e Drenasit dhe duhet të jemi krenar për këtë.

Florentina Elezi; Më vjen keq që na drejtoheni në këtë formë duke kërkuar urime duke na paragjykuar. Këto klube janë të Drenasit dhe nuk janë pronë e dikujt që duhet ta urojmë. Ne jemi krenar për suksesin e Feronikelit dhe për sukseset e kujtdo klubi tjetër, por duhet të mbështesim të gjitha klubet, sepse nuk ka kuptim që tua ndalesh subvencionimet disave dhe të financosh gati me 70% të buxhetit për subvencionime vetëm një klubi. Edhe klubet e tjera po të kenë subvencione të mjaftueshme mund të arrijnë suksese, ashtu siç po i tregojnë këto kohët e fundit. Dhe ju lutem mos na paragjykoni. Nuk kemi nevojë ti marrim leje kurrkujt se si duhet të votojmë.

Kryesuesi; Kurrkush nuk ka paragjykuar njeri. Mos e merr për paragjykim. Ai e kritikoi, por nuk e paragjykoi. Kritikën mos e merrni për fyerje. Shumë më pëlqeu ideja e Petrit Sinanit në aspektin e klubeve.

Petrit Sinani; Realisht ajo që e thash unë nuk është paragjykim. Kuvendi Komunal është arenë e debatit dhe duhet të ketë mendime të ndryshme. Ne duhet të debatojmë pasi të gjithë mund të kemi mendime ndryshe por në fund qëllimi final duhet të jenë interesat e qytetarëve. Sa për dy klubet Feronikeli dhe Drenica janë ekipe të Drenasit dhe aksionar është Komuna e Drenasit.

Arta Xhylani; Ju lutem i drejtohem Petritit. Nuk keni të drejtë ju me ju dhënë llogari se si të votojmë. Sa për atë se jemi kundër janë qytetarë që na gjykojnë. Nuk jemi kundër subvencionimeve por kërkojmë rregull dhe shpërndarje për të gjitha klubet.

Burim Bujupi; Nuk desha me u zgjat por desha me plotësua kolegen time. Mos u mërzit se këtyre duhet tu marrim leje sepse i kanë uzurpuar krejt tani.

Edolina Plakiqi; Nuk jemi kundër subvencionimeve dhe nuk kemi abstenuar për këtë por kemi abstenuar sepse nuk ka vlerësim dhe rritje në subvencionim ashtu siç pretendohet. Drejtoresha pretendon se ka rritje por nuk ka edhe tash.

Adem Bucolli; Po me vjen mire se kolegët po kërkojnë transparencë lidhur me subvencionimet e të gjitha klubeve. Por ju nuk keni thënë asnjë fjalë për ekipin e Basketbollit Feronikeli, i cili në superligë i ka fituar të gjitha takimet.

Drejtuesi i seancës pas reshtjes së debateve kaloi në procesin e votimit veç e veç të katër pikave. Ju ftoj të votojmë për pikën 3. Propozim vendim për financimin për projektin KH

"Drenica"

Për votuan 19 anëtarë,

Kundër votuan 00 anëtarë,

Abstenim 07 anëtarë.

Votojmë për pikën 4. Propozim vendim për financimin për projektin KF "Feronikeli"

Për votuan 19 anëtarë,

Kundër votuan 00 anëtarë,

Abstenim 07 anëtarë.

Votojmë për pikën 5. Propozim vendim për financimin për projektin KF "Drenasi"

Për votuan 19 anëtarë,

Kundër votuan 00 anëtarë,

Abstenim 07 anëtarë.

Votojmë edhe për pikën 6. Propozim vendim për financimin për projektin e Këshillit për veprim Rinor Lokal në Drenas.

Për votuan 22 anëtarë,

Kundër votuan 00 anëtarë,

Abstenim 03 anëtarë.

Pika 7. Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2020-2022

Drejtuesi i seancës ia kaloi fjalën për të bërë arsyetimin drejtorit Shyqyri Bublaku.

Shyqyri Bublaku; Sa i përket draft kornizës afatmesme buxhetore 2020-2022, është hapi i parë i krijimit të buxhetit të ardhshëm 2020 dhe parashikim për vitin 2021-2022. Hartimi i këtij draft buxheti është bërë mbi bazën kornizës afatmesme të buxhetore të dërguar nga Ministria e Financës gjegjësisht Qeveria e Kosovës për vitin 2020 dhe parashikimi për vitin 2021 dhe 2022. Duke pasur parasysh kriteret për krijimin e buxhetit kihen parasysh tri kriterë që janë edhe shtyllat bazë; 1-Kriteri bazë është numri i popullsisë, 2 - Madhësia gjeografike e Komunës dhe 3 - Madhësia e popullsisë pakicë. e cila vlerësohet edhe me një buxhet shtesë prej 02% më shumë. Më pas Bublaku vijoi me të dhënat teknike të krijimit të draft kornizës afatmesme buxhetore komunale.

Qendrim Mulaj; Desha me theks se lista e projekteve ka një ndryshim, infrastruktura në Komoran dhe infrastruktura në Drenas janë 150 me 50, mos duhen ndryshuar vendet e shifrave, pasi më duken gabim duhet rregulluar.

Petrit Sinani; Draft-korniza afatmesme buxhetore është një dokument, i cili përmban informata dhe udhëzime të mjaftueshme në lidhje me shpenzimet pothuajse të gjitha kategorive buxhetore të gjitha departamenteve komunale si dhe indikator kryesor i përcaktimit të tavanit të shpenzimeve për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësimet për dy vitet e tjera fiskale pas atij siç thuhet edhe në ligjin për financat publike.

Siç e dini draft KAB duhet të përfshijë procedura , të dhëna , detaje dhe afate të departamenteve përkatëse në lidhje me propozimet dhe kërkesat buxhetore të departamenteve për ndarje buxhetore.

Për mendimin tim draft KAB e komunës së Drenasit në krahasim me vitet e tjera ofron një qartësi për sa i përket të dhënave dhe kërkesave për ndarje buxhetore, por ajo çka desha të ndalem unë janë disa propozime të përgjithshme, të cilat uroj të merren në konsideratë nga ana e drejtorëve të drejtorive përkatëse.

Secila drejtori duhet të ketë objektiva të qarta në lidhje me projektet të cilat parashihen të realizohen gjatë vitit fiskal dhe këto objektiva të dalin nga kjo letër dhe të jenë në shërbim direkt të gjithë qytetarëve.

Baza e çdo planifikimi të mirë është komunikimi i vazhdueshëm me qytetarët , i cili është çelësi kryesor drejt arritjes së realizimit të buxhetit komunal. Komuna jonë ka bërë përmirësime të dukshme. Në disa dikastere është e rëndësishme dhe jetike që të gjitha kategoritë ekonomike si dhe investimet kapitale të shkojnë në funksion të rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Krijimi i infrastrukturës së nevojshme komunale, lehtësimi i procedurave rreth regjistrimit të bizneseve, krijimi i një fondi të veçantë zhvillimor, përkrahja direkte e bizneseve STAR UP, përkrahja e një numri të madh të fermerëve përfitues me projekte të ndryshme në bujqësi e blegtori , duhet të jenë prioriteti kryesor të cilin duhet të synoj komuna jonë.

Idriz Hyseni: Desha të bëj një përmirësim. Kur kemi bërë draft propozimi nuk i kemi pasur ofertat për lum pasi projekti për përmirësimin e shtratit të lumit Drenica, kemi lënë investimin 100. 000 euro, Mendoj që të hiqen 50. 000 pasi i mbulojmë këtë vit, një pjesë të madhe të punimeve për shtratin e lumit dhe shumë 50 000 ti kalojmë në Nekoc dhe Kishnarek, pasi është fshat i madh dhe akoma kanë mbetur një pjesë e rrugëve në këto fshatra.

Petrit Gashi; Në bazë të dhënave dhe gjendjes në terren nuk po shoh planifikime buxhetore për tre vjet. Nuk e di a i kam të gjitha materialet, por po shoh që premtimet e kryetarit për Ngrohjen e Qytetit dhe Liqenin e Verboçit që janë edhe premtime të kryetarit të bëra gjatë fushatës. Ndoshta ka planifikim por unë nuk po shoh planifikime buxhetore për tre vjetet e ardhshme.

Idriz Hysenaj; Petrit i kenë kodin buxhetor Llapushnik, Vukovo dhe Poterk. Në bazë të punëve që kanë mu krye unë kam menduar se e përtheqojmë me këto të tjera. Sa i përket pendës ne e kemi bërë fizibilitetin dhe qeveria Hungarezee ka marrë përsipër dhe tashmë procedurat i vazhdojnë ata.

Burim Bujupi; Pse tek ujërat e zeza nuk është përfshirë fshati Gjurgjicë dhe Bytyç?

Shyqyri Bublaku Të gjitha vërejtjet që u dhanë për gabimet teknike do të përmirësohen gjatë ditës së sotme.

Arta Xhyllani; Edhe unë për një Gabim teknik e kam dhe më duhet të njoftoj tek tabela 5 dhe tabela 6 duhet ndryshuar viti.

Drejtuesi i seancës Halilaj meqë është draft dhe nuk votohet kalojmë në diskutimin e Pikës 8.

8. Informatë lidhur me Raportin e SMPK-së për vitin 2018.

Shyqyri Bublaku; Sa i përket granateve përfituese për shkak të performancës gjatë viteve 2018 kam me i përmend 4 pika kryesore. Nga GIZI gjerman Komuna në vitin e kaluar ka përfituar 180.000 euro grande për asete për pastrim. Nga KDI-ja për performancë jemi vlerësuar si Komuna më transparente. Kemi përfituar grande prej 100 000 euro ta pastrojmë Kosovën është përfituar vjet por grandet barten. Investime prej ministrisë shumë prej 650 000 euro për 5 projekte. Prej qeverisë Japoneze janë përfitu 64 000 euro për Mamografin. Kemi edhe një grand prej qeverisë së Zvicrës 130 000 euro.

Pika 9. Propozim vendim për ndryshimin e Komitetit për Komunitete.

Përfaqësuesi i komunitetit katolik Bekim Lestrani ka propozuar ndryshimin emrit nga Kristina Sopi në Engjell Sopi.

Pas sqarimeve drejtuesi i seancës kaloi në votim ku;

Për votuan 23 anëtarë,

Abstenim votuan 00 anëtarë

Kundër votuan 00 anëtarë

Të ndryshme

Adem Bucolli; Kam dy propozime për sinjalizimet dhe Laurat në vendkalimet e hekurudhave?
Dhe vendosjen e një pllake me emrat e gjithë dëshmorëve në sheshin Fehmi Lladrovci?

Edolina Plakiqi; Të vendoset një shofer për QF në Komoran?


Arsim Haxhiu; Ne kemi kujdestari në Komoran dhe lejen për vozitje e kanë të gjithë punonjësit kur ka raste.

Arta Xhylani; Mendoj se Sheshi Drenasi ka nevojë të plotësohet me më shumë gjelbërim.

Sabrie Kukaj; Çka u bë puna me atë projekt të lumit që keni që dy vjet që e shtyni.


Mbledhja përfundoi në orën 11.47

Proccsmbajtëse:


Zahrie Podrimqaku-Subashi



Kryesuesi i Kuvendit


Labinot Halila



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 19.07.2019, si vijon:

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K.P.F-ca se kemi edhe tri pika shtesë në rendin e ditës dhe një plotësim i pikës tre: -. Raporti financiar i zhvillimit të buxhetit Janar Qershor 2019.

- Plani i veprimtë për implementimin e rekomandimeve të raportit për vitin 2018.

-Propozim vendim për financimin e projektit Handikos Drenas.

- Asfaltimi i rrugës në fshatin Baicë,Krajkovë,Damanek me kod 48640 në shumë në shumë prej: 11.998.89euro.

Të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan që të futet edhe këto pika dhe kaloj rendi i ditës me:

07 vota për, Kunder: 00, dhe abstënim: 00

1. Procesverbali i mbledhjes së K.P.F-ca të datës 20.06.2019

Nuk pati vërejtje dhe diskutime për këtë pikë të rendit të ditës.

2. Propozim vendim për ridëstinim dhe transfer të mjeteve nga kategoria e projekteve kapitale dhe kategoria për mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale.

Edhe kjo pikë e rendit të ditës u votua si;

07 vota për, 00 kunder, 00 abstënim

3.Propozim vendim për ridesinin të mjeteve nga Drejtorati për infrastrukturë Publike.

Kjo pikë e rendit të ditës u votua si;

7vota për, 00kunder dhe 00 abstënim

4. Propozim vendim për formimin e Panelit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Barazi Gjinore.

Kjo pikë e rendit të ditës u votua si;

7vota për, 00 kundër dhe 00 abstënim

5. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim/ndryshimin e Rregullores për subvencione të Komunës së Drenasit.

Kjo pikë e rendit të ditës u votua si;
7vota për, 00 kundër dhe 00 abstenim

6. Raporti financiar i zhvillimit të buxhetit Janar Qershor 2019.

Kjo pikë e rendit të ditës u votua si;
7vota për, 00 kundër dhe 00 abstenim

7. Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të raportit për vitin 2018.

Kjo pikë e rendit të ditës u votua si;
7vota për, 00 kundër dhe 00 abstenim

8. Propozim vendim për financimin e projektit Handikos Drenas.

Kjo pikë e rendit të ditës u votua si;
7vota për, 00 kundër dhe 00abstenim

9. Të ndryshme.

Nuk diskutuan në pikën të ndryshme pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime mbledhja përfundoj rreth ores 10:45 min

